



Udhëzuesi për përdorimin e Standardit Global të IUCN-së për Zgjidhjet e Mbështetura tek Natyra

Korniza lehtësisht e përdorshme për verifikimin, hartimin dhe shkallëzimin e Zgjidhjeve të Mbështetura tek Natyra

Botimi i parë



UNIONI NDËRKOMBËTAR PËR RUAJTJEN E NATYRËS

Rreth IUCN-së

IUCN-ja është Unioni i cili në përbërjen e tij unike përmban anëtarësimin e organizatave qeveritare dhe të shoqërisë civile. Përmes tij organizatat publike, private dhe joqeveritare arrijnë të përftojnë njohuri dhe mjete, të cilat bëjnë të mundur realizimin e përbashkët të progresit të njeriut, zhvillimit ekonomik dhe ruajtjes së natyrës.

IUCN-ja u krijua më 1948 dhe tashmë është rrjeti më i madh dhe më i larmishëm në rang botëror për mjedisin, i cili përdor njohuritë, burimet dhe kapacitetet e më shumë se 1 400 organizatave anëtare dhe afërsisht 15 000 ekspertëve. Ai është ofruesi kryesor i të dhënave, vlerësimeve dhe analizimeve për ruajtjen. Anëtarësia e tij e madhe i jep mundësinë IUCN-së të kryejë rolin e inkubatorit dhe depozituesit të besuar të praktikave më të mira, mjeteve dhe standardeve ndërkombëtare.

IUCN-ja siguron një hapësirë neutrale në të cilën aktorë të ndryshëm përfshirë qeveritë, OJQ-të, shkencëtarët, bizneset, komunitetet lokale, organizatat e popujve autoktonë dhe të tjerë, mund të punojnë së bashku për të krijuar dhe zbatuar zgjidhjet ndaj sfidave mjedisore dhe për të arritur zhvillimin e qëndrueshëm.

Përmes bashkëpunimit dhe mbështetjes së organizatave partnere, IUCN-ja ka realizuar një paketë të gjerë e të larmishme projektesh mbarëbotërore për ruajtjen. Ndërthurja e shkencës më të fundit me njohuritë tradicionale të komuniteteve lokale, kanë bërë të mundur që këto projekte të përqendrohen në shmangien e humbjes së habitateve, restaurimit të ekosistemeve dhe përmirësimit të mirëqenies së njeriut.

www.iucn.org
<https://twitter.com/IUCN/>

Udhëzuesi për përdorimin e Standardit Global të IUCN-së për Zgjidhjet e Mbështetura tek Natyra

Korniza lehtësisht e përdorshme për verifikimin, hartimin
dhe shkallëzimin e Zgjidhjeve të Mbështetura tek Natyra

Botimi i parë

Përcaktimi i enteve gjeografike në këtë libër, dhe paraqitja e materialit, nuk nënkuptojnë shprehjen e ndonjë opinioni të çfarëdoshëm në emër të IUCN-së apo organizatave të tjera pjesëmarrëse në lidhje me statusin ligjor të ndonjë vendi, territori ose zone, apo të autoriteteve të saj, apo në lidhje me përcaktimin e kufijve ose juridiksioneve.

Pikëpamjet e shprehura në këtë botim nuk pasqyrojnë doemos ato të IUCN-së apo të organizatave të tjera pjesëmarrëse.

IUCN-ja përfiton nga rasti të falënderojë për mbështetjen e tyre Partnerët e Kornizës të cilët ofruan financimin kryesor: Ministrinë e Punëve të Jashtme të Danimarkës, Ministrinë e Punëve të Jashtme të Finlandës; Qeverinë e Francës dhe Agjencinë Franceze për Zhvillim (AFD); Ministrinë e Mjedisit të Republikës së Koresë; Agjencinë Norvegjeze për Bashkëpunimin për Zhvillim (Norad); Agjencinë Suedeze për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ndërkombëtar (SIDA); Agjencinë Zviceriane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) dhe Departamentin Amerikan të Shtetit.

IUCN-ja dhe organizatat e tjera pjesëmarrëse nuk mbajnë asnjë përgjegjësi për ndonjë gabim apo heqje fjale e cila mund të jetë shfaqur gjatë procesit të përkthimit në gjuhën shqipe të këtij dokumenti, versioni origjinal i të cilit është në gjuhën angleze. Në rast të ndonjë mospërputhjeje, ju lutemi referojuni botimit në gjuhën origjinale. Titulli origjinal i botimit: *Guidance for using the Global Standard for Nature-based Solutions. A user-friendly framework for the verification, design and scaling up of NbS*. First edition. (2020). Botuar nga: IUCN, Gland, Zvicër. DOI: <https://doi.org/10.2305/IUCN.CH.2020.09.en>

Ky botim është mundësuar pjesërisht nga financimi i Grupit të Agjencisë Franceze për Zhvillim (AFD), përmes Partneritetit për Zhvillimin e Natyrës Francë-IUCN.

Udhëzuesi shoqëron *Standardin Global të IUCN-së për Zgjidhjet e Mbështetura tek Natyra* (<https://doi.org/10.2305/IUCN.CH.2020.08.sq>), i cili ofron bazën shkencore dhe udhëzuesin për përdoruesit.

Botuar nga: IUCN, Gland, Zvicër

E drejta e autorit: © 2020 IUCN, Unioni Ndërkombëtar për Ruajtjen e Natyrës dhe Burimeve Natyrore

© 2021 Zyra Rajonale për Europën Lindore dhe Azinë Qendrore e IUCN-së, për përkthimin në gjuhën shqipe

Riprodhimi i këtij botimi për qëllime arsimore apo qëllime të tjera jotregtare, është i autorizuar pa pasur nevojën e marrjes së lejes me shkrim nga mbajtësi i të drejtës së autorit me kusht që burimi të bëhet i njohur plotësisht.

Riprodhimi i këtij botimi për rishitje apo qëllime të tjera tregtare është i ndaluar nëse nuk merret paraprakisht leja me shkrim nga mbajtësi i të drejtës së autorit.

Citimi: IUCN (2021). *Udhëzuesi për përdorimin e Standardit Global të IUCN-së për Zgjidhjet e Mbështetura tek Natyra. Korniza lehtësisht e përdorshme për verifikimin, hartimin dhe shkallëzimin e ZMN-ve*. Botimi i parë. Gland, Zvicër: IUCN.

ISBN: 978-2-8317-2109-5 (PDF)

978-2-8317-2110-1 (print)

DOI: <https://doi.org/10.2305/IUCN.CH.2020.09.sq>

Përkthyer nga: Iris Klossi

Ilustrimi i kopertinës: Përcaktimi i Zgjidhjeve të Mbështetura tek Natyra © IUCN

Faqësja nga: Imre Sebestyén jr/Unit Graphics

Përgatitur për botim nga: GRAFIK CENTAR d.o.o.

Ofrohet nga: IUCN, Unioni Ndërkombëtar për Ruajtjen e Natyrës

Grupi për Zgjidhjet e Mbështetura tek Natyra

Rue Mauverney 28

1196 Gland, Zvicër

NbSStandard@iucn.org

www.iucn.org/resources/publications

Teksti i këtij botimi është shtypur në letër të prodhuar nga fibra druri të pyjeve të certifikuar në përputhje me rregullat e Këshillit të Administrimit të Pyjeve (KAP).

Tabela e përmbajtjes

Historiku i dokumenteve	vi
Përmbledhje ekzekutive	vii
Falënderime	ix
Kontribuesit kryesorë	x
Lista e shkurtesave	xi
1. Hyrje	1
1.1 Zhvillimi nga koncepti fillestar në qasjen globale	1
1.2 Zgjidhjet e Mbështetura tek Natyra si korniza kryesore për adresimin e sfidave shoqërore	3
1.3 ZMN-të në kontekstin e Krizës së Biodiversitetit	4
1.4 ZMN-të në kontekstin e Krizës Klimatike	5
1.5 ZMN-të në kontekstin e krizës së gjithëpërfshirjes	7
2. Prezantimi i Standardit Global të IUCN-së për ZMN-të	10
2.1 Nevoja për një Standard Global	10
2.2 Fusha e zbatimit të Standartit	11
2.3 Përdorimi dhe publiku i synuar	11
3. Procesi për zhvillimin e përbashkët të Standardit Global	13
3.1 Bazat e kornizës së përkufizimeve të IUCN-së për Zgjidhjet e Mbështetura tek Natyra	13
3.2 Vështrim i përgjithshëm i procesit të përbashkët për zhvillim	14
3.3 Kodi ndërkombëtar për standardet e qëndrueshmërisë	14
4. Udhëzuesi për Kriteret	16
4.1 Përmbledhje	16
Kriteri 1: ZMN-të i adresojnë sfidat shoqërore në mënyrë të efektshme	17
K-1.1 Sfidat shoqërore më të rëndësishme për mbajtësit e të drejtave dhe përfituesit kanë prioritet	17
K-1.2 Sfidat shoqërore e adresuar kuptohet dhe dokumentohet qartë	18
K-1.3 Rezultatet për mirëqenien e njeriut që vijnë nga ZMN-të identifikohen, krahasohen dhe vlerësohen në mënyrë periodike	18
Kriteri 2: Hartimi i ZMN-ve informohet në bazë të shkallës	19
K-2.1 Hartimi i ZMN-ve njih ndërveprimet midis ekonomisë, shoqërisë dhe ekosistemeve dhe reagon ndaj tyre	19
K-2.2 Hartimi i ZMN-ve integrohet me ndërhyrje të tjera bashkëplotësuese dhe kërkon sinergji ndërmjet sektorëve	20
K-2.3 Hartimi i ZMN-ve përfshin identifikimin e rrezikut dhe menaxhimin e tij përtej zonës së ndërhyrjes	20
Kriteri 3: ZMN-të rezultojnë me përfitim për integritetin e biodiversitetit dhe të ekosistemit	22

K-3.1	Veprimet e ZMN-ve reagojnë drejtpërdrejt në vlerësimin e bazuar në fakte për gjendjen aktuale të ekosistemit dhe shkaqet mbizotëruese të degradimit dhe humbjes	22
K-3.2	Rezultatet e qarta dhe të matshme për ruajtjen e biodiversitetit identifikohen, krahasohen dhe vlerësohen në mënyrë periodike	23
K-3.3	Monitorimi përfshin vlerësime periodike të pasojave të dëmshme por të paqëllimshme ndaj natyrës të cilat shkaktohen nga ZMN-të	24
K-3.4	Mundësitë për të rritur integritetin dhe lidhshmërinë e ekosistemit identifikohen dhe përfshihen në strategjinë e ZMN-së	24
Kriteri 4:	ZMN-të janë ekonomiksht të realizueshme	26
K-4.1	Përfitimet dhe kostot direkte dhe indirekte të lidhura me ZMN-të, kush paguan dhe kush përfiton, identifikohen dhe dokumentohen	27
K-4.2	Studimi për efektshmërinë e kostove sigurohet për të mbështetur zgjedhjen e ZMN-ve duke përfshirë ndikimin e mundshëm të ndonjë rregulloreje apo subvencionimi përkatës	27
K-4.3	Efektshmëria e hartimit të ZMN-ve justifikohet kundrejt zgjidhjeve alternative të disponueshme, duke marrë parasysh çdo pasojë shoqëruese	27
K-4.4	Hartimi i ZMN-ve shqyrton paketën e mundësive për burime të tilla si ato që ofrohen nga tregu, sektori publik, angazhimet vullnetare dhe veprimet për të mbështetur përputhjen me rregullore	27
Kriteri 5:	ZMN-të bazohen në proceset qeverisëse gjithëpërfshirëse, transparente dhe fuqizuese	29
K-5.1	Mekanizmi i reagimit dhe zgjidhjes së mosmarrëveshjeve i përcaktuar dhe i miratuar plotësisht vihet në dispozicion të të gjithë aktorëve përpara se të fillojë ndërhyrja nëpërmjet një ZMN-je	30
K-5.2	Pjesëmarrja bazohet te respekti dhe barazia e ndërsjelltë, pavarësisht gjinisë, moshës apo statusit shoqëror, dhe mbron të drejtën e Popujve Autoktonë për Pëlqimin e Lirë, Paraprak dhe të Informuar (PLPI)	30
K-5.3	Aktorët të cilët ndikohen direkt ose indirekt nga ZMN-të identifikohen dhe përfshihen në të gjitha proceset e ndërhyrjes së ZMN-së	30
K-5.4	Proceset e vendimmarrjes dokumentojnë të drejtat dhe interesat e aktorëve të ndikuar dhe reagojnë ndaj tyre	31
K-5.5	Aty ku shkalla e ZMN-së shtrihet përtej kufijve territorialë, krijohen mekanizmat për të mundësuar vendimmarrjen e përbashkët të aktorëve në territoret e ndikuara	31
Kriteri 6:	ZMN-të balancojnë kompromiset për përmbushjen e objektivit(ve) të tyre kryesor dhe sigurimin e vazhdueshëm të përfitimeve të shumëfishta	32
K-6.1	Kostot dhe përfitimet e mundshme të kompromiseve të caktuara për ndërhyrjen e ZMN-ve njihen qartë dhe informojnë për masat mbrojtëse dhe çdo veprim të duhur korrigjues	32
K-6.2	Të drejtat, përdorimi dhe aksesimi i tokës dhe burimeve, së bashku me përgjegjësitë e aktorëve të ndryshëm, njihen dhe respektohen	33
K-6.3	Masat e krijuara mbrojtëse rishikohen në mënyrë periodike për të siguruar se kufijtë e kompromiseve të ndërsjellta respektohen dhe nuk çrregullojnë të gjithë ndërhyrjen e ZMN-ve	33

Kriteri 7:	ZMN-të menaxhohen në mënyrë të përshtatur, duke u bazuar në fakte..	34
K-7.1	Strategjia e ZMN-ve krijohet dhe përdoret si bazë për monitorimin e vazhdueshëm dhe vlerësimin e ndërhyrjes.....	34
K-7.2	Plani i monitorimit dhe vlerësimit zhvillohet dhe zbatohet gjatë kohëzgjatjes së ndërhyrjes	35
K-7.3	Korniza për të nxënë të ripërsëritës e cila bën të mundur zbatimin e menaxhimit të përshtatur zbatohet gjatë gjithë kohëzgjatjes së ndërhyrjes..	35
Kriteri 8:	ZMN-të janë të qëndrueshme dhe të integruara brenda kontekstit të duhur territorial.....	36
K-8.1	Hartimi i ZMN-ve, zbatimi dhe mësimet e nxjerra ndahen për të sjellë ndryshime transformuese	36
K-8.2	ZMN-ja informon dhe rrit politikën lehtësuese dhe kuadrin rregullator për të mbështetur përdorimin dhe integrimin e saj	37
K-8.3	Në rastet përkatëse, ZMN-ja kontribuon ndaj objektivave kombëtare dhe globale për mirëqenien e njeriut, ndryshimet klimatike, biodiversitetin dhe të drejtat e njeriut, duke përfshirë Deklaratën e Kombeve të Bashkuara për Të Drejtat e Popujve Autoktonë (UNDRIP).....	37
5.	Si përdoret Standardi	38
5.1	Si bëhet vetëvlerësimi	39
	Fjalori i përkufizimeve	41
	Referencat	61

Historiku i dokumenteve

Udhëzuesi për përdorimin e Standardit Global të IUCN-së për Zgjidhjet e Mbështetura tek Natyra	
Botimi	1.0
Gjuha e tekstit origjinal	Angleze. Përkthimet zyrtare të disponueshme.
Njësia Përgjegjëse	Programi Global i Menaxhimit të Ekosistemit; Komisioni i IUCN-së për Menaxhimin e Ekosistemit
Zhvilluar nga	Grupi i IUCN-së për Zgjidhjet e Mbështetura tek Natyra; Komisioni i IUCN-së për Zgjidhjet e Mbështetura tek Natyra
Lënda (Taksonomi)	Menaxhimi i Ekosistemit; Efektshmëria e Menaxhimit; Sigurimi
Data e miratimit	Shkurt 2020
Miraturuar nga	Këshilli i IUCN-së
Objekti	Të ofrojë udhëzime dhe një kornizë globale për hartimin, verifikimin dhe shkallëzimin e Zgjidhjeve të Mbështetura tek Natyra. Standardi përfshin Kriteret dhe Treguesit e qëndrueshëm në rang global, të cilët mbështeten nga Parimet për Zgjidhjet e Mbështetura tek Natyra, për të matur nivelin e ndërhyrjeve.
Është pjesë e	Grupit të IUCN-së për Zgjidhjet e Mbështetura tek Natyra
Është në përputhje me	Sistemin e Menaxhimit Mjedisor dhe Shoqëror (ESMS) [SMMSH] të IUCN-së Kodi i Praktikave të Mira për Vendorsjen e Standardeve të ISEAL-it
Dokumentet shoqëruese	Dokumenti i Sfondit Historik të Standardit Global për Standardin Global të IUCN-së për Zgjidhjet e Mbështetura tek Natyra
Distributori	IUCN COMPASS; Portali i Unionit të IUCN dhe faqja e internetit të IUCN-it

Historiku i dokumenteve		Botimi i parë aktual
Versioni	Data e Publikimit	Përmbledhje e Ndryshimeve
0.1	Tetor 2018	Diskutimet e brendshme realizuan me Anëtarët e IUCN-së, Komisionet dhe Sekretariatit.
0.2	Dhjetor 2018	Redaktimet e kryera nga reagimi i brendshëm dhe versioni i ri i paraqitur në konsultimin e parë publik i cili zgjati një muaj.
0.3	Janar 2019	Redaktimet kryesore të kryera nga reagimi i jashtëm dhe versioni i ri i paraqitur në konsultimin e dytë i cili zgjati dy muaj.
0.4	Shkurt 2020	Redaktimet e kryera në përputhje me reagimin nga konsultimi i dytë publik e më pas të pranuar nga Këshilli i IUCN-së, i cili miratoi publikimin e tij gjatë Takimit të 98-të në Selinë Botërore të IUCN-së, në Gland të Zvicrës.
0.5	Mars 2020	Recencimi i kryer nga recensues të jashtëm.

Përmbledhje ekzekutive

Pavarësisht se sfidat me të cilat po përballemi në ditët e sotme mund të duken të pakalueshme, shoqëria ka treguar se ajo mund të punojë si një trup i vetëm për të zgjidhur kërcënime të mëdha globale. Në vitet 1970-të, bota me sukses ndërmori veprime për të ndaluar dhe shmangur hollimin e shtresës së ozonit. Mosarritja për ta bërë këtë do të thoshte se “vrime e ozonit” tani do të shtrihej në zonat tropikale, duke ndikuar në shëndetin e njerëzve, shërbimet e ekosistemit dhe biodiversitetin. Ndryshimi i trajektores së krizës së parashikuar ka nevojë për zgjidhje të gatshme e të menjëhershme, të besueshme dhe të efektshme. Për këtë qëllim, Zgjidhjet e Mbështetura te Natyra (ZMN-të) i japin botës mundësinë e vërtetë për të adresuar siç duhet krizat e shumta të qëndrueshmërisë, duke përfshirë ndryshimet klimatike, sigurimin e ushqimit dhe të ujit, degradimin e tokës dhe humbjen e biodiversitetit.

Përmes punës së përbashkët dhe të orientuar nga përvoja e praktikave më të mira, ne tashmë jemi në gjendje të gjejmë zgjidhje afatgjata dhe të qëndrueshme, të cilat mund të na ndihmojnë të jetojmë në këtë planet në mënyrë të barabartë, të drejtë dhe të qëndrueshme. Standardi Global i IUCN-së për Zgjidhje të Mbështetura tek Natyra është gjithashtu rezultat i punës së mbi 800 ekspertëve i kombinuar me dije dhe njohuri, në lidhje me përdorimin e natyrës si aleate e denjë në luftën kundër ndryshimeve klimatike dhe sfidave të tjera kryesore të shekullit të 21-të.

Mbrojtja, menaxhimi i qëndrueshëm dhe restaurimi i natyrës mund të sjellin përfitime të rëndësishme për shoqërinë. Megjithatë, kjo mund të arrihet vetëm nëse kemi një vizion të përbashkët për përmbajtjen e atyre zgjidhjeve, një qasje të qëndrueshme mbi hartimin dhe zbatimin e tyre dhe mbi të gjitha, një kornizë të nxëni e cila na ndihmon të vlerësojmë, përshtasim dhe përmirësojmë ndërhyrjet e ardhshme duke i bërë më të efektshme.

Standardi ka funksion lehtësues, sepse jo vetëm ofron udhëzime për përdoruesin se si ta hartojë dhe zbatojë ndërhyrjen, por gjithashtu përmirëson vazhdimisht qëndrueshmërinë e saj dhe ndihmon për përgatitjen e përballjes me të papriturat. Ai

bazohet tek ideja se zgjidhja reagon në mënyrë të padiskutueshme në bazë të një konteksti dhe rezultati mund të ndryshojë në çdo kohë. Standardi ofron një qasje të qëndrueshme, e cila arrin të trajtojë një sërë rrethanash dhe kontekstesh individuale, në mënyrë që të japë rezultatet të cilat janë të arsyeshme në aspektin mjedisor, të barabarta në aspektin shoqëror dhe të realizueshme në aspektin ekonomik, pa mënjeluar asnjërin prej tyre.

8 Kriteret dhe 28 Treguesit u vijnë në ndihmë përdoruesve 1) për të vlerësuar nivelin e cilësimit të një zgjidhjeje të propozuar si ZMN dhe për të identifikuar veprimet të cilat mund të ndërmerren më tej për të forcuar qëndrueshmërinë e ndërhyrjes, duke përdorur sistemin e shkallëzimit: e fuqishme, e përshtatshme, e pjesshme dhe e pamjaftueshme; 2) për të mundësuar hartimin e një zgjidhjeje në bazë të një qëllimi të caktuar dhe në bazë të Kriteve dhe Treguesve, ndërkohë që ndërtohen mekanizmat e menaxhimit të përshtatur për të ruajtur fushën e zbatimit dhe qëndrueshmërinë e zgjidhjes gjatë kohëzgjatjes së saj.

Standardi është krijuar për një numër të madh përdoruesish, veçanërisht për ata jashtë sektorit tradicional të ruajtjes. Ai shoqërohet nga një paketë mjetesh lehtësisht të aksesueshme

dhe të përdorshme për verifikimin, ndërkohë që redaktimet dhe përmirësimet e Standardit mbikqyren nga Komiteti Ndërkombëtar i Standardeve. Në lidhje me këtë, IUCN-ja do të mbështetë krijimin e një komuniteti global përdoruesish të cilët mund të mësojnë së bashku dhe të ndihmojnë për zhvillimin e Standardit.

- Kriteri 1 adreson rëndësinë e identifikimit të qartë të sfidës shoqërore ndaj të cilës reagon zgjidhja. Ndonjëherë, ai mund të mbulojë më shumë se një prioritet kyç. Synimi i këtij kriteri është të sigurojë hartimin e duhur në lidhje me nevojat e mirëqenies së njeriut.
- Kriteri 2 udhëzon hartimin e një ZMN-je në lidhje me aspektet territoriale, të cilat shpesh referohen si qasje e peizazhit.
- Kriteret 3, 4 dhe 5 përkojnë me tre dimensionet kryesore të zhvillimit të qëndrueshëm – qëndrueshmëria mjedisore, barazia shoqërore dhe realizueshmëria ekonomike.
- Kriteri 6 adreson praktikitetin e drejtimit dhe balancimin e kompromiseve, të cilat janë të qenësishme në pjesën më të madhe të vendimmarrjes për menaxhimin e burimeve natyrore, duke përfshirë përshtatjen ndaj nevojave në periudha afatgjata dhe

afatshkurtra. Ai thekson se vendimet për kompromise kryhen me transparencë të plotë, paraqitje publike dhe marrëveshje ndërmjet të gjithë aktorëve të ndikuar.

- Kriteri 7 promovon qasjen e menaxhimit të përshtatur, me anë të të cilit të nxënë të veprimi bashkëplotësojnë njëri-tjetrin në mënyrë që përdoruesi të zhvillojë dhe përmirësojë zgjidhjen.
- Kriteri 8 nxit integrimin brenda politikës kombëtare, e cila është e rëndësishme për të mbështetur qëndrueshmërinë dhe shtrirjen afatgjatë të ZMN-së. Kjo mund të realizohet përmes harmonizimit të politikave, angazhimeve kombëtare dhe globale si dhe mësimave të përbashkëta për të ofruar informacion për zgjidhje të tjera.

Ky Standard u realizua gjatë periudhës kur bota luftonte për të frenuar dhe ndaluar përhapjen e COVID-19. Vëmendje aktualisht i kushtohet rimëkëmbjes ekonomike pas pandemisë. Ndërkohë që drejtuesit e politikës botërore përpiqen të gjejnë mënyra për rimëkëmbje, Zgjidhjet e Mbështetura tek Natyra ofrojnë mundësinë e papërsëritshme për investime në drejtim të mirëqenies së shoqërisë dhe ripërtëritjes së ekonomisë pa u rikthyer tek gabimet e së kaluarës.

Falënderime

Botimi i këtij Standardi është përpjekja e përbashkët e shumë individëve, grupeve dhe rrjeteve të angazhuara. Ne dëshirojmë të falënderojmë të gjithë ata që kontribuan në përgatitjen e këtij raporti. Kontributet teknike u siguruan nga një gamë e gjerë ekspertësh nga Sekretariati i IUCN-së dhe Komisioni për Menaxhimin e Ekosistemit (CEM) [KME]. Në veçanti, ne njohim kontributet e individëve të mëposhtëm - Ali Raza Rizvi, Madhav Karki, Barbara Nakangu, Fabrice Renaud, Lucilla Boito, Stephen N. Edwards, Bernal Herrera, Willem Ferwerda, Jonathan Davies, John Waugh, Mike Jones, Birguy Lamizana, Jenny Springer, Kelvin Passfield, Charles Lor, Wendy Atieno, Rebecca Welling, Anita Tzec, Edmund Barrow, Mirjam Kuzee, Leigh Ann Hurt dhe Jonathan Hughes. Ne falënderojmë ata që dhanë komente mbi versionet e mëparshme të dokumentit, duke përfshirë qindra pjesëmarrës nga 100 vende që morën pjesë në dy fazat e konsultimeve publike duke pasuruar cilësinë dhe fushën e zbatimit të Standardit. Ne veçanërisht falënderojmë kontributet e grupeve nga Komiteti Kombëtar Francez i IUCN-së, Conservation International, Komisioni Botëror i IUCN-së për Zonat e Mbrojtura, Ministria Franceze për Bujqësinë, Qendra Ligjore e Mjedisit e IUCN-së, Koalicioni i Kapitalit Natyror dhe Komisioni Evropian.

Ky Standard është zhvilluar me njohuri teknike dhe udhëzime për vendosjen e standardeve nga Shërbimi Ndërkombëtar i Sigurimit (ASI) [SHNS]. Ne gjithashtu i përcjellim mirënjohjen tonë Marnie Bammert të SHNS-së për kryerjen e recensimit të këtij botimi.

Ne gjithashtu falënderojmë recensuesin tonë të jashtëm Chantal Van Ham për reagimet që kanë rritur shumë cilësinë dhe fushën e zbatimit të këtij botimi.

Falënderime të tjera rezervohen për Caroline Snow për realizimin e botimit, Imre Sebestyén (Unit Graphics) për faqosjen dhe Efrat Bronstein për paraqitjen grafike. Njësia Globale e Komunikacionit të IUCN-së dhe Grupet e Komunikacionit të ZMN-së marrin falënderime për mbështetjen e tyre për komunikimet dhe grafikën.

Raporti u bë i mundur përmes kontributit të Agjencisë Franceze për Zhvillim (AFD) [AFZH], Partneritetit për Zhvillimin e Natyrës Francë-IUCN.

Çdo gabim mbetet përgjegjësi e autorëve kryesorë.

Kontribuesit kryesorë

Ky Standard u zhvillua në mënyrë konsultative, duke u mbështetur në ekspertizën shkencore, redaktuese dhe teknike të shumë njerëzve nga IUCN-ja dhe Komisioni për Menaxhimin e Ekosistemit (CEM). Autorët janë renditur sipas rendit alfabetik, më poshtë.

Andrade, Angela; Cohen-Shacham, Emmanuelle; Dalton, James; Edwards, Steve; Hessenberger, Daisy; Maginnis, Stewart; Maynard, Simone; McElwee, Pam; Murti, Radhika; Nelson, Cara; Ruiz, Verónica; Siikamaki, Juha; Vasseur, Liette.

Lista e shkurtesave

AFD	Agjencia Franceze për Zhvillim
COMPASS	Komuniteti i Standardeve të Qëndrueshmërisë për Zonat e Mbrojtura
CSR	Përgjegjësia Shoqërore e Korporatave
FAQs	Pyetjet që Bëhen Shpesh
INVEST	Vlerësimi i Integruar i Shërbimeve të Ekosistemit dhe Kompromiseve
IPCC	Paneli Ndërqeveritar për Ndryshimet Klimatike
ISBN	Numri Standard Ndërkombëtar i Librit
ISEAL	Akreditimi dhe Etiketimi Ndërkombëtar Shoqëror dhe Mjedisor
IUCN	International Union for Conservation of Nature and Natural Resources
KDB	Konventa për Diversitetin Biologjik
KME	Komisioni për Menaxhimin e Ekosistemit
KQBN	Korniza Qeverisëse për Burimet Natyrore
KSZRF	Korniza Sendai për Zvogëlimin e Rrezikut nga Fatkeqësitë
LKLLK	Lista e Kuqe për Llojet e Kërcënuara
M&V	Monitorimi dhe Vlerësimi
NDC	Kontributet e Përcaktuara në Nivel Kombëtar
NDT	Neutraliteti i Degradimit të Tokës
OBSh	Organizata Botërore e Shëndetësisë
OECD	Organizata për Bashkëpunimin dhe Zhvillimin Ekonomik
ONQ	Organizata Ndërqeveritare
OZHQ	Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm
PBE	Përshtatje e Mbështetur në Ekosistem
PLPI	Pëlqimi i Lirë, Paraprak dhe i Informuar
PNBSHE	Platforma Ndërqeveritare e Politikës Shkencore për Biodiversitetin dhe Shërbimet e Ekosistemit
RPP	Restaurimi i Peizazhit Pyjor
SHNS	Shërbimet Ndërkombëtare të Sigurimit
SKBPV	Strategjitë Kombëtare për Biodiversitetin dhe Planet e Veprimit
SMMSH	Sistemi i Menaxhimit Mjedisor dhe Shoqëror
UN	Kombet e Bashkuara
UNCCD	Konventa e Kombeve të Bashkuara në Luftën Kundër Shkretëtirëzimit
UNDRIP	Deklarata e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Popujve Autoktonë
UNFCCC	Konventa Kornizë e Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike
USD	Dollari Amerikan
ZMN	Zgjidhjet e Mbështetura tek Natyra
ZRF-ME	Zvogëlimi i Rrezikut nga Fatkeqësitë i Mbështetur në Ekosistem

1. Hyrje

“Zgjidhjet e Mbështetura tek Natyra janë veprime për të mbrojtur, menaxhuar në mënyrë të qëndrueshme dhe restauruar ekosistemet natyrore apo të modifikuara, të cilat i adresojnë sfidat shoqërore në mënyrë të efektshme dhe të përshtatshme, për të siguruar si mirëqenien e njeriut ashtu dhe përfitimet e biodiversitetit.”

(IUCN, 2016)

Viti 2020 shënoi rritjen e ndërgjegjësimit për rolin që luan natyra në shoqërinë tonë. Megjithatë, për pjesën më të madhe të shekullit të 20-të, vendimmarrësit e trajtonin ruajtjen e natyrës si çështje dytësore në agjendat kombëtare dhe globale. Në rastin më të mirë, ajo konsiderohej një interes me vlerë, në rastin më të keq, një pengesë ndaj zhvillimit. Megjithatë, rritja e numrit të marrëveshjeve shkencore tregon se pikëpamje të tilla ishin të gabuara dhe se “natyra është thelbësore për ekzistencën e njeriut dhe cilësinë e mirë të jetës”. Mosnjohja e këtij fakti jo vetëm që krijon një model negativ për zhvillimin ekonomik, i cili ndikon në mënyrë të konsiderueshme në humbjen e biodiversitetit, por gjithashtu nuk krijon mundësinë për ta përdorur natyrën në mënyrë të efektshme për të ndihmuar në

zgjidhjen e sfidave kryesore shoqërore të tilla si ndryshimet klimatike, sigurimi i ushqimit, zvogëlimi i rrezikut nga fatkeqësitë, etj. Për këtë qëllim ofrohet mundësia e integritetit të qasjeve të ruajtjes në sektorë të tjerë, duke përfshirë bujqësinë, infrastrukturën, ujin, shëndetësinë, planifikimin urban dhe zhvillimin rural.

Shumica e ekosistemeve janë në gjendje të sigurojnë përfitime të shumta ndaj përfituesve të ndryshëm, kur në të njëjtën kohë mbështetin edhe mbrojnë burimet natyrore bazë. Ky fakt nënkupton se menaxhimi i ekosistemit shpesh është rruga më premtuese përmes të cilës mund të adresohen sfidat shoqërore, duke siguruar rolin e biodiversitetit në “funksionin aktual” brenda sektorëve të tjerë.

1.1 Zhvillimi nga koncepti fillestar në qasjen globale

Qasje të shumta të ruajtjes të zhvilluara që nga viti 1990 dhe në vazhdim, bazohen në menaxhimin e ekosistemeve për një qëllim të caktuar, duke përfshirë Restaurimin e Peizazhit Pyjor, Menaxhimin e Qëndrueshëm të Tokës, Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore, Menaxhimin e Integruar të Peizazhit, Menaxhimin

e Integruar të Zonës Bregdetare, Restaurimin Ekologjik dhe Iniciativën e Përdorimit të Qëndrueshëm të IUCN-së. Qasje të tilla operative kanë qenë në gjendje të paraqesin rezultatet e ruajtjes, të cilat sigurojnë përfitime konkrete ndaj shoqërisë duke përfshirë krijimin e vendeve të punës, përmirësimin e prodhimit të tokës,

kontrollimin e erozionit dhe sekuestrimin e karbonit. Pas secilit prej këtyre termave qëndron baza kërkimore dhe komuniteti i praktikuesve.

Qasjet për ruajtjen (p.sh. mbrojtja, restaurimi dhe menaxhimi i qëndrueshëm) qofshin të pavarura apo të kombinuara me forma të tjera zgjidhjeje (p.sh. teknologjike dhe inxhinierike), mund të zbatohen gjithashtu duke pasur si objektiv kryesor mirëqenien e njeriut. Ky evolucion, të menduarit për ruajtjen, ka çuar në njohjen e dy fushave të gjera të ndërhyrjeve për ruajtjen, ato të cilat kanë si qëllim kryesor mbrojtjen e biodiversitetit për vlerat e tij të brendshme, dhe ato të cilat kanë si qëllim kryesor ruajtjen e shoqërisë – ato që tani njihen me emrin “Zgjidhjet e Mbështetura tek Natyra” (ZMN). Të dyja fushat janë në përputhje me të njëjtin grup të normave dhe parimeve për ruajtjen, dhe në rastet kur ato mbivendosen për nga funksioni, pikat e fillimit janë disi të dallueshme.

Për më tepër, zhvendosja e paradigmës ka çuar gjithashtu në njohjen e faktit se vende

të ndryshme kanë një histori të menaxhimit të natyrës, në mënyra që sjellin përfitime për shoqërinë, pavarësisht se ata nuk përdorën termin ZMN për të përshkruar këto ndërhyrje në atë periudhë. Pavarësisht se të gjitha këto zgjidhje për ruajtjen kanë qenë të dobishme, ato nuk mjaftojnë për të adresuar sfidat aktuale nëse përdoren të veçuara. Komunitetet e praktikuesve dhe kërkuesve kanë kohë që punojnë të veçuar, shpesh duke konkuruar për të njëjtat burime, pavarësisht parimeve, qëllimeve dhe zbatimeve të njëjta të qasjeve për ruajtjen.

Në mënyrë që të rritej vëmendja ndaj potencialit të veprimeve për mbrojtjen lidhur me përdorimin e qëndrueshëm të natyrës për nevojat e njerëzve, u zhvillua koncepti i ZMN-së si pjesë e ndryshimit të vazhdueshëm të paradigmës, i cili filloi në vitin 1980, në të cilin njerëzit shihen më shumë si mbrojtësit, administruesit dhe restauruesit proaktivë të ekosistemeve, sesa përfituesit pasivë të natyrës, duke adresuar një sërë sfidash kryesore shoqërore (Cohen-Shacham et al., 2019). ZMN-të përforcojnë faktin se ruajtja e biodiversitetit



Figura 1: Ndërhyrjet për ruajtjen janë në përputhje me normat dhe parimet për ruajtjen. Njëra fushë e ruajtjes përqendrohet në ndërhyrjet për mbrojtjen e biodiversitetit dhe vlerën e tij të pazëvendësueshme. Fusha tjetër përqendrohet në ndërhyrjet për mbrojtjen e shoqërisë, duke ndjekur vazhdimisht po ato norma dhe parime për ruajtjen. Këto të fundit quhen Zgjidhje të Mbështetura tek Natyra. Meqenëse mes tyre ka mbivendosje, jo të gjitha ndërhyrjet për ruajtjen janë Zgjidhje të Mbështetura tek Natyra. (© IUCN)

dhe mbrojtja e shërbimeve të ekosistemit janë thelbësore për aspektet e ndryshme të mirëqenies së njeriut, duke përfshirë shëndetin e njeriut. Meqenëse ZMN-të trajtojnë sisteme komplekse, ato shkojnë përtej qasjeve tradicionale mekanike për zgjidhjen e problemeve (Rogers et al., 2013). Koncepti i ZMN-ve i ka bazat e tij në Qasjen e Ekosistemit (CBD, 2004; Holling, 1973; Holling, 1978; Holling, 1986; Qaltner – Toews & Kay, 2005), e cila mbështet Konventën për Biodiversitetin Biologjik (KDB) (Smith & Maltby, 2003).

Aktualisht në vitin 2020, komuniteti për ruajtjen dhe sektorët përkatës gjenden në mes të lëvizjes globale për njohjen, promovimin dhe kërkimin e ZMN-ve. Qasja ka përparuar në krahasim me pesë vitet e kaluara, në kohën kur IUCN-ja krijoi termin, duke bërë që ZMN-të të përfshihen në politika, thirrje për projekt-propozime, plane ekonomike, pyetje për kërkime dhe strategji kombëtare për biodiversitetin dhe ndryshimet klimatike. Rritja e këtij vlerësimi dhe investimi solli kërkesën konkrete për përkufizimin e termit dhe krijimin e mundësive për ndërhyrje me kosto të efektshme.

1.2 Zgjidhjet e Mbështetura tek Natyra si korniza kryesore për adresimin e sfidave shoqërore

Zgjidhjet e Mbështetura tek Natyra konsiderohen si korniza kryesore e qasjeve të bazuara në ekosistem (p.sh. konceptet e përmendura më parë) të cilat përdoren për të adresuar sfidat

kryesore shoqërore (Cohen-Shcham et al., 2016) (Shih Figurën 2). Termi “Zgjidhjet e Mbështetura tek Natyra” u promovua nga IUCN-ja në vitin 2009, dhe më vonë u parashtrua si një term



Figure 2: Përkufizimi i Zgjidhjeve të Mbështetura tek Natyra. (© IUCN)



Figure 3: Sfidat kryesore shoqërore të adresuara nga ZMN-të. (© IUCN)

kryesor për të theksuar veçoritë e qasjeve të ndryshme për ruajtjen, duke përfshirë ato të përmendura më parë. Konceptet shtesë, të cilat i përkasin kornizës kryesore të ZMN-ve përfshijnë: Zgjidhjet Natyrore (roli i zonave të mbrojtura në luftën ndaj ndryshimeve klimatike); Përshtatjen e Mbështetur në Ekosistem (PME); Zvogëlimin e Rrezikut nga Fatkeqësitë e Mbështetura në Ekosistem (ZRRF-ME); Infrastrukturën e Gjellbër (për rritjen ekonomike dhe investimet, në kontekstin urban); Infrastrukturën Natyrore (për Menaxhimin e Qëndrueshëm të Integruar të Burimeve Ujore); dhe Menaxhimin e Plotë apo Rigjenerues të Peizazhit. Këto qasje do të vijojnë të jenë tejet të lidhura me zbatimin e ZMN-ve. Ato shërbejnë si qasje specifike operative të cilat mund të përdoren për ekzekutimin e zgjidhjes ndaj një sfide shoqërore. Kombinimi i qasjeve të ndryshme mund të jetë gjithashtu i nevojshëm brenda një ndërhyrjeje, dhe mund të kërkohet që të bashkëplotësohen për të përmirësuar efikasitetin dhe shmangur tepricat e panevojshme.

Në mënyrë që një ndërhyrje të konsiderohet ZMN, ajo duhet të adresojë një ose shumë sfida shoqërore në mënyrë të integruar. IUCN-ja aktualisht i referohet shtatë sfidave shoqërore - përshtatjes dhe zbutjes ndaj ndryshimeve klimatike, zvogëlimit të rrezikut nga fatkeqësitë, shmangies së degradimit të ekosistemit dhe humbjes së biodiversitetit, shëndetit të njeriut, zhvillimit shoqëror dhe ekonomik, sigurimit të ushqimit dhe ujit (Shih Figurën 3). Nëse adresohet sfida shoqërore e degradimit të ekosistemit, duhet të paktën që një sfidë tjetër shoqërore të bëhet pjesë gjatë hartimit të zgjidhjes, për të bërë dallimin e ndërhyrjes ZMN nga një veprim i dedikuar tërësisht për ruajtjen.

Pavarësisht se janë ende në zhvillim e sipër, zgjidhjet ndaj këtyre sfidave shoqërore po gjejnë aktualisht zbatim. Ato mbështeten tek njohuritë shkencore dhe praktikën e mira duke treguar vlerën e ZMN-ve si reagim ndaj sfidave. Ndërkohë që koncepti i ZMN-ve po përgatitet për t'u zbatuar, listës mund t'i shtohen edhe sfida të tjera shoqërore.

1.3 ZMN-të në kontekstin e krizës së biodiversitetit

Platforma Ndërqeveritare për Politikën Shkencore për Biodiversitetin dhe Shërbimet e Ekosistemit (PNBSHE), "Raporti Global i Vlerësimit për Biodiversitetin dhe Shërbimet e Ekosistemit" (PNBSHE, 2019a), paraqet një tablo shumë të

zymtë për biodiversitetin, me një milionë lloje të bimëve dhe kafshëve të kategorizuara si të kërcënuara apo të zhdukura në rang global, dhe rënie të shërbimeve të ekosistemit për shkak të shfrytëzimit të madh dhe keqpërdorimit. Humbja

e shpejtë dhe drastike e biodiversitetit zbeh kapacitetin e ekosistemeve për të kryer shërbimet të cilat janë thelbësore për mirëqenien e njeriut. Ritmet aktuale të humbjes së jovvertebrorëve dhe mikroorganizmave të tokës, përmes praktikave të përdorimit intensiv të tokës, shkaktojnë dëme në jetën e njerëzve. Kontributet e natyrës ndaj njerëzve luajnë rol të rëndësishëm për të mbështetur ekzistencën e njeriut dhe cilësinë e jetës, por shpesh shpërndahen në mënyrë të pabarabartë në kohë dhe hapësirë (PNBSHE, 2019a). PNBSHE raporton se efektet negative nuk janë proporcionale dhe ndikojnë veçanërisht tek njerëzit e marginalizuar dhe autoktonë si dhe tek komunitetet rurale, të cilët e mbështesin mbijetesën e tyre drejtpërdrejt tek përfitimet nga natyra. PNBSHE-ja gjithashtu thekson se ndryshimet klimatike janë shkaku i drejtpërdrejtë i përqendrimit të ndikimit të shkaktarëve të tjerë ndaj natyrës dhe mirëqenies së njeriut (PNBSHE,

2019b); dhe do të jenë shkaku kryesor i humbjes së biodiversitetit në vitet e ardhshme, duke ndikuar tek llojet, habitatet dhe ekosistemet.

Në mënyrë që një zgjidhje të konsiderohet ZMN, është e domosdoshme që ajo të sigurojë njëkohësisht përfitime ndaj biodiversitetit dhe mirëqenies së njeriut. Për rrjedhojë, secila zgjidhje duhet ose të ruajë ose të shtojë biodiversitetin, pa të cilin veprimi nuk mund të klasifikohet si ZMN. Kjo është e rëndësishme për të siguruar shmangien e dëmtimit të integritetit dhe stabilitetit të sistemit natyror nga praktikatat të cilat favorizojnë fitimet afatshkurtra, por vënë në rrezik aftësinë e sistemit për të siguruar brezat e ardhshëm. Për rrjedhojë, meqenëse ruajtja e biodiversitetit është thjesht produkt i ZMN-ve, ajo kthehet në kontribut të rëndësishëm, nëse mirëmbahet apo zgjerohet, duke i dhënë zgjidhjes vlerën e ZMN-së (IUCN, 2016).

1.4 ZMN-të në kontekstin e krizës klimatike

Nga ana tjetër, në Raportin e Panelit Ndërqeveritar për Ndryshimet Klimatike (IPCC) “Ngrohja Globale me 1.5°C”, ofrohen mjaft fakte se si veprimtaritë e njeriut kanë shkaktuar rritjen e ngrohjes globale me afërsisht 1.0°C mbi nivelet para-industriale (IPCC, 2018). Ngrohja Globale pritet të rritet me 1.5°C mes viteve 2030 dhe 2052, duke na vënë përballë një situatë shumë të rrezikshme nëse nuk arrijmë të përmbushim objektivin e përcaktuar në Marrëveshjen e Parisit – për të mbajtur rritjen e temperaturës mesatare globale “vetëm nën 2°C mbi nivelet para-industriale” (Shih Kutinë 1 për shembujt e gjetjeve kryesore). Meqenëse njerëzimi po përballet me pikën kritike katastrofike të klimës, qasjet novatore janë të domosdoshme për bashkëplotësimin e veprimeve për ruajtjen e natyrës; së bashku me ndryshimet e menjëhershme transformuese për të zvogëluar nivelet e emetimit të karbonit duke

kufizuar ngrohjen globale deri në 1.5°C (IPCC, 2018; Rockström et al., 2009; Steffen et al., 2015).

Koncepti i ZMN-së ofron një qasje të integruar, e cila mund të ndihmojë vendet për përmbushjen e objektivave të rëndësishme të marrëveshjeve ndërkombëtare, të tilla si Objektivat e Kombeve të Bashkuara për Zhvillimin e Qëndrueshëm (OZHQ), Marrëveshja e Parisit, Objektivat Aichi, Sfida e Bonit dhe Korniza Sendai për Zvogëlimin e Rreziqeve nga Fatkeqësitë (KSZRF). ZMN-ja u miratua në Samitin e Kombeve të Bashkuara për Klimën në vitin 2019 dhe u theksua në Raportin e veçantë të IPCC-së “Ngrohja Globale me 1.5°C” (de Coninck et al., 2018), Raportin e IPCC-së për Ndryshimet Klimatike dhe Tokën (IPCC, 2019) dhe Raportin Global të PNBSHE-së për Vlerësimin e Biodiversitetit (PNBSHE, 2019a), për mundësinë e



© John Greene – Conservation International



Zgjidhje të Mbështetura tek Natyra

Zgjidhje të Prejardhura nga Natyra

Zgjidhje të Frymëzuara nga Natyra

Figura 4: Ndërkohë që Zgjidhjet e Mbështetura tek Natyra përdorin forcën e ekosistemeve funksionale si infrastrukturë për të siguruar shërbimet natyrore në dobi të shoqërisë dhe mjedisit, zgjidhjet e prejardhura nga natyra dhe zgjidhjet e frymëzuara nga natyra, të cilat janë gjithashtu të domosdoshme për të pasur nivele të ulëta të emetimit të karbonit dhe të ardhme të qëndrueshme, janë të ndryshme. Zgjidhjet e prejardhura nga natyra përfshijnë erën, dallgët dhe energjinë diellore, të gjitha të prejardhura nga natyra dhe ndihmojnë në përmbushjen e nevojave për energji me nivel të ulët të emetimit të karbonit, përmes metodave të prodhimit të prejardhur nga burimet natyrore. Pavarësisht se këto burime të energjisë vijnë nga bota natyrore, ato nuk bazohen drejtpërdrejt në ekosistemet funksionale. Zgjidhjet e frymëzuara nga natyra përfshijnë dizejimin novator dhe prodhimin e materialeve, strukturave dhe sistemeve të modeluara sipas proceseve biologjike dhe të frymëzuara nga natyra. Për shembull, imitimi biologjik është një praktikë e cila mëson dhe imiton strategjitë e gjetura në natyrë për zgjidhjen e sfidave. Këto dizejime e marrin frymëzimin nga natyra - të tilla si dorashka të bëra posaçërisht të ngjithme të cilat imitojnë përshtatjet e ngjitjes së murit nga hardhucat (gecko). Ato nuk bazohen në ekosistemet funksionale.

© John Greene – Conservation International

adresimit të sfidave kryesore globale shoqërore dhe ekologjike.

Meqenëse alarmi për klimën sa vjen e shtohet, njerëzit dhe natyra do të jenë ata që do të cënohen nga ekstremitetet e motit dhe klimës, dhe meqenëse ndikimet do të ndihen në një rajon të caktuar, në përgjithësi njerëzit dhe natyra do të jenë ata që mund të pësojnë ndikime negative më të shpeshta dhe më intensive. Raporti i vecantë i IPCC-së Ndryshimet Klimatike dhe Toka, raporton se shpeshësia më e madhe e ngjarjeve ekstreme të motit dhe ndryshimi i formave të reshjeve tashmë kanë ndikuar në sigurimin e ushqimit në tokë (IPCC, 2019), ndërkohë që në Raportin e Veçantë të IPCC-së Oqeanet dhe Kriosfera raportohet se tkurja e kriosferës që nga mesi i shekullit të 20-të ka ndikuar gjithashtu shumë negativisht tek sigurimi i ushqimit dhe i ujit (IPCC, 2019). Lidhja ndërmjet njerëzve dhe natyrës bëhet e qartë në

përballjen me ndryshimet klimatike. Për shembull, ndryshimet klimatike përkeqësojnë degradimin e tokës, i cili gjithashtu ndikon negativisht tek njerëzit të cilët jetojnë në zona të degraduara (IPCC, 2019). Po ashtu, ndryshimet klimatike përbëjnë një rrezik mjaft të madh për ekosistemet bregdetare të tilla si lëndinat bregdetare apo pyjet me leshterikë, ku humbja e habitateve do të çojë në humbjen e llojeve dhe diversitetit, si dhe në degradimin e funksioneve të ekosistemit (IPCC, 2019) nga i cili varen njerëzit. .

Kjo ndërlidhje mes njerëzve dhe natyrës i jep mundësinë ZMN-ve të adresojnë sfidat e pranishme shoqërore (të tilla si sigurimi i ushqimit) duke kontribuar ndërkohë ndaj përshtatjes dhe zbutjes së klimës. Në Raportin e IPCC-së të vitit 2019, Ndryshimi Klimatik dhe Toka, theksi vihet mbi menaxhimin e qëndrueshëm të tokës, duke përfshirë ruajtjen e ekosistemit

meqenëse ai “mund të kontribuojë në zvogëlimin e ndikimeve negative të shkaktarëve të shumtë për ekosistemet dhe shoqëritë, duke përfshirë ndryshimet klimatike” (IPCC, 2019). Shembujt e përshtatjes së mbështetur në ekosistem, të cilët mund të eliminojnë gazet me efekt serë dhe të kontribuojnë në zbutjen dhe përshtatjen, përfshijnë restaurimin e ekosistemeve natyrore

dhe përmirësimin e ruajtjes së biodiversitetit (IPCC, 2019). Në mënyrë që ngrohja globale të kufizohet deri në nivelin e rritjes me 1.5°C apo nën nivelin e rritjes me 2°C, shoqëria ka nevojë për kombinimin e zgjidhjeve të frymëzuara nga natyra, të prejardhura nga natyra dhe të mbështetura tek natyra, së bashku me zvogëlimin e ndjeshëm të emetimit të lëndëve djegëse fosile (Figura 4).

Kutia 1: Shembujt e gjetjeve kryesore nga raportet kryesore globale (PNBSHE, 2019b; IPCC, 2018, PwC & WWF, 2020):

- Ekosistemet natyrore kanë rënë mesatarisht me 47% në krahasim me vlerësimin e mëparshëm të gjendjes së tyre.
- Afërsisht 25 % e llojeve në pjesën më të madhe të grupeve të studiuara të kafshëve dhe bimëve tashmë kërcënohen me zhdukje, duke sugjeruar se rreth 1 milion lloje tashmë do të përballen me zhdukjen, shumë prej tyre brenda disa dhjetëvjeçarëve, nëse nuk ndërmerret veprim për zvogëlimin e ritmeve të shkaktarëve të humbjes së biodiversitetit.
- Integriteti biotik – dendësia e madhe e llojeve të pranishme natyrore – ka rënë mesatarisht me 23% në komunitetet tokësore.
- Biomasa globale e gjitarëve të egër ka rënë me 82%. Treguesit e dendësisë së llojeve të vertebrorëve kanë pësuar rënie me ritme të shpejta që nga viti 1970.
- 72% e treguesve të zhvilluar nga popujt autoktonë dhe komunitetet lokale tregojnë përkeqësim të vazhdueshëm të elementëve natyrore të rëndësishëm për ta.
- Shumica e objektivave ndërkombëtare shoqërore dhe mjedisore nuk mund të përmbushen përmes trajektoreve aktuale, dhe objektivat për vitin 2030 dhe më tej mund të përmbushen vetëm përmes ndryshimeve transformuese të faktorëve ekonomikë, shoqërorë, politikë dhe teknologjikë.
- Shkaktarët e drejtpërdrejtë me ndikimin më të madh janë ndryshimet në përdorimin e tokës dhe detit; shfrytëzimi i organizmave; ndryshimet klimatike dhe invazioni (përhapja) i llojeve të huaja.
- Veprimet e njeriut përlllogariten të kenë shkaktuar afërsisht 1.0°C të ngrohjes globale mbi nivelet para-industriale, me një ndryshore prej 0.8°C deri në 1.2°C.
- Ngrohja globale ka të ngjarë të arrijë deri në 1.5°C ndërmjet viteve 2030 dhe 2052, nëse ajo vazhdon të rritet me ritmin aktual.
- Ndryshimet klimatike ushtrojnë trysni shtesë mbi tokën, duke përkeqësuar rreziqet ekzistuese ndaj jetesës, biodiversitetit, shëndetit të njeriut dhe ekosistemit, infrastrukturës dhe sistemeve ushqimore.
- Kostot e mosveprimit për humbjen e biodiversitetit janë përlllogaritur në vlerën 4-20 triliardë dollarë amerikanë në vit për shërbime të ekosistemit nga viti 1997 deri në vitin 2011, vetëm nga ndryshimi i mbulesës së tokës, dhe një llogaritje prej 6-11 triliardë dollarë amerikanë në vit nga degradimi i tokës.

Shëndeti i ekosistemeve nga i cili varemi ne dhe të gjitha llojet e tjera, po përkeqësohet me hapa shumë të shpejtë, duke kërcënuar shëndetin e planetit dhe të njerëzve. Ne jemi ata që po dëmtojmë vetë themelet e ekonomive tona, jetëve tona, sigurimit të ushqimit, shëndetit dhe cilësisë së jetës në mbarë botën. Në Raport gjithashtu vërehet se ndryshimet klimatike do të jenë shkaktarët kryesorë të humbjes së biodiversitetit pas vitit 2020. Për këtë arsye, biodiversiteti dhe kriza e ndryshimeve klimatike duhet të analizohen dhe adresohen të dyja njëkohësisht përmes ZMN-ve, të cilat luajnë gjithashtu një rol kyç në realizimin e ndryshimit transformues që kërkohet në përmbytjen e objektivave globale për qëndrueshmërinë.

ZMN-të mund të jenë pjesë e qasjes hierarkike të zbutjes, e cila është korniza e vendimmarrjes në të cilën përfshihen një sërë hapash, duke filluar me shmangien e ndikimeve, të shoqëruar nga minimizimi i ndikimeve të pashmangshme, restaurimeve zonale dhe në përfundim, nëse është e realizueshme dhe e nevojshme, ruajtjen e biodiversitetit. Zbatimi i duhur i hierarkisë së zbutjes mund të kufizojë ndikimet e dëmshme të projekteve të zhvillimit ndaj biodiversitetit dhe mund të ofrojë përfitime shtesë për ruajtjen e biodiversitetit. Megjithatë, zbatimi i papërshtatshëm, veçanërisht nëse kryhet me mangësi të theksuara të njohurive, dhe me politika të dobëta bashkëpunimi, financiare dhe rregullatore, mund të dëmtojë qasjet e krijuara për menaxhimin e rrezikut ndaj biodiversitetit.

1.5 ZMN-të në kontekstin e krizës së gjithëpërfshirjes

Ndërhyrjet mund të jenë të suksesshme vetëm nëse përfshihen sistemet e ndryshme të njohurive dhe pjesëmarrja e grupeve të ndikuara, duke përfshirë popujt autoktonë, komunitetet lokale, gratë dhe rininë. Megjithatë, për fat të keq ky nuk ka qenë gjithmonë rasti në historinë e nismave për ruajtjen, duke shkaktuar një krizë gjithëpërfshirjeje së bashku me atë të biodiversitetit dhe klimës. ZMN-të, për shkak të qasjes së tyre ndërsektoriale dhe mënyrës së integruar sipas të cilës zbatohen, përfitojnë shumë nga pjesëmarrja e aktorëve të ndryshëm të cilët mund të ndikohen direkt apo indirekt nga ndërhyrja, dhe përfshijnë lloje të ndryshme të sistemeve të njohurive dhe pikëpamjeve botërore, të tilla si ato të pranishme në njohuritë ekologjike tradicionale apo autoktone. Për shembull, përpjekjet ekzistuese për t'u përshtatur në Rajonet Polare kanë përfituar nga përfshirja e njohurive autoktone dhe lokale, të tilla si trendët dhe vijat e ndryshimeve të peizazhit

tokësor/detar dhe shëndeti dhe popullatat e llojeve (IPCC, 2019).

Kur merret parasysh diversiteti i aktorëve të pranishëm në ZMN, duhet gjithashtu të sigurohet pjesëmarrje aktive, gjithëpërfshirëse dhe transparente, pavarësisht gjinisë, moshës apo formimit shoqëror, ekonomik apo kulturor, dhe vendimmarrja në ZMN duhet të jetë transparente dhe e barabartë për mbrojtjen e njerëzve dhe kulturës. Kjo është gjithashtu e rëndësishme në mënyrë që përfitimet e ofruara nga ZMN-të të jenë të plota. Aspektet të cilat mund të ndikojnë dhe anashkalojnë proceset e përdorura në ZMN janë subjektiviteti kulturor dhe perspektivat elitare. Në rastet kur grupet e aktorëve kanë një peshë të barabartë (p.sh. aktorët ruralë dhe joruralë), perceptime të tilla mund të bëjnë që grupe të caktuara të mos i përfillojnë kontributet e klasave shoqërore më të ulëta apo anëtarëve të shoqërisë më pak të arsimuar. Situata të tilla mund të kufizohen dhe përmirësohen përmes

diskutimeve dhe bashkëpunimeve konstruktive të ndërmjetësuara, procese të cilat janë kyçe për zbatimin e një ZMN-je.

Veçanërisht popujt autoktonë dhe komunitetet lokale, ruajnë dhe menaxhojnë një pjesë të rëndësishme të rajoneve të Tokës më biodiversë, duke luajtur një rol të rëndësishëm për ruajtjen e tokave, deteve dhe burimeve, si dhe për përdorimin e qëndrueshëm të tyre. Ata kanë marrëdhënie të forta ekonomike, kulturore dhe shpirtërore me mjediset e tyre natyrore dhe shpesh zhvillojnë dhe ruajnë praktikën dhe njohuritë e menaxhimit tradicional të cilat kontribuojnë në ruajtjen e biodiversitetit dhe përdorimit të qëndrueshëm të burimeve natyrore. Për shembull, Zonat e Mbrojtura Autoktone, ku respektohen përdorimet tradicionale dhe të qëndrueshme të burimeve natyrore, mund të përfaqësojnë një ZMN e cila do të përfitojë nga mbijetesat e njohurive tradicionale dhe komuniteteve autoktone. Po ashtu administratorët e tokave rurale, qofshin apo jo autoktonë, do të jenë më të informuar në krahasim me çdokënd tjetër për tokën të cilën ata administrojnë.

Pavarësisht se cili grup aktorësh është i angazhuar, në përbërjen e tij do të ketë gjithmonë praninë e një komponenti gjinor, prandaj ndjekja e qasjes së reagimit gjinor është një parakusht për zhvillimin e qëndrueshëm. Përfshirja e grave në ZMN mbështet zbatimin e këtyre zgjidhjeve, meqenëse ruajtja e natyrës dhe të drejtat e grave lidhen pazgjidhshmërisht. Për shembull, degradimi i mjedisit përkeqëson dhunën kundër grave, dhe ndjekja e qasjes së

reagimit gjinor për ZMN-të mund të kontribuojë si për biodiversitetin ashtu edhe për krizën e gjithëpërfshirjes. Ndërkohë, studime të shumta tregojnë se angazhimi i grave sjell njohuritë e tyre të papërsëritshme në lidhje me menaxhimin e burimeve natyrore. Përfshirja e balancuar gjinore në drejtimin e ZMN-ve si dhe pjesëmarrja e barabartë e grave sjell më shumë përfitime për natyrën dhe për rrjedhojë edhe për njerëzit.

Vitet e fundit rinia, përveç rolit që ka pasur për të ushtruar ndikim dhe rritur vizibilitetin e ZMN-ve, ka shtuar dhe bërë të dukshme edhe veprimet në lidhje me ruajtjen. Kontributi i fëmijëve dhe i rinisë është konkret për zgjidhjen e sfidave shoqërore, duke theksuar në këtë mënyrë barazinë e kërkuar ndërmjet brezave. Ndërhyrjet të cilat i kushtojnë më shumë vëmendje kostove dhe përfitimeve afatshkurtra por nuk arrijnë të marrin parasysh kostot, përfitimet dhe kompromiset afatgjata, përfundojnë si të paqëndrueshme; përfshirja e rinisë në ndërhyrje sjell vlerësimin dhe mirëkuptimin mes brezave dhe ka për rrjedhojë një ndikim më afatgjatë dhe të qëndrueshëm. Me rëndësi të veçantë janë rastet kur mungon vëmendja e duhur për mbrojtjen, përfshirjen dhe fuqizimin e rinisë në lidhje me zgjidhjet e ndryshimeve klimatike, dhe ndër 160 Kontributet e Përcaktuara në Nivel Kombëtar (NDC) përfaqësimi i rinisë rezulton me tetë të tilla, duke theksuar trajtimin e padrejtë ndërmjet brezave apo brezave të ardhshëm. Përfshirja e rinisë në lëvizjen globale në mbështetje të ZMN-ve, jo vetëm mbështet qëndrueshmërinë e këtyre ndërhyrjeve por adreson përfitimet e mundshme ndaj përshtatjes dhe zbutjes së klimës përmes edukimit të rinisë.

2. Prezantimi i Standardit Global të IUCN-së për ZMN-të

2.1 Nevoja për një Standard Global

Përdorimi i gjerë i konceptit ZMN në ditët e sotme ka bërë që të rritet nevoja për marrjen e informacionit në lidhje me kuptimin e qartë, komunikimindhezbashkimetduhurdëkonceptitpër të vënë në funksion të Parimet e parashtruara për ZMN-të (IUCN, 2016). Standardet e praktikës janë metoda e zakonshme për të arritur këto objektiva ndërkohë që fushat e praktikës zhvillohen. Për më tepër, pavarësisht se ZMN-të luajnë një rol bashkëplotësues për ruajtjen e natyrës, objektivi i tyre kryesor është adresimi i një apo më shumë sfidave shoqërore në dobi të biodiversitetit dhe mirëqenies së njeriut. Ky dallim është shumë i rëndësishëm për të siguruar se 1) veprimet për ruajtjen do të vazhdojnë të kryhen për përmbushjen e objektivave të ndalimit apo shmangies së humbjes së biodiversitetit, aty ku është e nevojshme, dhe 2) veprimet për ruajtjen hartohen në mënyrë të qëllimshme dhe informuese për një apo më shumë sfida shoqërore, duke kërkuar partneritete novatore dhe integrimin e qasjeve të shumta (të tilla si bashkëplotësimi me infrastrukturën gri, d.m.th. zgjidhjet hibride).

Për rrjedhojë, rritja e interesit global për ZMN-të, parashtron kërkesën për të ofruar një Standard të posaçëm dhe të qëndrueshëm i cili informon

hartimin dhe zbatimin e çdo ZMN-je, dhe përmes këtij Standardi bëhet i mundur:

- Kuptimi dhe interpretimi i konceptit të ZMN-së ndërmjet sektorëve, përdoruesve dhe pozicioneve gjeografike të ndryshme;
- Përdorimi i ZMN-ve në mënyrë sistematike, të bashkërenduar me sektorët, përdoruesit dhe pozicionet gjeografike të tjera të ndikuara;
- Kontrollimi cilësor për hartimin dhe ekzekutimin e ndërhyrjeve përmes proceseve të Standardizuara të cilat mundësojnë llogaridhënien;
- Përdorimi i mjeteve, qasjeve dhe metodave ekzistuese të dedikuara tërësisht për hartimin dhe ekzekutimin e një zgjidhjeje;
- Zvogëlimi i rreziqeve në lidhje me përdorimin e mëtejshëm të natyrës dhe mosklasifikimi si ZMN i veprimeve shumë të dëmshme për biodiversitetin dhe shoqërinë; dhe
- Angazhimi i sektorëve të shumtë në zbatimin dhe adresimin e sfidave shoqërore.

Në këtë mënyrë, ZMN-të ofrojnë kontributin e tyre ndaj ndryshimeve transformuese, duke u kthyer në elementë të pranishëm në planifikimin dhe zbatimin e reagimeve të shoqërisë ndaj sfidave të tilla.

2.2 Fusha e Zbatimit të Standardit

Standardi Global i IUCN-së për ZMN-të është një koncept gjithëpërfshirës i përdorimit të gjerë, i cili mund të ekzekutohet përmes qasjeve dhe mjeteve ekzistuese të ekosistemit, veçanërisht atyre të cilat janë operative dhe gjithëpërfshirëse. Për rrjedhojë, interpretimi dhe zbatimi i konceptit të ZMN-së është mjaft specifik për nga konteksti, në varësi të një sërë faktorësh të cilët ndikojnë në sfidat shoqërore të adresuara, duke përfshirë llojet e ekosistemit të peizazheve tokësore/ detare në të cilat zbatohen ZMN-të, sistemin shoqëror dhe ekonomik dhe përbërjen dhe lidhjet e grupeve të interesit. Duke u nisur nga ky fakt, Standardizimi i proceseve për hartimin dhe ekzekutimin e ZMN-ve është realizuar duke shmangur përshtatjen Standard të një rezultati sa herë zbatohet një zgjidhje. Për rrjedhojë, Standardi Global për ZMN-të është një Standard me funksion lehtësues, i cili synon të bëjë të

mundur përdorimin e tij në shkallë të gjerë dhe të përmirësojë hartimin dhe ekzekutimin e proceseve më shumë sesa rregullimin e tyre për të arritur rezultatet apo pritshmëritë e caktuara. Procesi i zbatimit të Standardit të ZMN-ve është parashikuar gjithashtu si mjet për të siguruar fakte në lidhje me adresimin e ndryshimeve mjedisore dhe shoqërore gjatë periudhave kohore, dhe për të kontribuar në përmirësimin e zhvillimit të politikave.

Standardi u jep mundësinë praktikuesve të Standardizojnë hartimin dhe zbatimin e ZMN-ve, duke: 1) Përcaktuar bazën e përbashkët të të kuptuarit se për çfarë shërben apo jo një ZMN; 2) Kontribuar ndaj ndryshimeve transformuese, duke përmirësuar praktikën e ZMN-ve dhe duke mbështetur qartësimin dhe zhvillimin e politikës së zhvillimit në lidhje me ZMN-të.

2.3 Përdorimi dhe publiku i synuar

Standardi është planifikuar të përdoret nga të gjithë ata që punojnë me verifikimin, hartimin dhe shkallëzimin e ZMN-ve. Në grupin e përdoruesve mund të përfshihen menaxherët e projekteve në sektorin publik dhe privat, planifikuesit e peizazhit, praktikuesit e zhvillimit dhe ruajtjes, qeveritë apo përfaqësuesit e sektorit të financës (donatorët dhe investuesit), politikëbërësit dhe planifikuesit. Në këtë fazë, Standardi ka dy funksione – të ndihmojë udhëzimin për hartimin e ZMN-ve dhe të sigurojë mjetin për verifikimin e përmbushjes së kërkesave për hartimin e Standardit të ZMN-ve.

- **Hartimi** – tetë Kriteret e orientuara drejt procesit reagojnë ndaj aspekteve më të rëndësishme të hartimit (dhe ekzekutimit të ardhshëm) në mënyrë që ndërhyrja të

cilësohet si ZMN. Si të tilla, Kriteret reagojnë ndaj ciklit të menaxhimit të projektit, duke theksuar aspektet më të rëndësishme dhe duke menduar përtej hapësirës gjeografike dhe afateve kohore të projektit dhe nevojës për të praktikuar menaxhimin e përshtatur, meqenëse hartimi i ZMN-ve bazohet në teorinë e ndryshimit e cila pa dyshim përmban supozimet që do të testohen gjatë zbatimit.

- **Verifikimi** – kur hartohet zgjidhja, Standardi mund të përdoret për të provuar nëse ajo mund të cilësohet apo jo si ZMN. Ky funksion i Standardit është i rëndësishëm për përdorues të tillë si financuesit dhe investuesit, të cilët bëjnë thirrje për prezantimin e zgjidhjes. Për më tepër, ZMN-

të e së shkuarës dhe të tashmes, të cilat paracaktojnë zhvillimin e këtij Standardi, mund të vlerësohen gjithashtu në bazë të Kriteve të Standardit, nëse synohet që ndërhyrja të njihet si ZMN.

- **Shkallëzimi** – disa shembuj të ZMN-ve mund të jenë në përputhje me pjesën më të madhe të tetë Kriteve të Standardit, pavarësisht se nuk i përmbushin disa prej tyre. Shumica e tyre mund të jenë projekte pilote apo ndërhyrje të cilat kanë një afat kohor të kufizuar ose përfaqësojnë një qasje të veçantë. Standardi mund të përdoret qoftë për të identifikuar ndërhyrje të qenësishme të cilat mund të shkallëzohen, ashtu edhe

për të shndërruar ndërhyrjet në mënyrë të tillë që të përkufizohen si ZMN të forta.

Për më tepër, Standardi faktikisht është hartuar për t'u përdorur si proces vetëvlerësimi apo verifikimi nga pala kryesore. Në përputhje me qasjen e Standardit për lehtësimin e procesit për përdorimin e gjerë të konceptit ZMN, vetëvlerësimi ofron aktualisht një qasje sa të qëndrueshme aq dhe elastike për të hartuar dhe ekzekutuar zgjidhje të tilla. Meqenëse bota është në fazën e të kuptuarit dhe interpretimit të ZMN-ve për nevoja dhe kontekste të ndryshme, Standardi ofron hapësira për të nxënë dhe reflektimin e ripërsëritur kundrejt procesit të ngurtë normativ të certifikimit.

3. Procesi për zhvillimin e përbashkët të Standardit Global

3.1 Bazat e kornizës së përkufizimeve të IUCN-së për Zgjidhjet e Mbështetura tek Natyra

Objektivi kryesor i ZMN-ve është të mbështetë përmbushjen e objektivave të zhvillimit shoqëror dhe mbrojtjen e mirëqenies së njeriut, në mënyra të cilat pasqyrojnë vlerat kulturore dhe shoqërore dhe rrisin aftësinë ripërtëritëse të ekosistemeve, aftësinë e tyre për rimëkëmbje dhe sigurimin e shërbimeve (IUCN, 2016). Së bashku me kornizën e përkufizimeve të IUCN-së për ZMN-të të publikuar në vitin 2016, në të cilën ZMN-ja u përkufizua si “Veprime për të mbrojtur, menaxhuar në mënyrë të qëndrueshme dhe restauruar ekosistemet natyrore apo të

modifikuara, të cilat trajtojnë sfidat shoqërore në mënyrë të efektshme dhe të përshtatshme, duke siguruar njëkohësisht mirëqenien e njeriut dhe përfitimet për biodiversitetin” (IUCN, 2016), u miratuan tetë Parimet nga anëtarët e IUCN-së (IUCN, 2016) siç tregohen në Figurën 5. Që atëherë, u krijua me shpejtësi një bazë e fortë e literaturës së botuar, e cila mbështet më tej rolin e ZMN-ve për ruajtjen.

Sipas një analizimi të fundit të Parimeve të ZMN-ve (shih më lart) u zbulua se korniza e ZMN-ve




Figura 5: Lidhja ndërmjet Parimeve dhe Kriteve të Standardit të ZMN-ve. (© IUCN)

shkon përtej qasjeve të tjera të ngjashme (p.sh. Restaurimit të Peizazhit Pyjor (RPP); QME (Qasjes së Mbështetur në Ekosistem); restaurimit ekologjik; Qasjes së Ekosistemit) përmes tre Parimeve të saj (2, 6 dhe 8, d.m.th., për sinergjitë e ZMN-ve me lloje të tjera zgjidhjeje, zbatimin

në bazë të shkallës së peizazhit tokësor/detar dhe integritit në politikë). ZMN-ja për rrjedhojë mund të shërbejë si kornizë kryesore për një sërë qasjesh të krijuara siç duhet, të bazuara në ekosistem dhe të lidhura me ekosistemin (Cohen – Shacham et al., 2019).

3.2 Vështrim i përgjithshëm i procesit të përbashkët të zhvillimit

Përmes rolit ndërmjetësues të IUCN-së u realizua hartimi i përbashkët i Standardit për ZMN-të, duke bashkuar njohuritë e ekspertëve, aftësitë dhe përvojat e një numri të madh të aktorëve të përfshirë. Burimet e shumta për hartimin e Standardit kanë qenë të rëndësishme për shkak se ZMN-ja është temë ndërsektoriale dhe për këtë arsye kërkon integrimin me fusha të ndryshme të dijeve (p.sh. ekologjinë, shkencat sociale, shkencat politike, matematikën dhe ekonominë) dhe forma të dijeve të ndryshme (p.sh. dije me bazë përvojë, njohuri shkencore dhe njohuri tradicionale) për të siguruar informacionin mbi praktikën e mirë. Në dy raundet e konsultimeve publike pati një pjesëmarrje nga 100 vende të cilët ofruan më shumë se 800 reagime (sektorët publikë dhe privatë, si edhe organizatat joqeveritare).

Sondazhet e konsultimit u përcollën ndaj të gjithë anëtarëve të IUCN-së, partnerëve, duke përfshirë kompanitë ndërkombëtare, rrjetet e koalicionit dhe donatorët. Për më tepër, Komisioni për Menaxhimin e Ekosistemit (KME) dha kontributin për shqyrtimin shkencor të koncepteve kryesore, të Kriterëve dhe Treguesve, përmes katër komiteteteve drejtuese, të cilët u takuan në dy takime pune në Uashington DC me pjesëmarrjen e anëtarëve të shumtë të

ekipit drejtues. Kontributet u përftuan në formë të shkruar apo përmes diskutimeve ballë për ballë me grupet e interesit. Të gjithë kontributet e konsultimeve me publikun e gjerë arritën të sigurojnë informacionin e duhur dhe të përcaktojnë fushën e zbatimit dhe përmbajtjen e Standardit. Versioni përfundimtar i Standardit u miratua në takimin e 98-të të Këshillit të IUCN-së. [Standardi](#) u botua nga IUCN-ja në vitin 2020.

Në lidhje me metodën teknike për zhvillimin e Standardit, hapi i parë ishte hartimi i tetë Parimeve të ZMN-ve, të miratuara përmes Rezolutës [WCC \(Kongresi Botëror për Ruajtjen\) -2016-Res-069-EN](#) (IUCN, 2016) nga anëtarët e IUCN-së, në bazë të trembëdhjetë Standardeve ekzistuese përkatëse, qasjeve dhe udhëzimeve për kornizat e menaxhimit të ekosistemit. Parimet e përbashkëta dhe mangësitë e kornizave u identifikuan për të krijuar qoftë bazat e përbashkëta të ZMN-ve ashtu edhe elementët unikë të ZMN-ve, për të lejuar zhvillimin e një Standardi të IUCN-së. Në bazë të kësaj metode, fillimisht u zhvilluan shtatë Kriteret për konsultimin e brendshëm, duke përdorur ekspertizën dhe përvojën e IUCN-së. Në bazë të shqyrtimeve dhe konsultimeve vijuese u krijuan tetë Kriteret për ZMN.

3.3 Kodi ndërkombëtar për standardet e qëndrueshmërisë

Që në hapat e parë të procesit për zhvillimin e Standardit, IUCN-ja u angazhua për të harmonizuar zhvillimin e Standardit Global të IUCN-së për ZMN-të, sa më shumë të ishte e mundur, me Kodin e Praktikës së Mirë: Përcaktimi i Standardeve Shoqërore dhe Mjedisore të zyrës së Akreditimit dhe Etiketimit Ndërkombëtar Shoqëror dhe Mjedisor (ISEAL). Ky version i Standardit Global të IUCN-së për ZMN-të bazohet tek mësimet e nxjerra gjatë konsultimeve publike në rang global të zhvilluara përgjatë vitit 2018 dhe 2019.

Kriteret dhe Treguesit e Standardit Global të IUCN-së për ZMN-të renditen në të njëjtën mënyrë siç u miratuan në Takimin e 98-të të Këshillit të IUCN-së më 2020. Udhëzuesi për përdorimin e Standardit Global të IUCN-së për ZMN-të, shoqëron këtë libër për të ofruar bazën shkencore dhe udhëzimet për përdoruesit. Një tjetër dokument i mëvonshëm, Pjesa III, do të shërbejë si manual i përdorimit, i bazuar në mësimet nga projektet pilote dhe i lidhur me një mjet vetëvlerësimi me sugjerime për mjetet e verifikimit dhe mjetet e hartimit dhe zbatimit.

4. Udhëzuesi për Kriteret

4.1 Përmbledhje

Standardi përbëhet nga tetë Kriteria, secili me një grup Treguesish. Kriteret bazohen mbi Parimet e ZMN-ve si dhe reagimin e marrë nga konsultimet.

Kriteri 1 parashtrohet procesin për përcaktimin e sfidës(ave) shoqërore me të cilën përballen aktorët dhe mbajtësit e të drejtave, si dhe ndihmon për kuptimin e mundësive dhe sfidave përkatëse. Hartimi i zgjidhjes synon të adresojë sfidën, duke marrë parasysh kontekstet më të gjera shoqërore, ekonomike dhe ekologjike në të cilat ekzistojnë sfida dhe zgjidhja, si në Kriterin 2. Kriteri 2 parashtrohet idenë se pavarësisht se ekzekutimi i zgjidhjes kryhet në nivelin e një

zone apo një shkalle më të vogël, rezultatet e nivelit apo të shkallës më të madhe mund të ofrojnë informacion për qëndrueshmërinë dhe kohëzgjatjen e zgjidhjes, përtej zbatimit të saj. Kriteret 3, 4 dhe 5 parashtrojnë proceset të cilat mund të rrisin mundësitë për realizimin e rezultateve pozitive për biodiversitetin, shoqërinë dhe ekonominë. Megjithatë, në mënyrë që të përmbushen këto tre Kriteria në lidhje me rezultatet e menjëhershme, afatshkurtra dhe afatgjata, duhet të përcaktohen dhe të bëhen kompromiset, të cilat parashtrohen në mënyrë të drejtpërdrejtë në Kriterin 6, me qëllim që kjo çështje të ketë peshën dhe qartësinë e duhur. Proceset e vendimmarrjes për çdo kompromis të kryer, duhet të jenë transparente dhe të barabarta, dhe të realizohen brenda kontekstit të një apo më shumë aspekteve të Kriteriave 3, 4 dhe 5. Për më tepër, parimet e menaxhimit të përshtatur të mbështetura në teorinë e ndryshimit dhe në proceset e të nxënësimit ripërsëritës, mund të rrisin mundësinë për suksesin e ZMN-ve. Kriteri 8 përqendrohet në proceset e integritetit të ZMN-ve në shkallët territoriale dhe kohore, ku veprimet dhe ndikimet të ndihen edhe pas përfundimit të projekteve, në mënyrë që roli i natyrës të kuptohet si mjeti i sigurimit të zgjidhjeve ndaj sfidave shoqërore.

Nëndarjet e mëposhtme ofrojnë udhëzime për tetë Kriteria e Standardit të ZMN-së dhe Treguesve të tyre përkatës. Udhëzuesi përshkruan elementët e ZMN-së së efektshme dhe identifikon gjithashtu mënyrën se si Kriteret dhe Treguesit e ndryshëm janë të lidhur me njëri-tjetrin.




Figura 6: Tetë Kriteria të cilat përbëjnë Standardin Global të IUCN-së janë të gjitha të ndërlidhura (©IUCN)

Kriteri 1: ZMN-të i adresojnë sfidat shoqërore në mënyrë të efektshme

ZMN-të duhet të hartohen për të adresuar në mënyrë të efektshme dhe efikase sfidat e caktuara shoqërore. Këto përfshijnë përshtatjen dhe zbutjen e ndryshimeve klimatike, zvogëlimin e rrezikut nga fatkeqësitë, degradimin e ekosistemit dhe humbjen e biodiversitetit, shëndetin e njeriut, zhvillimin shoqëror dhe ekonomik, sigurimin e ushqimit dhe sigurimin e ujit. Tre lloje kryesore të veprimeve të efektshme të ruajtjes mund të përdoren (të veçuara apo të kombinuara) për të adresuar sfidat shoqërore – ruajtja përmes mbrojtjes, restaurimi dhe veprimtaritë restauruese dhe përdorimi i qëndrueshëm. Hartimi ka për qëllim të arrijë rezultatet e caktuara të cilat vijnë nga adresimi i drejtpërdrejtë dhe i qartë i sfidave shoqërore dhe përmbushja e kërkesave shoqërore, duke ruajtur funksionet e ekosistemit.

Përpara se të nisë ndërhyrja duhet të kuptohen kushtet e rëndësishme shoqërore, ekonomike dhe mjedisore. Ky hap shërben për vlerësimin dhe kuptimin e duhur të llojit të sfidës së adresuar dhe përshtatjes së ZMN-së së propozuar, duke matur nivelet e përmirësimit në kohë. Gjendja fillestare mund të jetë analizimi i situatës përmes informacionit në literaturën zyrtare dhe jozyrtare. Për rrjedhojë, gjendja fillestare nis të zhvillohet përmes konsultimeve me aktorët përkatës, përfituesit e synuar dhe aktorë të tjerë si p.sh. agjencitë qeveritare, kompanitë e sektorit privat, akademikët dhe shkencëtarët me ekspertizë për klimën dhe ekologjinë e zonës, si dhe autoritetet rajonale me mandatin e duhur për zonën e synuar.

Pavarësisht se ZMN-të përqendrohen në adresimin e sfidave shoqërore, veprimtaritë e përcaktuara duhet gjithashtu të ruajnë dhe të rrisin shërbimet e ekosistemit, duke mirëmbajtur strukturën e ekosistemit, funksionin dhe përbërjen (shih Kriterin 3). Në këtë mënyrë

ruhet integriteti dhe stabiliteti i sistemit ekologjik dhe për rrjedhojë përmirësohen ndikimet afatgjata të ZMN-së(ve) së përcaktuar(a) për të adresuar sfidën(at) shoqërore. ZMN-ja e cila thjeshton strukturën, funksionin dhe përbërjen e ekosistemit, zbeh aftësinë e tij ripërtëritëse, dhe në fund priret të dështojë pavarësisht se mund të ketë disa rezultate afatshkurtra. Qasjet e plota, të cilat shtrihen për shumë vite kanë mundësi më të mira për sukses.

K-1.1 Sfidat shoqërore më të rëndësishme për mbajtësit e drejtave dhe përfituesit kanë prioritet

Ndërkohë që ZMN-të mund të sjellin përfitime të shumta për një sërë sfidash shoqërore, ndërhyrjet e ZMN-ve duhet të përqendrohen vetëm tek të paktën një (ose më shumë) sfida të caktuara shoqërore.

Për identifikimin e sfidës shoqërore duhet të përdoret një proces transparent dhe gjithëpërfshirës (Kriteri 5). Kjo ndodh për shkak se atë që aktorët e jashtëm mund ta perceptojnë si sfidë prioritare, popullsia vendase mund të mos ta gjykojë si më të rëndësishme, apo e anasjelltë. Për rrjedhojë, proceset e përshkruara në Kriteret 5 dhe 7 japin informacion për vendimmarrjen. Për më tepër, me rëndësi është fakti se për shkak të ndikimeve të ndërlidhura të sfidave shoqërore ndaj aktorëve lokalë, zgjidhja e një sfide shoqërore të veçantë mund të kërkojë gjithashtu adresimin e një sfide tjetër. Për shembull, në disa komunitete, mund të jetë e pamundur të punohet nën ndikimet afatgjata të ndryshimeve klimatike nëse komuniteteve u mungon kapaciteti të përballojnë fatkeqësi sezonale apo madje të kenë një vend të sigurt për të jetuar. Po ashtu, nëse sfidat shoqërore dhe kulturore të tilla si punësimi apo çështjet e pronësisë mbi tokën,

nuk adresohen sic duhet, do të jetë e vështirë të kuptohen pikat e rëndësishme. Për të siguruar ndryshimin transformues i cili do të përçohet edhe tek brezat e ardhshëm, është e nevojshme të përdoret qasja e Teorisë së Ndryshimit. Referencat dhe mjetet për zhvillimin e teorisë së ndryshimit do të ofrohen si informacion bashkëplotësues i këtij Standardi.

K-1.2 Sfida(t) shoqërore e adresuar kuptohet dhe dokumentohet qartë

Ndërhyrja nëpërmjet ZMN-ve duhet të adresojë sfidat shoqërore të cilat ndikojnë drejtpërdrejt tek një grup i caktuar njerëzish (p.sh. ZMN-të për të kontrolluar erozionin bregdetar i cili rrezikon një njësi vendore të caktuar) apo ndikojnë indirekt ndaj shoqërisë si një e tërë (p.sh. ZMN-ja për sekuestrimin e karbonit si mundësi për zbutjen e klimës). Megjithatë, ndërhyrja nëpërmjet ZMN-ve për një sfidë të caktuar shoqërore sjell shpesh përfitime të shumta shoqërore, të tilla si krijimi i vendeve të punës, përfitime të tjera ekonomike dhe, nëse shihet e arsyeshme, këto përfitime shtesë të adresimit të sfidave shoqërore duhet të përshkruhen, dokumentohen dhe justifikohen.

Po ashtu, jo të gjitha ndërhyrjet për ruajtjen apo restaurimin mund të konsiderohen automatikisht si ZMN. Ndërkohë që përmes ndërhyrjeve për ruajtjen mund të përfitohen (direkt apo indirekt) përfitime shoqërore shtesë, shumica e tyre nuk janë hartuar apo menaxhuar me qëllimin

e sigurimit të përfitimeve të tilla. Në mënyrë që ndërhyrja ekzistuese për ruajtjen të zgjerohet apo shndërrohet në ZMN, kërkohet që mandati dhe plani i menaxhimit të ndryshohen për t'u përshtatur me kriteret dhe objektivat e ZMN-së së bashku me evidentimin e gjendjes fillestare të domosdoshme për të matur dhe mbajtur përgjegjësi për zbatimin. Kriteri 7 (Menaxhimi i Përshtatur) do të udhëzojë veçanërisht se si të kryhet shndërrimi i një veprimi për ruajtjen në një ndërhyrje ZMN-je.

K-1.3 Rezultatet për mirëqenien e njeriut që vijnë nga ZMN-të identifikohen, krahasohen dhe vlerësohen në mënyrë periodike

Në mënyrë që ndërhyrja të sjellë përfitime për mirëqenien e njeriut, duhet të krijohen objektivat përkatëse (shih Fjalorin për përkufizimin e mirëqenies së njeriut). Kjo ndihmon për të bërë dallimin ndërmjet veprimeve për ruajtjen dhe ZMN-të (Treguesi 1.1). Në një situatë ideale, do të preferohej zhvillimi i objektivave për zbatimin dhe ndikimet e ndërhyrjes. Pavarësisht se ndikimet e ZMN-ve mund të realizohen përtej kufirit kohor të ndërhyrjes, mund të zhvillohen gjithashtu edhe objektiva treguese apo momente referimi. Objektiva apo momente të tilla referimi mund të nxitin investimet afatgjata për mirëmbajtjen e ZMN-ve dhe do të shërbejnë për monitorimin afatgjatë të ndërhyrjes.

Kriteri 2: Hartimi i ZMN-ve informohet në bazë të shkallës

ZMN-të e suksesshme hartohen duke pasur parasysh ndërveprimet të cilat kryhen në shkallë të ndryshme shoqërore dhe ekologjike brenda një peizazhi tokësor apo detar - për shembull, lëvizja sezonale e komunitetit të blektorëve apo emigrimi sezonal i djemve të rinj nga zonat rurale drejt tregut të punës në një qytet të largët apo remitancat nga anëtarët e familjes që jetojnë jashtë vendit. Nëse hartimi i projektit nuk i njeh ndërveprimet midis shkallëve, ato mund të shkaktojnë veprime të zhvendosura, duplikime, konflikte dhe dështime të projektit.

Me rëndësi është të kuptohet se si organizohen dhe ndërveprojnë ekosisteme të ndryshme brenda të njëjtës zonë (peizazh). Në secilën fazë të zhvillimit dhe ekzekutimit të ZMN-së, duhet të merret parasysh peizazhi më i gjerë tokësor/detar. ZMN-të duhet të konceptohen brenda shkallës së peizazhit tokësor/detar, sepse ekosistemet ndikohen dhe kanë ndikim mbi peizazhin më të gjerë tokësor dhe detar në të cilin bëjnë pjesë dhe nuk mund të menaxhohen të izoluar. Për më tepër, për shkak se disa mallra dhe shërbime të ekosistemit sigurohen në shkallën e peizazhit tokësor/detar, veprimtaritë e ZMN-ve duhet të përdoren në mënyrë strategjike përgjatë një peizazhit më të gjerë tokësor/detar.

Në fakt, menaxhimi i proceseve ekologjike në nivelin e peizazhit - për shembull cikli i ushqyesve - mund të jetë po aq i rëndësishëm sa vendimet e menaxhimit të marra në nivelin e zonës së ndërhyrjes, veçanërisht nëse kryerja e shërbimeve të ekosistemit është një objektiv i rëndësishëm. Për rrjedhojë, vlerësimi, planifikimi, zbatimi dhe monitorimi afatgjatë i veprimtarive të synuara për të ndikuar tek mallrat dhe shërbimet e ekosistemit, të cilat i sjellin dobi shoqërisë në tërësi (uji, zbutja dhe përshtatja ndaj klimës, etj.), kërkojnë qasje në nivelin e peizazhit tokësor/detar, si dhe zbatimin dhe monitorimin e integruar të masave të zonës përkatëse. Për këto

arsye, në secilën fazë të zhvillimit dhe ekzekutimit të ZMN-së, duhet të merret parasysh peizazhi më i gjerë tokësor/detar, si dhe proceset ekonomike të cilat bëjnë pjesë në këto nivele.

K-2.1 Hartimi i ZMN-ve njeh dhe reagon ndaj ndërveprimeve midis ekonomisë, shoqërisë dhe ekosistemeve

Të gjitha ndërhyrjet, duke përfshirë ato të cilat kryhen vetëm në një zonë apo në një shkallë të vogël territoriale, duhet të zhvillohen në kontekstin e peizazhit të gjerë tokësor/detar nëpërmjet planifikimit të peizazhit tokësor/detar, në mënyrë që veprimtaritë të jenë strategjike dhe të rrisin përfitimet për njerëzit dhe ekosistemet, duke zgoçuar ndikimet e dëmshme ndaj ekosistemeve fqinje dhe popullatave të njerëzve. Zbatimi i ZMN-ve novatore në shkallë të vogël është baza për shkallëzimin e tyre, meqenëse aktorët në peizazhin tokësor/detar mësojnë dhe përvetësojnë praktikën e reja të cilat ndërmerren nga ata të cilët kanë dëshirë të provojnë diçka të re. Konteksti i peizazhit më të gjerë tokësor/detar përfshin perspektivat ekologjike, ekonomike dhe social-kulturore.

Në vend që të përqendrohet tek një ekosistem i caktuar apo grup i vetëm aktorësh, zgjerimi i peizazhit tokësor/detar përfshin edhe aspektet e lidhshmërisë së ekosistemeve dhe funksioneve të tyre me vlerat, të drejtat dhe përfitimet e aktorëve të ndryshëm. Planifikimi dhe vendimmarrja për ZMN-të duhet të ndërmerren gjithmonë në shkallën e peizazhit tokësor/detar, duke kuptuar ndërlikimet e ndërhyrjeve në shkallën e peizazhit tokësor/detar. Këto aspekte mund të ndihmojnë për të siguruar integritimin e nevojave të shumta, planeve të ndryshme sektoriale, programeve dhe politikave të zhvilluara nga praktikuesit e ZMN-ve, dhe mbështetjen e përdorimit të praktikave të duhura tradicionale për zbatimin, në një

kontekst të vetëm territorial i cili ka në përbërje kompromiset, mundësitë dhe skenarët. Marrja parasysh e niveleve të tilla të peizazhit tokësor/detar nuk përfshin vetëm masat për ndikimet në zonën e caktuar, por gjithashtu edhe ndikimet kumulative ndërmjet zonave dhe aktorëve të shumtë.

Meqenëse ndërveprimet mes njerëzve dhe natyrës janë komplekse dhe të pasigurta, hartimi i ZMN-ve mund të ideohet në bazë të një modeli të thjeshtë cilësor, të zhvilluar përmes një procesi gjithëpërfshirës. Po ashtu, ai përfshin identifikimin e ndërveprimeve kryesore ndërmjet aktorëve dhe përdorimeve të tyre të tokës, ndërveprimeve ndërmjet këtyre grupeve të aktorëve dhe vetë peizazhit tokësor apo detar, dhe ndërveprimeve ndërmjet politikave dhe marrëveshjeve rregullatore dhe territoriale për peizazhin tokësor/detar, duke përfshirë ligjet dhe politikat kombëtare. Ky model i thjeshtë i sistemeve mund të ofrojë bazat për zhvillimin gjithëpërfshirës të skenarëve të ardhshëm, të cilët do të drejtojnë vendimmarrjen dhe do të realizojnë integrimin e duhur të çështjeve të lidhura me Kriteret 3, 4, 6 dhe 8.

Kuptimi i ndikimit të ndërveprimeve sipas shkallëve hierarkike (brenda institucioneve pjesëmarrëse në ZMN dhe ndërmjet tyre) krijon ndërlikime për qeverisjen dhe duhet të parashikojë se institucionet ekzistuese (si formale ashtu dhe joformale) mund të mbështesin apo të ndalojnë hartimet alternative të ZMN-ve.

K-2.2 Hartimi i ZMN-ve integrohet me ndërhyrje të tjera bashkëplotësuese dhe kërkon sinergji ndërmjet sektorëve

ZMN-të mund të zbatohen më vete, pavarësisht se shpesh ato janë pjesë e një pakete të integruar ku përfshihen lloje të tjera zgjidhjesh

për të adresuar sfidat shoqërore (p.sh. zgjidhjet teknologjike dhe inxhinierike, instrumentet financiare). Sinergjitë e ZMN-ve me lloje të tjera të zgjidhjeve mund të jenë të planifikuara qartë. Vlen të theksohet se të gjitha kontributet bazohen fuqimisht tek shkenca dhe përmbajnë qasje integruese për monitorimin si pjesë e hartimit.

Për të mbështetur sinergjitë ndërmjet zgjidhjeve të ndryshme, mund të identifikohen lidhjet ndërmjet një sërë sektorësh për të zgjeruar fushën e zbatimit të reagimit ndaj sfidave shoqërore. Qasje të tilla të përbashkëta bëjnë të mundur përvetësimin e qasjes, zvogëlojnë rreziqet e pasojave të paqëllimshme negative dhe realizojnë integrimin e përgjithshëm të ZMN-ve në politika dhe sektorë. Gjatë planifikimit të ZMN-ve, sinergjitë e mundshme me sektorë të ndryshëm (p.sh. bujqësinë, pylltarinë, ujin, shëndetin, etj.) janë të rëndësishme të realizohen në mënyrë aktive sepse në këtë mënyrë kontribojnë ndaj ZMN-së, adresojnë nevojat për jetesën dhe përmirësojnë cilësinë e mjedisit. Disa shembuj të cilët ilustronë lidhje të tilla janë përfshirja në ZMN : a) e sektorëve të sigurimit të bujqësisë apo kulturave, për të adresuar më mirë sigurimin e ushqimit; b) e sektorit të shëndetësisë, për të adresuar më mirë shëndetin e njeriut në peizazhet urbane; c) e infrastrukturës, për të adresuar rrezikun nga fatkeqësitë e përmytjeve në vijat bregdetare (përmes kombinimit të mangroveve-rizofore dhe argjinaturave buzë detit).

K-2.3 Hartimi i ZMN-ve përfshin identifikimin e rrezikut dhe menaxhimin e rrezikut përtej zonës së ndërhyrjes

Proceset e hartimit të besueshëm kërkojnë vlerësimin e ndikimit të proceseve shoqërore dhe ekologjike, dhe rrezikun e ndryshimit të padëshirueshëm të sistemit për shkak të

shfaqjes së një ngjarjeje të jashtme (p.sh. ngjarje të dëmshme natyrore), dhe se si këto mund të ndikojnë në rezultatin e synuar të një ndërhyrjeje. Këto janë veçanërisht të vlefshme për ndikimet negative të cilat ndodhin përtej kufijve të ndërhyrjes.

Vlerësimi i rrezikut kryhet gjithashtu në lidhje me mundësinë e cënueshmërisë së disa prej aktorëve si pasojë e paqëllimshme e hartimit të ndërhyrjes. Kjo vlen veçanërisht në rastin e atyre ZMN-ve kur burime të shumta mund të ndikojnë për një periudhë afatgjatë në shëndetin dhe integritetin e shërbimeve përkatëse të ekosistemit. Ndërmarrja e veprimeve paraprake, të tilla si vlerësimi i ndikimit, si dhe menaxhimi i kërcënimeve proaktive, arrijnë të bëjnë ndryshimin ndërmjet ZMN-ve të suksesshme dhe ato të dështuara. Në bazë të vlerësimeve të cënueshmërisë dhe aftësisë ripërtëritëse parashtrohen edhe pyetjet kryesore, të tilla si:

- A ekziston konkurrenca mes politikave kombëtare, rajonale apo vendore e cila vë në rrezik objektivat e ZMN-së për menaxhimin e sistemit shoqëror dhe ekologjik të caktuar?
- A ekziston konkurrenca mes pretendimeve për sistemet dhe shërbimet e ofruara shoqërore dhe ekologjike e cila mund të vërë në rrezik ZMN-në?
- A ekzistojnë praktika të veçanta në vendet fqinje apo në zonën e rrjedhës së sipërme të lumenjve në lidhje me praktikën e përdorimit të tokës, të cilat mund të zbehin efikasitetin e ZMN-së?
- A është hartimi i ZMN-së mjaft i qëndrueshëm për t' u bërë ballë ndryshimeve të shpejta ekonomike, demografike dhe klimatike?
- A përbën ZMN-ja në vetvete rrezik apo ushtron presion shtesë ndaj ekosistemit mbështetës (p.sh. rreziku i prezantimit apo përhapjes së llojeve invazive)?

Kriteri 3: ZMN-të rezultojnë me përfitim për integritetin e biodiversitetit dhe ekosistemit

Krizat aktuale të biodiversitetit jo vetëm që po kërcënojnë me zhdukje llojet e rralla, por gjithashtu po degradojnë seriozisht shumë ekosisteme, duke çenuar si shëndetin e planetit ashtu edhe atë të njeriut. Pavarësisht se cilat janë sfidat e synuara, të gjitha ZMN-të duhet të kenë një ndikim pozitiv ndaj biodiversitetit; me fjalë të tjera, diversiteti biologjik dhe integriteti ekologjik i zonës së ndërhyrjes dhe mjedisi rrethues duhet të përmirësohen si rezultat i drejtpërdrejtë të ZMN-së.

ZMN-të gjithashtu synojnë të realizojnë ruajtjen dhe restaurimin e integritetit të ekosistemit dhe të shmangin thjeshtimin e mëtejshëm të ekosistemit (si psh. zëvendësimin e një pyllshteje me mbjelljen e pemëve të një lloji të vetëm). Pavarësisht se biodiversiteti (shih përkufizimin në Fjalor) është një komponent kyç i integritetit ekologjik, komponentë të tjerë po aq të rëndësishëm përfshijnë strukturën, funksionin dhe qasjen e ekosistemeve dhe peizazheve tokësore/detare dhe lidhshmërinë. Për më tepër, ZMN-të varen nga kushtet ekologjike të ekosistemeve mbështetëse; për rrjedhojë, praktikuesit e ZMN-ve e shohin me interes idenë se masat e zbatimit do të ruajnë të paktën integritetin ekologjik të zonës së synuar në periudhën afatgjatë. Vlen të theksohet se mbështetësit e ZMN-ve bien dakord për objektivat e ruajtjes dhe i ndërthurin më tej planet e zbatimit, si dhe mbajnë përgjegjësi për progresin gjatë monitorimit të zbatimit, me qëllim që sfida shoqërore të mos mbetet e paadresuar.

Praktikuesit e ZMN-ve duhet të vlerësojnë në mënyrë periodike ndikimet e dëmshme në ekosistemet e synuara dhe ato përreth. Në planin e veprimit të ZMN-ve duhet të parashtrihen të gjitha hollësitë e shqyrtimit të bazuar në fakte të rreziqeve dhe ndikimeve të mundshme të veprimeve kryesore të ZMN-ve ndaj biodiversitetit

të zonës. Për më tepër, në fazën e parë duhet të kuptohen kushtet e gjendjes fillestare për peizazhin e synuar tokësor/detar, në lidhje me biodiversitetin, përbërjen, strukturën, funksionin, lidhshmërinë dhe kërcënimet e jashtme. Kushti për analizën e gjendjes fillestare do të sigurojë informacionin për shkallën e degradimit dhe mund të përdoret për të përcaktuar objektivat e caktuara të ZMN-ve si edhe Standardin për përcaktimin e efikasitetit dhe ndikimet. Për shkak se të gjithë ekosistemet dhe peizazhet tokësore/detare - duke përfshirë ato pa asnjë degradim apo me degradim të vogël - janë dinamike, shkalla e degradimit nuk duhet të vlerësohet në bazë të ekosistemit historik apo peizazhit tokësor/detar, por në bazë të kushtit në të cilin është gjendur sistemi në atë kohë, nëse nuk do të ishte shfaqur degradimi. Kjo mund të karakterizohet përmes krijimit të modeleve të referimit për zonat apo peizazhet tokësore/detare ekzistuese, informacionit teorik apo njohurive tradicionale. Sondazhet dhe mbledhja e të dhënave mund të jenë të kushtueshme. Megjithatë, analizat për gjendjen fillestare janë të domosdoshme për të karakterizuar komponentët kyç të integritetit ekologjik dhe për të përcaktuar shkaktarët e vazhdueshëm të degradimit.

K- 3.1 Veprimet e ZMN-ve reagojnë drejtpërdrejt në vlerësimin e bazuar në fakte për gjendjen aktuale të ekosistemit dhe shkaqet mbizotëruese të degradimit dhe humbjes

Sondazhet dhe mbledhja e të dhënave janë të kushtueshme dhe për rrjedhojë praktikuesit e ZMN-ve mund të kufizojnë analizën e gjendjes fillestare pikërisht për shërbimin(et) e ekosistemit me interes (p.sh. iniciativa për të sekuestruar

karbonin përmes menaxhimit të përmirësuar të moçalishtes vetëm sa vlerëson mundësinë e kapjes së karbonit). Megjithatë, meqenëse kryerja e shërbimeve të ekosistemit mbështetet nga integriteti dhe gjendja e vetë ekosistemit dhe, meqenëse një nga gjërat kryesore dhe tërheqëse të ZMN-së është kontributi i tyre ndaj ruajtjes së biodiversitetit, gjendjet fillestare duhet të jenë të mjaftueshme për të drejtuar këto lloje vendimesh për menaxhimin gjatë zbatimit. Informacioni bazë për analizën e gjendjes fillestare, duhet të përfshijë të paktën:

1. Informacionin strukturor, duke përfshirë dinamikën trofike dhe shtresat e vegjetacionit si dhe shpërndarjen e tyre territoriale brenda ekosistemeve, dhe shpërndarjen territoriale (dhe modelet e shpërndarjes) të llojeve kryesore të ekosistemit brenda peizazhit tokësor/detar, sipas shkallës së kërkuar në zonën e interesit dhe statusit aktual të ruajtjes;
2. Përbërjen e llojeve, duke përfshirë dendësinë e llojeve të shumta nga grupet kryesore taksonomike (bimë vaskulare, gjitarë, shpendë dhe mikroorganizmat e tokës) dhe statusin aktual të llojeve (rreziku për zhdukje)
3. Informacionin për funksionet kryesore të ekosistemit (p.sh. ritmet e prodhimit, qarkullimi i ujit dhe ushqyesve, dhe ndërveprimet biotike);
4. Aspektet kyçe të mjedisit fizik (p.sh. sasia dhe cilësia e ujit dhe informacioni për vetitë fizike dhe kimike të tokës dhe nënshtresave të tjera);
5. Lidhshmërinë, duke përfshirë korridoret e vegjetacionit natyror apo gjysmë natyror përgjatë peizazhit tokësor/detar që lidh zonat e mbrojtura dhe gjysmë të mbrojtura dhe habitatet e tjera të biodiversitetit dhe të cilat lejojnë shkëmbimet e popullatave, ujit dhe materialeve ndërmjet ekosistemeve;
6. Kërcënimet e jashtme ndaj ekosistemit apo peizazhit tokësor/detar dhe rrezikut

të dështimit të ekosistemeve, kur të jetë e mundur siç përcaktohet përkatësisht nga Lista e Kuqe e Llojeve të KërcënuaraTM dhe Lista e Kuqe e Ekosistemeve të IUCN-së;

7. Ndërhyrjet ekzistuese apo të vazhdueshme të ruajtjes për llojet dhe ekosistemet e rrezikuara në peizazhin tokësor/detar.

Vlerësimi për gjendjen fillestare duhet të përdoret për të përcaktuar shkallën e degradimit dhe hartimit të objektivave të projektit, si dhe për të kuptuar ndryshimet të cilat shkaktohen nga ZMN-të gjatë periudhave kohore, të cilat sigurojnë informacionin e vazhdueshëm për objektivat e menaxhimit, duke përfshirë ndërhyrjet e duhura të ZMN-ve për zvogëlimin e rezultateve negative. Për këtë, është e nevojshme që ndryshoret e vlerësuara dhe njësiti e analizimit të jenë të thjeshta apo të njëjta me sondazhin për gjendjen fillestare. Monitorimi është i nevojshëm për të vlerësuar përmirësimet në integritetin e ekosistemit dhe kapacitetin për të kryer shërbimet e dëshiruara.

K-3.2 Rezultatet e qarta dhe të matshme për ruajtjen e biodiversitetit identifikohen, krahasohen dhe vlerësohen në mënyrë periodike

Meqenëse ZMN-të varen nga shëndeti dhe kushtet e ekosistemeve mbështetëse, praktikuesit janë të interesuar të sigurohen që masat për zbatimin mund të ruajnë dhe përmirësojnë të paktën integritetin ekologjik dhe diversitetin e llojeve të zonës së synuar në periudhën afatgjatë. Fusha e zbatimit dhe mundësitë për përmirësime të tilla përcaktohen në bazë të kontekstit, meqenëse varen nga marrëveshja midis aktorëve të tjerë, politikave kombëtare dhe rajonale dhe burimeve të disponueshme. Në disa situata, ZMN-të mund të përfshijnë veprimtaritë ekologjike të restaurimit të cilat i

japin fund degradimit dhe realizojnë rikuperimin e sistemit duke e sjellë atë në gjendjen përpara shfaqjes së degradimit. Në situata të tjera, ZMN-të thjesht synojnë diversifikimin e pranisë së llojeve në zonat e caktuara apo përmirësimin e kryerjes së disa funksioneve të ekosistemit. Objektivat për ruajtjen duhet të përcaktohen me marrëveshje dhe të përfshihen në zbatim, ndërsa efikasiteti dhe ndikimet (duke përfshirë pasojat e paqëllimshme) përcaktohen përmes monitorimit, pa mënjnauar adresimin e sfidave shoqërore që synohen nga ZMN-të.

Për secilin objektiv të menaxhimit i cili lidhet me ruajtjen dhe diversitetin biologjik, si dhe me integritetin ekologjik, ZMN-të duhet të paktën të përfshijnë si më poshtë:

1. Ndryshoret e caktuara të matshme, të cilat shoqërohen nga objektivi i menaxhimit (p.sh. numri i llojeve/ha, përqindja (%) e kurorës së gjelbër;
2. Veprimin (p.sh. ngritjen, uljen, mirëmbajtjen);
3. Sasinë (p.sh. 50%);
4. Periudhën kohore (p.sh. 5 vjet).

K-3.3 Monitorimi përfshin vlerësime periodike të pasojave të dëmshme por të paqëllimshme ndaj natyrës të cilat vijnë nga ZMN-të

Për zbatimin e programit të monitorimit duhet të hartohet plani i cili përcakton efikasitetin dhe ndikimet (duke përfshirë ndikimet e dëmshme por të paqëllimshme) e ZMN-së në kohën kur hartohet plani i ZMN-ve.

Ekosistemet janë komplekse dhe dinamike. Pavarësisht se procesi i qëndrueshëm i planifikimit (Kriteri 2) do të ndihmojë për përshpejtimin dhe adresimin e ndikimeve negative të paqëllimshme, ekziston gjithmonë rreziku për rezultate të paqëllimshme gjatë

punës me sistemet dhe proceset natyrore. Për rrjedhojë, praktikuesit e ZMN-ve këshillohen të vëzhgojnë në mënyrë periodike pranimin e ndikimeve të dëmshme në ekosistemet e synuara dhe ato fqinje. Në bazë të kësaj çështjeje, në planin e veprimit të ZMN-ve duhet të përcaktohen në mënyrë të hollësishme vëzhgimi i bazuar në fakte i rreziqeve dhe ndikimeve të mundshme të ndërhyrjeve kryesore të ZMN-ve ndaj biodiversitetit të zonës. Gjithashtu, duhet të përfshihet harku kohor i caktuar për monitorimin dhe korniza për reagimin nëse vërehen ndikimet negative dytësore.

Plani i monitorimit dhe i vlerësimit përfundimtar duhet të përfshijë si më poshtë:

1. Sasinë dhe burimet e financimit për secilin komponent të programit të monitorimit (të detajuara më poshtë);
2. Hartimin për mbledhjen e të dhënave, duke përfshirë ndryshoret që do të vlerësohen, metodën e mbledhjes së të dhënave, përsëritjen e nevojshme për të përcaktuar ndikimet e ndërhyrjeve të menaxhimit, frekuencën dhe kohëzgjatjen e monitorimit;
3. Llojet e analizimit të cilat do të përdoren për të vlerësuar ndikimet e menaxhimit;
4. Vendodhjen dhe protokollet për krijimin e një arkive të përhershme për të dhënat;
5. Mënyrën sipas të cilës do të përçohen mësimet e nxjerra.

K-3.4 Mundësitë për të rritur integritetin dhe lidhshmërinë e ekosistemit identifikohen dhe përfshihen në strategjinë e ZMN-së

Lidhshmëria e ekosistemit i referohet qarkullimit në dy drejtime të komponentëve biotikë (d.m.th. të gjallë) të ekosistemit, të cilët në një kontekst tjetër do të ndaheshin nga pengesat fizike të peizazhit tokësor/detar. Kontributi për përmirësimin e

lidhshmërisë shpesh mund të konsiderohet si objektivi i cili mund të realizohet lehtësisht nga ZMN-të. Shkalla në të cilën adresohet lidhshmëria në planifikim varet nga objektivat e përcaktuara për ndërhyrjen e ZMN-së.

Lidhshmëria e ekosistemit konsiderohet edhe në bazë të pikëpamjeve shoqërore dhe, në lidhje me këtë aspekt, disa nga mundësitë më premtuese të ndërhyrjeve të ZMN-ve lidhen me kërkesën urbane për hapësira të gjelbra të cilat ofrojnë mundësitë për veprimtari shlodhëse dhe jashtëshkollore, si dhe për shëndetin publik, duke zvogëluar ndjeshëm praninë e grimcave të ndotjes dhe pluhurit. Lidhshmëria ndërmjet ekosistemeve urbane dhe zonave të thella janë shembuj shumë

të mirë për zhvillimin e hapësirave të gjelbra në zonat urbane.

Shembuj të tjerë të mënyrave se si ZMN-të përmirësojnë lidhshmërinë, përfshijnë korridore të planifikuara që lidhin habitatet e vogla të biodiversitetit të tilla si gardhet, ligatinat dhe pyllishtet, pra ekosistemet e modifikuara, për të përshtatur lëvizjen e llojeve përgjatë një peizazhi; apo ruajtjen e lidhshmërisë ndërmjet peizazheve me burime ujore dhe zonave urbane të cilat sigurojnë furnizime të qëndrueshme me ujë për banorët. ZMN-të duhet të hartohen, zbatohen dhe monitorohen, duke marrë parasysh lidhshmërinë dhe ndikimin e saj në integritetin e ekosistemit.

Kriteri 4: ZMN-të janë ekonomikisht të realizueshme

Një nga sfidat me të cilat përballen shumë praktikues të ZMN-ve në ditët e sotme është mungesa e planifikimit ekonomik apo financiar dhe burimet afatgjata. Në shumë prej ndërhyrjeve bëhet gabimi i investimit të madh që në fazat e para, pa marrë parasysh stabilitetin financiar përtej kufirit kohor të ndërhyrjes. Në këtë mënyrë ZMN-të jo vetëm që rrezikohen të dështojnë, por gjithashtu nuk arrijnë të ofrojnë mundësitë për zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik. Për shembull, krijimi i vendeve të punës në sektorin e gjelbër dhe jetesa e qëndrueshme mund të integrohen brenda fushës së zbatimit të ndërhyrjes së ZMN-ve për të shërbyer si stimuj për ndikim të mëtejshëm.

Në mënyrë që ZMN-të të jenë të qëndrueshme, duhet të merret parasysh bashkëpunimi ekonomik (përveç dy shtyllave të tjera të zhvillimit të qëndrueshëm – mjedisor dhe shoqëror). Në të kundërt, ne do të ndeshemi me zbatime të kufizuara vetëm brenda harkut kohor të projektit (p.sh. pesë vjet) dhe pas përfundimit të tij marrin fund si zgjidhja ashtu edhe përfitimet e shumta, madje në disa raste peizazhi tokësor/detar mbetet në gjendje akoma më të mjeruar se më parë. Për më tepër, ZMN-të nuk funksionojnë pa pasur mbështetje financiare, prandaj ato duhet të jenë të lidhura dhe të integruara me institucionet financiare dhe strukturat subvencionuese. Gjithashtu është e rëndësishme të kuptohet nëse politikat ekonomike dhe strukturat financiare bashkëplotësojnë njëra-tjetrën, me qëllim që ZMN-të të ofrojnë gamën e tyre të plotë të përfitimeve për natyrën dhe njerëzit.

Natyra mbështet ekonominë dhe shoqërinë tonë, në mënyrë të drejtpërdrejtë (p.sh. ushqimi, lënda drusore) dhe në mënyrë indirekte (p.sh. cikli i ushqyesve, formimi i dheut, pjalmimi). Mallrat dhe shërbimet e ofruara për njerëzit nga kapitali natyror përfshijnë një numër përfitimesh

shoqërore dhe mjedisore duke përfshirë ajrin e pastër dhe ujin, përshtatjen dhe zbutjen e klimës, ushqimin, energjinë, vendet për të jetuar, materialet për produktet, veprimtaritë shlodhëse dhe mbrojtjen nga rreziqet. Ndërkohë që disa nga këto përfitime shkëmbehen dhe vlerësohen me çmimin e tregjeve, shumë përfitime nga natyra nuk janë mallra dhe shërbime të tregut, duke përfshirë disa të cilat gjenden falas. Kur vlerësohen ZMN-të, sfida kryesore është që përfitimet e tyre të shumta të përfshihen në një kornizë të përbashkët të vlerësimit ekonomik.

Qasjet kryesore në lidhje me vlerësimet ekonomike përfshijnë efektshmërinë e kostove dhe vlerësimet e përfitimeve nga kostot. Kur kostot janë të efektshme, ZMN-të realizojnë rezultatet e pritshme (për shembull, sekuestrimi i CO₂, mbrojtja nga përmytjet, filtrimi i ujit, dhe ruajtja e biodiversitetit) me kosto të ulët në krahasim me kostot e zgjidhjeve të tjera të mundshme që adresojnë të njëjtat sfida shoqërore. Efektshmëria e kostove nuk kërkon shndërrimin e përfitimeve në vlerë monetare; ajo mund të përfshijë rezultate me përfitime monetare dhe jomonetare duke përdorur sasi të tyre fizike. Vlerësimi i efektshmërisë së kostove nuk kërkon përdorimin e një monedhe të përbashkët, e cila ndihmon në përfshirjen e përfitimeve jomonetare, por kufizon mundësitë e disponueshme për të krahasuar rezultatet e ndryshme të përfitimeve. Vlerësime me shumë kritere mund të bashkëplotësojnë vlerësimin e efektshmërisë së kostove duke përlogaritur rezultatet e ndryshme të përfitimeve përmes një vlerësimi të përbashkët përfundimtar dhe kornizës së vendimeve.

Analiza kosto-përfitim integron rezultate të shumta të përfitimeve, duke i bërë ato të krahasueshme me anë të përdorimit të një monedhe të përbashkët. Kur të gjithë përfitimet

përkthehen në vlerë monetare, analiza kosto-përfitim ndihmon të kalohet përtej efektshmërisë së kostove, duke vlerësuar jo vetëm koston e përmbushjes së rezultateve të caktuara (efektshmërinë e kostove), por gjithashtu duke përcaktuar se cili nivel i investimit për ZMN-të është i garantuar në plan të parë (përfitimet i tejkalojnë koston).

K-4.1 Përfitimet dhe kostot direkte dhe indirekte të lidhura me ZMN-të, kush paguan dhe kush përfiton, identifikohen dhe dokumentohen

Kërkesa më e rëndësishme për të kuptuar aspektet ekonomike të ZMN-ve përfshin identifikimin dhe dokumentimin e të gjitha llojeve të përfitimeve të ofruara (financiare dhe jofinanciare; ekonomike dhe joekonomike), kush i merr ato, cilat janë kostot e ofrimit, dhe kush i përballon këto kosto. Përfitimet dhe kostot mund të vlerësohen nga aspekti joekonomik (p.sh. rritje e cilësisë së ajrit) apo ekonomik (p.sh. kosto të ulëta për shëndetësinë) apo të dyja. Marrja parasysh e aspekteve tregtare apo jotregtare të ZMN-ve është thelbësore për të siguruar një vlerësim gjithëpërfshirës, për të identifikuar kush është paguesi, kush do të përfitojë dhe kush është ai që vepron. Kjo ndihmon për të marrë parasysh kompromiset në bazë të Kriterit të gjashtë (Treguesi 6.).

K-4.2 Studimi për efektshmërinë e kostove sigurohet për të mbështetur zgjedhjen e ZMN-ve duke përfshirë ndikimin e mundshëm të ndonjë rregulloreje apo subvencionimi përkatës

Korniza analitike mund të jetë studimi për efektshmërinë e kostove, vlerësimin e përfitimit nga kostot apo analizimin e shumë kriterëve. Ka shumë metoda dhe mjete për të ndihmuar

studimet mbi efektshmërinë e kostove dhe, në fund të fundit, përpjekje të tilla do të ndihmojnë mjaft për të ofruar informacionin për Kriterin 6 për kompromiset.

K-4.3 Efektshmëria e hartimit të ZMN-ve justifikohet kundrejt zgjidhjeve alternative të disponueshme, duke marrë parasysh çdo pasojë shoqëruese

Qëllimi kryesor i ZMN-ve është të adresojnë me efektshmëri të paktën një sfidë shoqërore në mënyrë që të jenë ekonomikisht të qëndrueshme. Për identifikimin e zgjidhjes më të efektshme dhe të përballueshme, duhet të merren parasysh zgjidhjet alternative. Zgjidhjet alternative mund të jenë zgjidhje tërësisht teknologjike apo inxhinierike, strukturore (zgjidhje gri). Krahësimi i zgjidhjeve të ndryshme mund të ofrojë informacion për mënyrën më të efektshme përpara se të adresohen sfidat shoqërore. Ky Tregues lidhet fort me Treguesin e mësipërm 4.2.

K-4.4 Hartimi i ZMN-ve shqyrton paketën e mundësive për burime të tilla si ato që ofrohen nga tregu, sektori publik, angazhimet vullnetare dhe veprimet për të mbështetur përputhjen me rregulloret

Gjetja e burimeve të duhura për ZMN-të është e nevojshme për të siguruar qëndrueshmërinë. Këto aspekte janë të rëndësishme pavarësisht se ndërhyrja mund të kryhet për të nxjerrë apo jo përfitime. Nëse qëllimi është jofitimprurës, gjetja e burimeve mund të mbështetet fillimisht tek marrja e një granti por pas përfundimit të afatit kohor të ndërhyrjes duhet të merren parasysh mënyrat e gjetjes së burimeve të ardhshme. Aktualisht, meqenëse kërkesa për ZMN po

rritet, po rriten gjithashtu edhe mundësitë e gjetjes së burimeve, veçanërisht financimi novator apo financimi i kombinuar. Financimi i kombinuar është përdorimi strategjik i financimit për zhvillimin e mobilizimit të financimit shtesë kundrejt zhvillimit të qëndrueshëm në vendet në zhvillim” (OECD, 2020). Për t’u siguruar që ZMN-ja ofron zgjidhjen më të efektshme ndaj sfidave shoqërore në secilin rast, duhet të merren në konsideratë një sërë mundësish, duke përfshirë për shembull, ekonominë qarkulluese, angazhimet vullnetare, skemat e tatimeve, sektorin e gjelbër dhe financimin shoqëror. Financimi i sektorit privat për ZMN-të, qoftë përmes përgjegjësisë shoqërore të korporatave (CSR) [PSHK] apo financimit për bamirësi, ofron mundësi të cilat duhet të merren parasysh.

Për adresimin e fizibilitetit ekonomik/financiar dhe kufizimet e ZMN-ve duhet të përpilohet një plan biznesi/financiar afatgjatë. Ky plan shkon përtej afatit kohor të planifikimit dhe fazës fillestare të zbatimit të mbështetur nga grantet. Nëse nuk merren parasysh planifikimet afatgjata financiare, kostot afatshkurtra do të jenë më të mëdha se përfitimet afatgjata. Analizime të tilla mund të arrijnë në pëfundimin se zgjidhja e dëshiruar mund të mos konsiderohet si ekonomisht e qëndrueshme në periudhat e ardhshme kohore. Për rrjedhojë, planifikimi duhet të marrë parasysh fazën e zbatimit por gjithashtu të përfshijë edhe idenë e të menduarit paraprak në bazë të Kriterit të mësipërm.

Kriteri 5: ZMN-të bazohen në proceset qeverisëse gjithëpërfshirëse, transparente dhe fuqizuese

Proceset e duhura të qeverisjes janë të rëndësishme për përcaktimin e rezultateve të suksesshme të ZMN-ve për njerëzit dhe natyrën. Pjesëmarrja e barabartë, ndarja e pushtetit, njohja dhe siguri i të drejtave, dhe njohja e qartë e përgjegjësisë, do të sigurojnë përfitimet paralele për njerëzit dhe natyrën qoftë në periudhën afatshkurtër ashtu edhe në atë afatgjatë. Qeverisja për ndërhyrjen e ZMN-ve përfshin mundësitë për identifikimin, vendimmarrjen, monitorimin dhe reagimin, dhe proceset e ankimimit për të gjithë aktorët. Të gjitha ZMN-të duhet të ndjekin një qasje gjithëpërfshirëse kur identifikojnë dhe krijojnë mekanizmat e qeverisjes, dhe duhet të njohin dhe respektojnë praktikën kulturore të mëparshme dhe përdorimet e tokës ku të jetë e mundur, gjatë kohëzgjatjes së ndërhyrjes dhe përtej saj. Për identifikimin e numrit të aktorëve të cilët do të ndikohen nga ZMN-ja dhe mënyrën se si do të kryhet, duhet të ndiqet një proces rigoroz i planifikimit të aktorëve. Të gjithë grupet e aktorëve duhet të përfaqësohen dhe të gjithë rolet e tyre duhet të merren parasysh kur merren vendime në lidhje me ZMN-në. Në këtë mënyrë mund të zvogëlohet rreziku i anashkalimit të një grupi të caktuar të aktorëve apo në rastin më të keq, mund të shmanget ndikimi negativ i ndërhyrjes së ZMN-së ndaj tyre. Nga ana tjetër, mungesa e një qasjeje të tillë do të rezultojë në vendimmarrje të bazuar në pikëpamje të kufizuara, të opinionuara apo të ngushta, të cilat do të krijojnë pabarazi të mëdha shoqërore dhe/ose ekonomike ndërmjet aktorëve. Për rrjedhojë, aktorët e papërfshirë mund të krijojnë konflikte në të ardhmen për shkak se nuk është marrë mendimi i tyre. Këto probleme lindin veçanërisht për shkak të pabarazive apo dallimeve të brendshme të nivelit të aktorëve të përfshirë apo të ndikuar. Për më tepër, mungesa e një qasjeje gjithëpërfshirëse mund të përkeqësojë rreziqet e përcaktuara në Treguesit 2.3 dhe 3.3 (ndryshim i padëshiruar përtej zonës së ndërhyrjes dhe pasoja

të dëmshme) dhe kufizojnë shkallën e ushtrimit të menaxhimit të përshtatur.

Transparenca është gjithashtu e rëndësishme për të siguruar se burimet (financiare, njerëzore dhe natyrore) përdoren siç duhet dhe me efikasitet në dobi të grupit(eve) përfitues, dhe identifikohen dhe vendosen me marrëveshje të përbashkët nga ana e të gjithë aktorëve të përfshirë. Transparenca e ofruar nga aktorët e jashtëm të cilët mund të jenë në krye të ndërhyrjes, është e nevojshme në mënyrë që aktorët lokalë dhe veçanërisht komunitetet lokale të kuptojnë problematikat e menjëhershme apo afatgjata të ndërhyrjeve të ZMN-së, qofshin ato ekologjike, ekonomike apo shoqërore (veçanërisht çdo ndikim negativ i mundshëm mbi kulturën, të drejtat lokale dhe praktikën). Të gjithë aktorët duhet të jenë të barabartë në përfshirjen e tyre në proceset e vendimmarrjes dhe të kuptojnë ndikimin e tyre nga problematika të tilla, duke përfshirë çdo kompromis që duhet bërë (Kriteri 6) për zbatimin e ZMN-së.

ZMN-të gjithashtu duhet të kontribuojnë ndaj trajtimit të pabarazive ekzistuese strukturore, emocionale dhe qeverisëse, veçanërisht ato të cilat nuk përfshijnë grupet e marginalizuara në procesin e vendimmarrjes. Qeverisja efikase ndihmon për të shmangur konfliktet, dhe dështimet e veprimit për ruajtjen. Përdorimi i mjeteve të tilla si Korniza për Qeverisjen e Burimeve Natyrore (KQBN) mund të kontribuojë drejtpërdrejt në përmbushjen e Kriterit 5, sepse ato janë mjete të cilat synojnë të drejtojnë hartimin dhe zbatimin e projekteve të cilat në mënyrë gjithëpërfshirëse, të qëndrueshme dhe sistematike, arrijnë të marrin parasysh gjithëpërfshirjen, barazinë dhe të drejtat.

Për një qeverisje gjithëpërfshirëse, të barabartë, transparente dhe të besueshme për ndërhyrjet e ZMN-së, qasja ka nevojë të fuqizojë aktorët,

veçanërisht ata të cilët mund të jenë të varfër, me më pak influencë apo të marginalizuar, që në fillim të procesit, përmes rritjes proaktive të kapaciteteve dhe ndarjes së dijeve. Fuqizimi mund të sigurojë themelet për pronësinë afatgjatë, të krijojë pavarësi ekonomike dhe përfundimisht, qëndrueshmëri si dhe shkallëzim të ndërhyrjes.

Komunikimi dhe angazhimi janë më të efektshëm kur njihen dhe kuptohen nevojat dhe kulturat e publikut. Në rastet kur ka komunitete me përbërje të ndryshme etnike, do të ishte e rëndësishme që këto komunitete të planifikojnë dhe alokojnë burime për kryerjen e përkthimeve dhe interpretimeve të kontributeve të tyre, në mënyrë që të gjithë të pranishmit të arrijnë të njohin dhe të kuptojnë se çfarë thotë gjithsecili.

K-5.1 Mekanizmi i reagimit dhe zgjidhjes së mosmarrëveshjeve i përcaktuar dhe i miratuar plotësisht vihet në dispozicion të të gjithë aktorëve përpara se të fillojë ndërhyrja e ZMN-së

Mekanizmi për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve apo polemikave duhet të miratohet paraprakisht, mundësisht gjatë planifikimit të ndërhyrjes, pavarësisht se ai mund të jetë në formën e një procesi ligjor apo sistemi jo formal jo ligjor, ai duhet të përmbajë procedurat, rolet dhe rregulloret e miratuara për marrjen dhe gjykimin e këtyre ndërhyrjeve. Shqyrtimi i mekanizmave ekzistuese të dëmshpërblimit në ligjin ndërkombëtar për veprimtaritë e ruajtjes kanë treguar rëndësinë e përfshirjes së metodave të duhura në bazë të kontekstit për adresimin dhe dëmshpërblimin. Mekanizmat e ankimeve duhet të jenë legjitime, të aksesueshme, të parashikueshme, të barabarta, transparente, në përputhje me të drejtat, të menaxhuara siç duhet dhe të bazuara në angazhimin dhe dialogun.

K- 5.2 Pjesëmarrja bazohet te respekti dhe barazia e ndërsjelltë, pavarësisht gjinisë, moshës apo statusit shoqëror, dhe mbron të drejtën e Popujve Autoktonë për Pëlqimin e Lirë, Paraprak dhe të Informuar (PLPI)

Pjesëmarrja ka për qëllim të sigurojë se diversiteti i njohurive, aftësive dhe ideve ofron informacionin për zbatimin dhe zhvillimin e ndërhyrjes, ku aktorët marrin përgjegjësinë për ZMN-të dhe madje mund të ndërmarrin veprime kolektive dhe të vazhdueshme pas ndërhyrjes. Pjesëmarrja e plotë është e rëndësishme për suksesin e ndërhyrjes. Pjesëmarrja pasive, ku grupet e caktuara të aktorëve thjesht informohen për atë çfarë do të ndodhë apo ka ndodhur, do të pengojë qëndrueshmërinë e procesit. Po ashtu, pjesëmarrja nuk mund të jetë një veprimtari e një apo disa grupeve të aktorëve për nxjerrjen e informacionit, dhe as nuk mund të bazohet në kanosje apo të nxitet për përfitime materiale. Në rastet kur ndikohen popujt Autoktonë, parimi i Pëlqimit Të Lirë, Paraprak e Të Informuar (PLPI) duhet të ndiqet për hartimin dhe zbatimin e ZMN-ve, por edhe grupe të tjera të aktorëve mund të përfitojnë nga qasjet e PLPI-së.

K-5.3 Aktorët të cilët ndikohen direkt apo indirekt nga ZMN-të identifikohen dhe përfshihen në të gjitha proceset e ndërhyrjes së ZMN-së

ZMN-të duhet të ofrojnë mundësinë për pjesëmarrje aktive të të gjithë njerëzve të cilët mund të ndikohen direkt apo indirekt nga fillimi deri në fund të ndërhyrjes. Me anë të përdorimit të një mjeti të qëndrueshëm për planifikimin e aktorëve, duhet të kryhet analizimi i aktorëve në mënyrë që të identifikohet dhe angazhohet numri i saktë i njerëzve të cilët mund të ndikohen nga ZMN-ja. Procesi gjithashtu duhet të identifikojë

aktorët të cilët mund të ndikohen negativisht dhe duhet të përballojnë ekonomisht fuqizimin e tyre, së bashku me kompensimin, për të parandaluar marginalizimin e mëtejshëm të tyre për shkak të ZMN-së. Mekanizmat për vendimmarrjen dhe zbatimin e ndërhyrjes së ZMN-së duhet të pasqyrojnë diversitetin dhe kontributin e grupeve të ndikuara të aktorëve.

K-5.4 Proceset e vendimmarrjes dokumentojnë të drejtat dhe interesat e aktorëve të ndikuar dhe reagojnë ndaj tyre

Në rastet kur aktorët i nënshtrohen pabarazisë, pandershmërisë dhe marginalizimit, në lidhje me ndikimin e tyre, pozicionin shoqëror, kulturën apo statusin financiar, duhet të kuptohen shkaqet e përfshira dhe të bëhen të gjitha përpjekjet për të zvogëluar apo shmangur pabarazi të tilla sa më shumë të jetë e mundur. Në këtë mënyrë do të zvogëlohen rastet e konflikteve. Në rastin e konflikteve të mundshme, ato zgjidhen përmes respektimit të negocimit, i cili njihet të drejtat e aktorëve në bazë të konteksteve, dhe nevojën për marrëveshje për të zvogëluar rrezikun e dështimit. Në këtë mënyrë do të ofrohet gjithashtu informacion për menaxhimin e përshtatur të ndërhyrjes së ZMN-së, i cili kryhet vetëm përmes procesit të planifikimit. Për më tepër, nëse konfliktet nuk mund të zgjidhen ndërmjet vetë aktorëve, do të përdoren mekanizmat e ankimimeve dhe dëmshpërblimeve.

K-5.5 Aty ku shkalla e ZMN-ve shtrihet përtej kufijve territorialë, krijohen mekanizmat për të mundësuar vendimmarrjen e përbashkët të aktorëve në territoret e ndikuara

Ekositemet shpesh i kapërcejnë kufijtë politikë apo administrativë. Për rrjedhojë, është e rëndësishme

të sigurohen qasjet gjithëpërfshirëse të cilat përfshijnë aktorët dhe institucionet përtej kufijve të shkallës gjeografike të ZMN-së së caktuar. Krijimi i organizmave dhe rregullave bashkëpunuese, apo ndërtimi mbi ato ekzistueset, është i rëndësishëm për ndërhyrjet të cilat përfshijnë ndërhyrjet ndërterritoriale të tilla si në rastin e lumenjve dhe llojeve migratore. Organe të tilla mund t'i shmangin objektivat konfliktuale të menaxhimit në territoret fqinje, të cilat janë pjesë e të njëjtit sistem ekologjik. Mospërputhja e shkallëve shoqërore dhe ekologjike rrit rrezikun e dështimit, për rrjedhojë qasjet e qeverisjes gjithëpërfshirëse duhet të njohin këto lidhje në mënyrën e duhur (shih gjithashtu Kriterin 2 për shkallët ekologjike) aty ku është e përshtatshme.

ZMN-të efikase ndonjëherë kërkojnë bashkëpunim ndërkufitar, kufitar apo rajonal. Në raste të tilla, do të jetë e nevojshme të sigurohen marrëveshjet e bashkëpunimit me autoritetet kombëtare përkatëse të cilat formojnë një vizion të përbashkët dhe përdorin qasje të qëndrueshme për planifikimin, monitorimin, vendimmarrjen e përbashkët dhe zbatimin e ZMN-ve. Marrëveshja duhet të shoqërohet nga shqyrtimi ligjor për të siguruar përputhjen me marrëveshjet për bashkëpunimin ndërkombëtar përkatës (d.m.th. autoritetet kombëtare zbatuese të kenë mandatin e nevojshëm dhe të përdorin procedurën e dëmshpërblimit e cila mund të përdoret në rastin e çdo mosmarrëveshjeje apo pasoje të paparashikueshme) dhe ligjet dhe rregulloret e juridiksioneve të ndryshme të përfshira. Shpesh mund të kërkohej që procesi të ndërmjetësohet nga një organizatë ndërqeveritare (ONQ).

Kriteri 6: ZMN-të balancojnë kompromiset për përmbushjen e objektivit(ve) të tyre kryesor dhe sigurimin e vazhdueshëm të përfitimeve të shumëfishta

Pavarësisht se një ZMN individuale i jep përparësi vetëm një apo disa sfidave shoqërore të caktuara (Kriteri 1), ekosistemet mbështetëse do të vazhdojnë të sigurojnë një sërë përfitimesh të cilat janë të rëndësishme për shoqërinë si një e tërë (Kriteri 3). Në fakt, aftësia për sigurimin e përfitimeve të shumta në të njëjtën kohë është veçori e ZMN-ve. Në disa raste, “renditja” e përfitimeve kryesore (p.sh. mbrojtja e ujit, sekuestrimi i karbonit dhe shëndeti publik përmes veprimtarive shlodhëse) është një përcaktues i rëndësishëm për qëndrueshmërinë ekonomike të ZMN-ve (Kriteri 4).

Megjithatë, kjo veçori themelore e ekosistemeve mund të përbëjë edhe një sfidë për praktikuesin e ZMN-ve. Sigurimi maksimal i përfitimeve nga çdo ZMN rrezikon zvogëlimin proporcional të përfitimit kryesor të ekosistemit, i cili është i domosdoshëm për adresimin e sfidës shoqërore të caktuar. Nga ana tjetër, sigurimi maksimal i përfitimit nga ekosistemi kryesor do të shkaktojë zvogëlimin e cilësisë dhe sasisë së përfitimeve të tjera nga ekosistemi. Kompromiset tilla janë shumë shpesh një tipar i pandashëm i menaxhimit të burimeve natyrore dhe lindin kur një shërbim i caktuar i ekosistemit apo preferenca e aktorëve (p.sh. ujë i pastër i pijshëm) favorizohen në dëm të një tjetre (p.sh. prodhimi bujqësor). Gjithashtu, jo të gjithë aktorët ndikohen në mënyrë të njëjtë dhe ZMN-të duhet të jenë të qarta në lidhje me përfitimet dhe adresimin e kostove. Disa kompromise bëhen si rezultat i vendimeve të qëllimshme, ndërsa të tjera shfaqen pa planifikim apo dijeni për ndikimet. Disa kompromise kthehen në problemin kryesor kur e njëjta zgjidhje përsëritet shumë herë, duke bërë që numri i përfitimeve të rëndësishme të ekosistemeve të zhduket apo të shfaqet në nivele të ulëta në të gjithë peizazhet tokësore/detare.

Megjithatë, kompromiset mund të menaxhohen në mënyrë të suksesshme nëse pasojat e mundshme vlerësohen siç duhet, janë plotësisht të qarta dhe të miratuara nga shumica e aktorëve të ndikuar (shih rastin studimor për Kriterin 6 në Pjesën I). Negocimi i drejtë dhe transparent për kompromise dhe kompensimi i palëve që mund të ndikohen për shkak të ndonjë humbjeje si rezultat i ZMN-ve, duke përfshirë jetesën, ofron bazën për rezultate të suksesshme afatgjata të ZMN-ve. Rëndësi e madhe duhet t'i kushtohet idesë se kompromiset kanë kufij, të cilat nënkuptojnë se masat mbrojtëse do të kërkohen për të siguruar mostejkalimin e vetive afatgjata stabilizuese të ekosistemit të cilat rregullojnë dhe mbështetin shërbimet, si në rastin e praktikave të përdorimit intensiv industrial të tokës. Kohët e fundit, mjete të tilla si Vlerësimi i Integruar i Shërbimeve të Ekosistemit dhe Kompromiset - InVEST (Sharp et al., 2020) dhe rastet studimore për mësimet nga menaxhimi i kompromiseve janë gjithashtu të disponueshme. Përpilimi i rasteve studimore të dobishme dhe mjetet e sugjeruara do të vihen në dispozicion si materiale bashkëplotësuese të këtij udhëzuesi.

K-6.1 Kostot dhe përfitimet e mundshme të kompromiseve të caktuara për ndërhyrjen e ZMN-ve njihen qartë dhe informojnë për masat mbrojtëse dhe çdo veprim të duhur korrigjues

Praktikuesit e ZMN-ve identifikojnë dhe dokumentojnë përfitimet dhe kostot e ZMN-së, dhe personat se kush i merr dhe kush i paguan ato (Kriteri 4), rezultatet e të cilave më tej ofrojnë informacion për veprimet, dhe ndarjen e barabartë të përfitimeve dhe kostove ndërmjet

aktorëve. Analizime të tilla nuk duhet të kufizohen vetëm në fazën e planifikimit por gjithashtu duhet të kryhen gjatë gjithë kohëzgjatjes së ZMN-së, duke përfshirë fazën fillestare, planifikimin, ekzekutimin dhe përfundimin, duke njohur faktin se ndërhyrjet e ZMN-së mund të zbatohen në mënyrë të përhershme.

Kompromiset kanë një dimension territorial, kohor dhe të ndryshueshëm. Kompromiset territoriale i referohen rasteve kur ndikimet e kompromiseve ndihen në nivelin vendor apo në zona të thella. Dimensioni kohor i referohet rasteve kur ndikimet ndihen relativisht shpejt apo ngadalë. Ndryshueshmëria shpreh rastet kur shërbimi i ndërprerë i ekosistemit mund të kthehet në gjendjen e tij të mëparshme menjëherë pas përfundimit të ngjarjes problematike. Për më tepër, marrëveshjet për ndarjen e përfitimeve, të cilat janë miratuar në mënyrë të ndërsjelltë, duhet të krijohen për të mundësuar balancimin e barabartë të përfitimeve dhe kompromiseve nga politikat dhe investimet.

K-6.2 Të drejtat, përdorimi dhe aksesimi i tokës dhe burimeve, së bashku me përgjegjësitë e aktorëve të ndryshëm, njihen dhe respektohen

Të drejtat ligjore dhe të përdorimit të grupeve të cënuara dhe të marginalizuara duhet të ruhen. Të drejtat, përdorimi, përgjegjësitë dhe

llogaridhënia e grupeve të aktorëve duhet të analizohen dhe vlerësohen përmes përdorimit të mjeteve të përshtatshme, duke u bazuar në rezultatet e analizimit dhe planifikimit të aktorëve. Veçanërisht, kur bëhet fjalë për popujt autoktonë dhe komunitetet vendore, duhet të përdoret pëlqimi i lirë, paraprak dhe i informuar (PLMI) (i përcaktuar në Kriterin 5). Për më tepër, jo të gjithë aktorët ndikohen njësoj dhe ZMN-të duhet të kenë mekanizmat për të balancuar kompromiset ndërmjet grupeve përmes përdorimit të qasjeve të tilla si transparenca, stimujt dhe alternativat e qëndrueshme.

K-6.3 Masat e krijuara mbrojtëse rishikohen në mënyrë periodike për të siguruar se kufijtë e kompromiseve të ndërsjellta respektohen dhe nuk çrregullojnë të gjithë ndërhyrjen e ZMN-ve

Shumë politika që lidhen me fushën e ruajtjes përfshijnë edhe politika të qarta për mbrojtjen (shih për shembull [Marrëveshjen e Kankunit të UNFCCC](#), Shtojca 1). Projektet vullnetare për karbonin shpesh kanë ndjekur [Standardet e Klimës, Komunitetit dhe Biodiversitetit](#). Masa të tjera mbrojtëse janë krijuar për investimet e Bankës Botërore. Këto sisteme të mbrojtjes janë në zbatim për t'i paraprirë pasojave të dëmshme të ndërhyrjeve dhe për t'i shmangur ato, dhe mund të përdoren si baza për masat mbrojtëse të përshtatshme për ZMN-të në kontekstet vendore.

Kriteri 7: ZMN-të menaxhohen në mënyrë të përshtatur, duke u bazuar në fakte

Ky Kriter lidhet ngushtë me Treguesit 2.3 dhe 3.3.

ZMN-ja shfrytëzon shërbimet e ekosistemeve, të cilat janë sisteme komplekse, dinamike dhe vetëorganizuese. Ekosistemet mund të reagojnë në mënyrën e dëshiruar ndaj një ndërhyrjeje të ZMN-së. Megjithatë, ndërhyrja mund të krijojë gjithashtu pasoja të paqëllimshme, të paparashikuara dhe të padëshiruara. Për rrjedhojë, ZMN-të janë përpjekje për të ndikuar në ndryshimin e një ekosistemi në mënyra të cilat përmbushin nevojat shoqërore në periudhën afatgjatë, dhe nuk mund të konsiderohen si ndërhyrje të cilat mund të parashikojnë rezultatet në drejtimin absolut të zgjidhjes së problemeve. Si rezultat, ZMN-të duhet të bazohen në teorinë e ndryshimit, e cila testohet dhe përshtatet në bazë të të dhënave. Teoria e ndryshimit duhet të njohë vetitë vetëorganizuese të ekosistemeve dhe të bazohet në vlerësimin e procesit dhe të funksionit, meqenëse këto lidhen me sfidat shoqërore. Supozimet e rëndësishme në lidhje me rrezikun e dështimit sistemik duhet të shprehen qartë në teorinë e ndryshimit dhe të testohen në bazë të fakteve apo eksperimentimit. Teoria e ndryshimit duhet gjithashtu të identifikojë kushtet e mundshme për ZMN-të.

Menaxhimi i përshtatur, për rrjedhojë, duhet të përfshihet në procesin e zbatimit të ZMN-ve. Menaxhimi i përshtatur përkufizohet si: "Një proces i strukturuar, ripërsëritës ... i vendimmarrjes në përballje me pasigurinë, me qëllim zvogëlimin e pasigurisë përgjatë periudhave kohore". Për më tepër, si reagim ndaj një qasjeje të tillë të menaxhimit, të nxënë të vazhdueshëm për proceset e mbarë sistemeve dhe përshtatja e ZMN-ve sipas ndryshimeve sistematike, janë të nevojshme për të gjithë aktorët e përfshirë. Kjo mund të përfshijë gjithashtu marrjen parasysh të ndikimeve afatgjata të qëndrueshmërisë së zonës së synuar nga ZMN-të, ndryshime të cilat mund të shkaktohen në peizazhet tokësore/detare fqinje,

në rrjedhën e poshtme të lumenjve dhe ndikimet të cilat mund të shfaqen në shkallët më të gjera, si në kohë ashtu edhe në hapësirën gjeografike. Nga ana tjetër, ndikimet e padëshirueshme në peizazhet tokësore/detare fqinje, në rrjedhën e poshtme të lumenjve dhe sistemet e shkallës së gjerë mund të jenë përtej kontrollit të aktorëve. Kjo thekson nevojën për menaxhimin e përshtatur, fleksibilitetin dhe proceset e të nxënës ripërsëritës kur zbatohet ZMN-ja. Mbështetja e qasjeve të tilla të të nxënës dhe menaxhimit, do të përbënin njohjen e ndërveprimeve ndërmjet komponentëve shoqërorë dhe ekologjikë të të gjithë sistemit brenda peizazhit tokësor/detar, si dhe ndërveprimeve të cilat shfaqen përgjatë niveleve të ndryshme të shkallëve shoqërore dhe ekologjike. Suksesi varet shumë nga Kriteri 5, proceset gjithëpërfshirëse, transparente dhe fuqizuese të qeverisjes. Menaxhimi i përshtatur gjithashtu mund të kontribuojë në matjen e sasisë së karbonit të depozituar në tokë, në bimësi dhe qëndrimin e tij gjatë periudhës kohore, si dhe ndryshimet në përbërjen e biodiversitetit..

K-7.1 Strategjia e ZMN-ve krijohet dhe përdoret si bazë për monitorimin e vazhdueshëm dhe vlerësimin e ndërhyrjes

Në ZMN, teoria e ndryshimit nuk është statike; ajo është dinamike dhe njeh pasigurinë e sistemeve bio-ekonomike dhe kushteve të ndryshueshme. Supozimet dhe mendimet e identifikuara në teorinë e ndryshimit duhet të shqyrtohen vazhdimisht në bazë të gjendjes së krijuar fillestare. Fakte të tjera përkatëse dhe të reja shoqërore, ekonomike dhe ekologjike të cilat mund të rrisin ndikimet e ZMN-ve si dhe të zvogëlojnë rreziqet e rezultateve negative të paqëllimshme, duhet të merren parasysh gjithashtu në bazë të gjendjes fillestare. Plani i monitorimit dhe vlerësimit do të mundësojë

gjithashtu shqyrtimin sistematik të ndërhyrjes së ZMN-ve në bazë të gjendjes fillestare dhe fakteve të tjera të reja.

K- 7.2 Plani i monitorimit dhe vlerësimit zhvillohet dhe zbatohet përgjatë kohëzgjatjes së ndërhyrjes

Plani i monitorimit dhe vlerësimit (M&V), mundësisht plani M&V gjithëpërfshirës, i cili përfshin të gjithë aktorët në verifikimin e rezultateve dhe të nxënët, do të sigurojë se ndërhyrja e ZMN-ve është në rrugën e duhur për zbatimin dhe kryerjen dhe do të ndihmojë të menaxhohen ndikimet afatgjata pozitive dhe negative. Pavarësisht se ndonjëherë mund të perceptohet si punë administrative shtesë, ajo është qasje e fuqishme për të kuptuar nëse ndërhyrja e ZMN-së adreson në mënyrë të efektshme sfidat shoqërore. Për t'u siguruar se planifikimet për monitorimin nuk kompromentohen për shkak të masave të ndërprerjes së kostove, të gjitha planet e monitorimit duhet të krijohen përpara zbatimit. Në rastet kur është e nevojshme, M&V mund të kryhen në mënyrë të pavarur nga një palë e tretë. Në rastin e vetëverifikimit apo verifikimit nga një palë e dytë, rekomandohet fuqimisht kryerja e shqyrtimit apo vlerësimit të jashtëm të iniciativës, mundësisht në mes dhe në fund të procesit.

Kur kryhet siç duhet, M&V jo vetëm që ndihmon të vlerësohen ndryshimet gjatë ndërhyrjes, por gjithashtu të kuptohen ndikimet e menjëhershme dhe afatshkurtra mbi natyrën dhe jetën e njerëzve. Ai do të mbështesë ndërhyrjet e ZMN-ve për ruajtjen e përgjegjësisë dhe përputhshmërisë.

Një plan i tillë i M&V është gjithashtu i rëndësishëm kur identifikohen reagimet sipas kushteve të ndryshueshme të përshkruara në treguesin 7.1 dhe menaxhohen shmangiet përkatëse. Këto reagime do të shërbejnë si veprime të menaxhimit të përshtatur që do të ndërmerren nga komuniteti i aktorëve. Këto veprime duhet të zhvillohen dhe ekzekutohen sipas mënyrës gjithëpërfshirëse dhe

pjesëmarrëse, duke ruajtur për rrjedhojë Kriterin 5. Informacioni mbi proceset e identifikimit të veprimeve si dhe të ekzekutimit të veprimeve duhet të vihen në dispozicion për qëllime inspektimi, me atribuimet përkatëse, duke ruajtur privatësinë dhe sigurinë e informatorëve. Shkallët e dhura ekologjike dhe shoqërore duhet të pasqyrohen në M&V meqenëse ZMN-të mund të kenë ndikime në shkallë të ndryshme dhe veprimet mund të kërkojnë angazhimin në shkallë të ndryshme nga ZMN-ja fillestare. Pa një qasje të tillë të përshtatur veprimet mund të kenë ndikim të vogël ose mund të mos kenë ndikim fare.

K-7.3 Korniza për të nxënë të ripërsëritës e cila bën të mundur zbatimin e menaxhimit të përshtatur, zbatohet gjatë gjithë kohëzgjatjes së ndërhyrjes

LTë nxënë është procesi i zhvillimit të të kuptuarit të bazuar në fakte, dhe përshtatja është sistemimi i menaxhimit në bazë të informacionit të ri. Të nxënë e bazuar në fakte duhet të drejtojë menaxhimin e ZMN-ve. Për më tepër, të nxënë-zbatimi-ripërsëritja janë të rëndësishëm për informimin e veprimeve të menaxhimit të përshtatur, në mënyrë që të reagojë ndaj faktorëve që ndikojnë në ndërhyrjet e ZMN-ve. Për këtë Kriter, Treguesit 7.1 dhe 7.2 ofrojnë një qark të vazhdueshëm të reagimit (feedback loop) për të mësuar dhe përshtatur ndërhyrjen e ZMN-ve. Procese të tilla të reagimit mund të bëhen pjesë e planit të monitorimit dhe vlerësimit të ndërhyrjes, duke përcaktuar afatin kohor të qëndrueshëm për analizimin ripërsëritës. Të dhëna të mëtejshme, të marra si nga burimet e dijeve tradicionale ashtu edhe nga ato shkencore, mund të sillen në procesin e të nxënë ripërsëritës. Kjo është veçanërisht e rëndësishme duke pasur parasysh ndikimet e ndryshimeve klimatike të cilat ndikojnë tek ekosistemet. Në rastin ideal, të nxënë ripërsëritës është i institucionalizuar në mënyrë që të ushtrohet edhe pas përfundimit të ndërhyrjes së ZMN-së.

Kriteri 8: ZMN-të janë të qëndrueshme dhe të integruara brenda kontekstit të duhur territorial

Meqenëse ZMN-ja është një koncept i ri, i sapoprezantuar, informacioni për ZMN-të duhet të qarkullojë lirisht dhe në mënyrë të hapur, duke rritur kërkesën dhe ofertën e ZMN-ve. Kjo i lejon njerëzit të nxjerrin mësimet dhe të përcaktojnë nëse proceset e ZMN-ve duhet të përshtaten dhe mënyrën se si duhet të përshtaten. Sapo kjo të jetë e qartë, do të jetë i mundur shkallëzimi dhe/ose përsëritja e ZMN-së përkatëse. Si shkallëzimi ashtu edhe përsëritja do të sigurojnë të dhëna dhe do të rrisin nivelin e të kuptuarit të qasjes së ZMN-së, duke hartuar në vazhdim ZMN më të efektshme, më të përballueshme dhe më të qëndrueshme.

ZMN-të hartohen dhe menaxhohen për të qenë bashkëplotësuese të strukturave, politikave, planeve, ligjeve, rregulloreve institucionale dhe ndërhyrjeve në zonat përreth (shih përkatësisht Hartimi në Bazë të Shkallës Kriteri 2 dhe Menaxhimi i Përshtatur Kriteri 7). Megjithatë, pavarësisht se ndërhyrja ZMN mund të jetë e varur nga faktori kohë (për shembull, aty ku veprimet e caktuara, të tilla si mbjellja e mangroveve-rizofore është e kufizuar deri në pesë vjet), ZMN-të në përgjithësi, duke përfshirë kornizën përkatëse dhe ndikimin, vazhdojnë përtej këtyre kufijve. Qëllimi i këtij Kriteri është të sigurojë se ZMN-të mundësojnë integrimin e zgjidhjeve në mënyrë që të zgjasin në kohë.

Për të mbështetur përvetësimin dhe shkallëzimin e ZMN-së përgjatë periudhave kohore dhe përtej kufirit të caktuar kohor të ndërhyrjes, praktikuesit e ZMN-ve duhet të sigurojnë se ZMN-të do të kenë një trajektore afatgjatë, e cila do të zgjasë për shumë dhjetëvjeçarë. Ka qasje të ndryshme për integrimin e ZMN-ve, megjithatë të gjitha mbështeten te komunikimet dhe përfshirja e publikut. Publiku i cili mund të merret në konsideratë përfshin individët (publikun, akademikët), institucionet (qeverinë kombëtare, bizneset e vogla të sapokrijuara, organizatat joqeveritare) dhe rrjetet globale (Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm, Marrëveshja e Parisit).

K-8.1 Hartimi i ZMN-ve, zbatimi dhe mësimet e nxjerra ndahen për të sjellë ndryshime transformuese

Në mënyrë që qasja e ZMN-ve të shkallëzohet (integrohet), zgjerohet (zgjerohet në përmasat gjeografike, sektoriale apo të synuara) ose përsëritet, është e rëndësishme që procesi i hartimit dhe zbatimit, së bashku me mësimet e nxjerra, të jenë të disponueshme dhe të aksesueshme nga individët e caktuar apo në bazë të kërkesës së çdo aktori të ndikuar drejtpërdrejt apo mjaft të interesuar për përsëritjen e procesit. Publiku për këtë komunikim përfshin individë të tillë si vendimmarrësit në sektorët ku ZMN-ja mund të konsiderohet si zgjidhje, investuesit, përdoruesit e ZMN-ve nga sektorët publikë dhe privatë dhe publikun e gjerë. Shembujt përfshijnë buletinët për mësimet e nxjerra, konferencat për shtyp për partneritetet e formuara, trajnimet për kapacitetet mbi hartimin apo zbatimin, përmbledhjet informative dhe lobimin. Mësimet e nxjerra duhet të përfshijnë si pasojat pozitive ashtu edhe ato negative (duke përfshirë ato të paqëllimshme) dhe mënyrat e mundshme për t'i kapërcyer ato në të ardhmen.

Në mënyrë që këto komunikime të jenë të aksesueshme, duhet të merret parasysh publiku i cili mund të përballet me pengesa në lidhje me teknologjinë, kulturën apo sfondin ekonomiko-shoqëror. Praktikuesit e ZMN-ve mund të shohin të arsyeshëm botimin e rezultateve përmes një botuesi me akses të hapur. Për më tepër, mund të merret parasysh edhe vizibiliteti dhe rritja e ndërgjegjësimit në zonën e caktuar, përmes vendosjes së tabelave dhe shenjave sinjalistike.

K-8.2 ZMN-ja informon dhe rrit politikën lehtësuese dhe kuadrin rregullator për të mbështetur përdorimin dhe integrimin e saj

ZMN-të janë tashmë pjesë e një sërë politikave, planeve, ligjeve dhe rregulloreve të mëparshme, në disa raste kufizuese dhe në disa mbështetëse. ZMN-të duhet të adresojnë dhe të jenë në përputhje me kontekstin e ofruar nga politikat, planet, ligjet dhe rregulloret aktuale në mënyrë që të mund të përmbushin rezultatet e tyre të synuara (Hartimi në Bazë të Shkallës Kriteri 2), apo sugjerojnë politikat dhe rregulloret e nevojshme për të garantuar zbatimin e tyre të suksesshëm. Pamundësia për të realizuar këtë, mund të vërë në rrezik kohëzgjatjen dhe qëndrueshmërinë e ZMN-së në periudhën afatgjatë, për shembull, ajo kërkon përdorimin e veprimeve apo ndërhyrjeve të cilat mund të jenë në kundërshtim apo në mospërputhje me politikat dhe praktikën e strategjisë së krijuar të përdorimit të tokës. Mund të ketë edhe situata të tilla ku politikat ekzistuese të përdorimit të tokës dëmtojnë njëra-tjetrën dhe për rrjedhojë, shtojnë sfida të tjera për zbatimin e ZMN-së. Në bazë të këtyre rrethanave, ZMN-të mund t'i ndihmojnë politikëbërësit që t'i evidentojnë këto mospërputhje dhe të nxitin ndryshimin e rregulloreve në mënyrë që të sigurohet qëndrueshmëria dhe kohëzgjatja e tyre.

Në disa raste, mund të lindin kontradikta për objektivat apo kërkesat e ndryshme të përdorimit të tokës apo të politikave sektoriale, të cilat mund të zbehin efikasitetin dhe/ose efektshmërinë e zbatimit të ZMN-së. Këto duhet të dokumentohen së bashku me mundësitë për zgjidhjen e këtyre pengesave për qëllime të monitorimit dhe për marrjen parasysh të politikëbërësve. Në mënyrë që të përmirësohet hartimi dhe të ndërmjetësohet harmonizimi i duhur i politikave të ZMN-ve të ardhshme, rezultatet e monitorimit dhe vlerësimit, si dhe format e tjera të nxjerrjes së mësimave, duhet të ruhen dhe të vihen në dispozicion të sektorit publik.

K- 8.3 Në rastet përkatëse, ZMN-ja kontribuon ndaj objektivave kombëtare dhe globale për mirëqenien e njeriut, ndryshimet klimatike, biodiversitetin dhe të drejtat e njeriut, duke përfshirë Deklaratën e Kombeve të Bashkuara për Të Drejtat e Popujve Autoktonë (UNDRIP)

Objekti i ZMN-ve është adresimi i sfidave shoqërore globale. ZMN-të individuale ndërtohen në bazë të kësaj logjike, përmes dokumentimit të progresit në drejtim të përmirësimit të mirëqenies së njeriut (duke përfshirë shëndetin, pasurinë, etj.) dhe trajtimit të krizave të klimës dhe biodiversitetit. Aty ku ndikimet e ZMN-ve kontribuojnë ndaj objektivave kombëtare dhe globale përkatëse (të paraqitura në Hartimin në Bazë të Shkallës Kriteri 2), organet përgjegjëse për këto objektiva duhet të informohen në mënyrë që ky ndikim të dokumentohet. Objektivat që duhet të merren parasysh përfshijnë:

- Politikat, rregulloret dhe ligjet kombëtare dhe rajonale;
- Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm të Kombeve të Bashkuara (OZHQ);
- Dhjetëvjeçari i Kombeve të Bashkuara për Restaurimin e Ekosistemit;
- Objektivat e Konventës së Kombeve të Bashkuara në Luftën Kundër Shkretëtirëzimit (UNCCD) të tilla si Neutraliteti i Degradimit të Tokës (NDT);
- Objektivat e caktuara për sfidat shoqërore (Marrëveshja e Parisit, Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSH), Objektivat Globale të Ushqimit, Korniza Sendai për Zvogëlimin e Rrezikut nga Fatkeqësitë [KSZRF]);
- Objektivat e caktuara për krizat e biodiversitetit (Objektivat Aichi apo pasuesit e tyre, Protokollin Nagoya për Ndarjen e Aksesit dhe Përfitimit apo pasuesit e tij, Strategjitë Kombëtare të Biodiversitetit dhe Planet e Veprimit SKBPV).

Ofrimi i informacionit për ata të cilët janë përgjegjës për objektivat, mund të realizohet përmes transferimit të dijeve, njoftimeve për politikat, takimeve me politikëbërësit apo raportimit ndaj mekanizmave të ndryshme të politikave.

5. Si përdoret Standardi





Standardi është realizuar për t'u përdorur për hartimin, verifikimin dhe shkallëzimin si një mjet i lehtë, i thjeshtë por i qëndrueshëm, i cili përforcon praktikën më të mirë, duke adresuar dhe korrigjuar mangësitë dhe duke bërë të mundur që ndërhyrjet të harmonizohen me parimet e ZMN-ve të pranura në rang ndërkombëtar (WCC-2016-Res-069). Përdoruesit mund ta aplikojnë Standardin si ndaj ndërhyrjeve të vazhdueshme ashtu edhe ndaj atyre të propozuara duke përdorur mjetin e vetëvlerësimit, i cili është hartuar në mënyrë që të përdoret së bashku me mjetet ekzistuese të menaxhimit të projektit dhe qasjeve teknike. Treguesit, udhëzuesi i tyre dhe shkallët e vlerësimit pikësor mund të harmonizohen me sistemet e raportimit dhe menaxhimit operativ në mënyrë që të minimizohet puna e panevojshme shtesë.

Për fazën fillestare të Standardit të ZMN-ve, është realizuar një mjet vetëvlerësimi (i shkarkueshëm këtu) për t'i dhënë mundësi përdoruesve të Standardit që të llogarisin përputhjen e përqindjes së ndërhyrjes së tyre kundrejt tetë Kriterëve dhe për të identifikuar nëse ndërhyrja e tyre është në përputhje me Standardin Global të IUCN-së për ZMN-të. Fleta e vetëvlerësimit në formën e një tabele Excel, i jep mundësinë përdoruesve të identifikojnë se deri në çfarë niveli ndërhyrja e tyre përputhet me Treguesit individualë: i fuqishëm, i

përshtatshëm, i pjesshëm apo i pamjaftueshëm. Përdoruesve më pas u ofrohet një sistem me dritat e semaforit për secilin Kriter, i cili u jep mundësinë të identifikojnë zonat e përmirësimit dhe të japin një ide të përgjithshme nëse ndërhyrja përputhet me Standardin Global të IUCN-së për ZMN.

Për secilin Tregues, regjistrohet vetëm një rezultat nga katër opsionet, në varësi të adresimit të Treguesit nga ndërhyrja sipas shkallëzimit: i fuqishëm, i përshtatshëm, i pjesshëm apo i pamjaftueshëm. Rezultati përdoret për të përllogaritur nivelin e përmbushjes së tij të secilit Kriter individual, duke përcaktuar gjithashtu rezultatin: i fuqishëm, i përshtatshëm, i pjesshëm apo i pamjaftueshëm për pikët më të mëdha se 75, ndërmjet 50 dhe 75, ndërmjet 25 dhe 50 dhe më të ulëta se 25% përkatësisht (Tabela 1). Këto pikë të Treguesit më tej normalizohen në mënyrë që secili Kriter të ketë peshë të barabartë. Pas normalizimit, pikët e Kriterit kombinohen për të dhënë një përputhje të përgjithshme në përqindje. Pavarësisht nga përputhja, nëse një ndërhyrje shënon një klasifikim "i pamjaftueshëm" në bazë të çdo Kriteri, atëherë ajo nuk është në përputhje me Standardin Global të IUCN-së për ZMN-të. Përputhja e përqindjes më tej mund të përdoret për të përshkruar nëse ky rezultat është i fuqishëm, i përshtatshëm apo i pjesshëm.

Tabela 1: Rezultati i fletës së vetëvlerësimit.

Treguesi (%)		Produkti
	≥75 i Fuqishëm	Ndërhyrja është në përputhje me Standardin Global.
	≥50 & <75 i Përshtatshëm	
	≥25 & <50 i Pjesshëm	
	<25 i Pamjaftueshëm	Ndërhyrja nuk është në përputhje me Standardin Global të IUCN-së për ZMN-të.

Pavarësisht se në bazë të Standardit vlerësohet nëse hartimi i një ndërhyrjeje përmbush kërkesat klasifikuese për ZMN-të, ekzekutimi i ndërhyrjes

Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore do të kërkohejshin për të vënë në funksion ZMN-në, menjëherë sapo ajo të hartohej në bazë të tetë




Figure 7: Si përdoret Standardi dhe si lidhet ai me vetëvlerësimin. (© IUCN)

do të kërkojë Standarde për funksionalizimin, mjete apo qasje të tjera. Si shembull mund të marrim rastin nëse një pellg i caktuar ujëmbledhës do të menaxhohej për të zvogëluar rrezikun nga përmbytjet, mjete të tilla si direktivat për

Kritereve (Figura 7). Në këtë drejtim, roli i Standadit Global për ZMN-të është të bashkëplotësojë dhe jo të zëvendësojë përdorimin e Standardeve të tjera.

5.1 Si bëhet vetëvlerësimi

Vetëvlerësimi në bazë të Standardit të ZMN-së duhet të kryhet në faza të ndryshme të kohëzgjatjes së projektit, për të ndihmuar në identifikimin e produkteve të papërsheptuara, pikave të dobëta dhe atyre të forta, në mënyrë që ato të përmirësohen apo të lehtësohen. Për rrjedhojë, vetëvlerësimi nuk duhet të shihet si

gjykimi i një projekti ZMN-je. Objektivi i tij është kryesisht të sigurojë përfitimet ndaj shoqërisë pa vënë në rrezik natyrën dhe anasjelltas. Vetëvlerësimi përmban sistemin sipas kodit të dritave të semaforit për të treguar statusin e Treguesve të ndryshëm sipas renditjes, ku jeshilja tregon se Treguesi përmbushet plotësisht,

portokallija tregon se ai përmbushet pjesërisht dhe e kuqja tregon se ai nuk përmbushet. Vetëvlerësimi kryhet si më poshtë:

- Shqyrtoni Treguesit, udhëzuesin dhe shembujt në Pjesën II dhe merrni parasysh mjetet e sugjeruara të verifikimit;
- Identifikoni mjetet e verifikimit të cilat janë të përshtatshme për të treguar se deri në çfarë niveli ZMN-ja përmbush një Tregues përkatës duke përdorur udhëzuesin e shkallëzimit: i fuqishëm, i përshtatshëm, i pjesshëm dhe i pamjaftueshëm të ofruar në mjetin e vetëvlerësimit;
- Përshkruani si dhe deri në çfarë niveli ZMN-ja juaj përmbush Treguesin në kutitë e ofruara të mjetit të vetëvlerësimit;
- Siguroni faqet e internetit për mjetet e verifikimit të përdorur (nëse janë të disponueshme online) apo lidhini ato me vetëvlerësimin tuaj për të provuar gjetjet tuaja;

- Kontrolloni fletën e përmbledhëse për rezultatet sipas kodit të dritave të semaforit, përqindjen e përputhjes së përgjithshme dhe nëse ndërhyrja është në përputhje me Standardin Global të IUCN-së për ZMN-të;
- Ndani, raportoni dhe diskutoni gjetjet meqenëse nevojiten për të përmirësuar apo zbatuar zgjidhjet;
- Bëhuni fleksibël dhe ripërsërisni procesin sipas nevojës në rastet kur disa aspekte ndryshojnë.

Parts I and II of the Standard will later be supplemented by a user-guide (Part III) and platform sharing approaches and tools. In the meantime, users of the Standard can join the global community of practice here, where they can also find assistance and FAQs. Questions can also be directed to NbSStandard@iucn.org to reach the NbS Group at IUCN.

Fjalori i përkufizimeve

Termi	Përkufizimi	Burimi	Link-u
Veprim	Veprimet konsiderohen më shumë si një ushtrim aktiv i pjesëmarrjes demokratike në shoqëri se sa sjellje reaguese apo ndryshime të stilit të jetës. Veprimi duhet të ndërmerret në mënyrë të vetëdijshme, të qëllimshme dhe të vullnetshme.	Fjalor i Mjeteve për KDB	https://www.cbd.int/cepa/toolkit/2008/doc/CBD-Toolkit-Glossaries.pdf
Plan-veprim	Plani i shkruar i zbatimit, shpesh duke dhënë hollësi për afatet kohore, fazat, rolet dhe/ose përgjegjësitë e projekteve të lidhura me objektivat e strategjisë.	Fjalor i Mjeteve për KDB	https://www.cbd.int/cepa/toolkit/2008/doc/CBD-Toolkit-Glossaries.pdf
Përshtatje	Iniciativat dhe masat për të ulur rrezikun e cënueshmërisë së sistemeve natyrore dhe njerëzore kundrejt ndikimeve të ndryshmeve klimatike ekzistuese apo të pritshme. Përshtatja është e llojeve të ndryshme dhe përfshijë: e pritshme dhe reaguese, private dhe publike, e pavarur dhe e planifikuar.	Fjalori i IUCN-së	https://www.iucn.org/sites/dev/files/iucn-glossary-of-definitions_en.pdf
Menaxhim i përshtatur	Procesi sistematik i politikave dhe praktikave në përmirësim të vazhdueshëm duke nxjerrë mësim nga rezultatet e programeve ekzistuese.	Fjalori i IUCN-së	https://www.iucn.org/sites/dev/files/iucn-glossary-of-definitions_en.pdf
Vlerësim	Analizimi dhe shqyrtimi i informacionit të nxjerrë nga kërkimet, me qëllim ardhjen në ndihmë personit përgjegjës për të vlerësuar veprimet e mundshme apo për të menduar për një problem. Vlerësimi nënkupton mbledhjen, përmbledhjen, organizimin, interpretimin dhe madje edhe përfshirjen e pjesëve nga njohuritë ekzistuese dhe komunikimin e tyre në mënyrë të përshtatshme për t'i ardhur në ndihmë vendimmarrësit inteligjent por me mungesë e ekspertizës së duhur.	Fjalori i terminologjisë së hartimit dhe vlerësimit të shërbimeve të ekosistemit	https://oneecosystem.pensoft.net/articles.php?id=27110
Gjendje fillestare	Referimi i sasive të matshme nga të cilat mund të matet një rezultat alternativ, p.sh. një skenar i mosndërhyrjes i përdorur si referim për analizimin e skenarëve të ndërhyrjes.	IPCC	https://www.ipcc.ch/pdf/assessment-report/ar4/syr/ar4_syr_appendix.pdf
Përfitues të shërbimit të ekosistemit	Çdo individ, grup individësh apo ent i cili përdor apo mund të përdorë përfitimet e përftuara nga natyra të ofruara nga njësia e menaxhimit. Shembujt përfshijnë dhe nuk kufizojnë individët, grupet e individëve apo entet që gjenden në njësitë vendore ku përfshihet menaxhimi. Përdoruesit fundorë të tillë si konsumatorët apo përfituesit indirektë nga zbutja e karbonit nuk konsiderohen si përfitues.	Shërbimet e Ekosistemit Procedura: Demonstrimi i Ndikimit dhe Mjetet e Tregut	https://ic.fsc.org/file-download/ecosystem-services-procedure-a-7433.pdf
Përfitime/ Ndikim	Përfitime: Ndryshimi pozitiv i "mirëqenies" nga përmbytja e nevojave dhe dëshirave. Ndikim: ndikimi pozitiv ndaj individëve, shoqërisë dhe burimeve mjedisore që shkaktohet nga ndryshimi mjedisor.	Fjalori i terminologjisë së hartimit dhe vlerësimit të shërbimeve të ekosistemit	https://oneecosystem.pensoft.net/articles.php?id=27110
Biodiversitet	Biodiversiteti: forma e shkurtuar për diversitetin biologjik që nënkupton diversitetin e jetës në të gjitha format e saj – diversiteti i llojeve dhe i ekosistemeve. Rëndësia e diversitetit biologjik ndaj shoqërisë njerëzore është e vështirë për t'u përshkruar me fjalë. Ekonomia globale është përllogaritur se bazohet në masën 40% në produktet dhe proceset biologjike. Njerëzit e varfër, veçanërisht ata të cilët jetojnë në zona me prodhimtari të ulët bujqësore, janë ata që varen pikërisht më shumë nga diversiteti gjenetik i mjedisit.	Fjalor i Mjeteve për KDB	https://www.cbd.int/cepa/toolkit/2008/doc/CBD-Toolkit-Glossaries.pdf

Termi	Përkufizimi	Burimi	Link-u
Humbje e biodiversitetit	Që në kohën kur njerëzit zunë vend për herë të parë në Tokë dhe filluan të gjuanin kafshë, të mblidhnin ushqim dhe të prisnin dru, kanë ushtruar ndikim ndaj biodiversitetit. Gjatë dy shekujve të fundit, rritja e popullsisë së njeriut, shfrytëzimi me tepri i burimeve natyrore dhe degradimi i mjedisit kanë shkaktuar një rënie drastike të biodiversitetit global. Llojet e ndryshme po reduktohen apo po zhduken, ekosistemet po pësojnë dëme apo po humbasin. 80% e pyjeve të mëparshme të cilat mbulonin Tokën 8 000 vjet më parë janë zhdukur, dëmtuar apo degraduar. Disa ekspertë vlerësojnë se ritmi me të cilin llojet po zhduken në ditë është 1 000 deri 10 000 herë më i lartë sesa do të ishte ritmi natyror.	Fjalor i Mjeteve për KDB	https://www.cbd.int/cepa/toolkit/2008/doc/CBD-Toolkit-Glossaries.pdf
Ujëmbledhës	Zona e grumbullimit të ujit të një lumi apo trupi ujor. Termi shpesh përdoret si i këmbyesëm me pellgun ujëmbledhës. Shih përkufizimin e pellgut ujëmbledhës.	Fjalori i IUCN-së	https://www.iucn.org/sites/dev/files/iucn-glossary-of-definitions_en.pdf
Shërbime të përshtatjes ndaj klimës	Përfitimet e njerëzve nga rritja e nivelit të aftësisë shoqërore për të reaguar ndaj ndryshimit, të ofruara nga kapaciteti i ekosistemeve për të ndryshuar dhe për t'u përshtatur ndaj ndryshimeve dhe paqëndrueshmërisë klimatike.	IUCN 2016, Botimi për Zgjidhjet e Mbështetura tek Natyra – (Lavorel et al., 2015)	https://portals.iucn.org/library/sites/library/files/documents/2016-036.pdf
Ndryshime klimatike	Ndryshimet klimatike i referohen çdo ndryshimi të klimës përgjatë periudhave kohore, qoftë për shkak të ndryshimeve natyrore ose për shkak të veprimtarisë së njeriut. Ky përdorim ndryshon nga ai i Konventës Kornizë të Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike, i cili i përkufizon "ndryshimet klimatike" si "ndryshimi i klimës i shkaktuar direkt apo indirekt nga veprimtaria e njeriut, i cili ndryshon përbërjen e atmosferës globale dhe i cili përveç paqëndrueshmërisë klimatike natyrore, vëzhgohet gjatë periudhave kohore të krahasueshme".	Fjalori i IUCN-së	https://www.iucn.org/sites/dev/files/iucn-glossary-of-definitions_en.pdf
Mbyllje	Mbyllja e Projektit ka për qëllim të përdorë në të ardhmen mësimet e nxjerra nga projekti.	IUCN PAAS	https://www.iucn.org/resources/project-management-tools/project-guidelines
Përbërje	Grupi i organizmave brenda një sistemi. Në planin e restaurimit apo monitorimit zakonisht ato renditen sipas specieve apo llojeve (për bimët dhe faunën vertebrorë) apo sipas rendit (për jovertebrorët dhe mikroorganizmat).	Standardet ndërkombëtare për praktikën e restaurimit ekologjik – duke përfshirë parimet dhe konceptet kyçe	http://seraustoralasia.com/wheel/image/SER_International_Standards.pdf
Koncept	Njësia e njohurive e krijuar nga kombinimi i karakteristikeve unike. Konceptet janë përmbledhje abstrakte, nocione të përgjithshme, njohuri, etj., një grupim i të gjitha sjelljeve, qëndrimeve apo karakteristikave të cilat kanë diçka të përbashkët. Konceptet përdoren për të ndihmuar për paraqitjen/ përcimin e saktë të kuptimit, kategorizimit, interpretimit, strukturimit dhe arsyetimit të dukurisë.	Fjalori i Termave të Klasifikimit, i Kombeve të Bashkuara i përgatitur nga Grupi i Ekspertëve për Klasifikimet Ndërkombëtare Ekonomike dhe Shoqërore	http://data.un.org/Glossary.aspx?q=scientific+knowledge
Konflikt	Mospërputhja e opinioneve, parimeve, etj. Konflikti nuk është domosdoshmërisht negativ, anormal apo jofunksional, por më tepër një element i ndërveprimit njerëzor. Kur mendohet për drejtimit e marra nga shoqëria, proceset e qeverisjes me të cilat ne trajtojmë konfliktin janë ato të cilat kanë vërtet rëndësi. Aty ku ka konflikt, palët mund të jenë më pak të prirura apo në gjendje për të marrë pjesë plotësisht apo në mënyrë konstruktive në negociime, derisa konflikti të njihet siç duhet.	Fjalori i IUCN-së i Ligjit për Mjedisin	https://www.iucn.org/theme/environmental-law/our-work/water/water-law-and-governance-support-platform/learning-resources/glossary#PStext

Termi	Përkufizimi	Burimi	Link-u
Lidhshmëri	Shkëmbimet e jashtme apo qarkullimet në 2 drejtime të cilat shfaqen ndërmjet njësie ekologjike brenda peizazhit tokësor apo mjedisit ujor, duke përfshirë qarkullimin e energjisë, ujit, zjarrit, materialit gjenetik, kafshëve dhe farave. Shkëmbimet ndërmjetësohen përmes lidhshmërisë me habitatin.	Standardet ndërkombëtare për praktikën e restaurimit ekologjik – duke përfshirë parimet dhe konceptet kyçe	http://seraustoralasia.com/wheel/image/SER_International_Standards.pdf
Ruajtje	Mbrojtja, kujdesi, menaxhimi dhe mirëmbajtja e ekosistemeve, habitateve, llojeve të botës së egër dhe popullatave, brenda dhe jashtë mjediseve të tyre natyrore, në mënyrë që të mbrohen kushtet natyrore për performancën e tyre afatgjatë. Ruajtja jashtë zonës. Ruajtja e komponentëve të diversitetit biologjik jashtë habitateve të tyre natyrore. Ruajtja e zonës. Ruajtja e ekosistemeve dhe habitateve natyrore dhe mirëmbajtja dhe rikuperimi i popullatave të rëndësishme të llojeve në mjediset e tyre natyrore ku ata kanë zhvilluar karakteristikat e tyre të veçanta.	Fjalori i IUCN-së	https://www.iucn.org/sites/dev/files/iucn-glossary-of-definitions_en.pdf
Konsultim	Konsultimi është procesi i dyanshëm i dialogut ndërmjet kompanisë së projektit dhe aktorëve të tij. Konsultimi i aktorëve në të vërtetë lidhet me fillimin dhe ruajtjen e marrëdhënieve të jashtme konstruktive gjatë periudhave kohore. Kompanitë të cilat e fillojnë këtë proces shpejt dhe përdorin pikëpamje strategjike afatgjata, kanë filluar faktikisht të zhvillojnë "licensën e tyre sociale për të vepruar".	Korporata Ndërkombëtare e Financave	https://www.ifc.org/wps/wcm/connect/5a4e740048855591b724f76a6515bb18/PartOne_StakeholderConsultation.pdf?MOD=AJPERES
Kosto	Kostot e projektit përbajnë të gjitha kostot të cilat shfaqen në vazhdim të projektit. Ato mund të llogariten për paketa individuale të punës, për planifikimin e objekteve individuale, për detyra të brendshme, dhe për të gjithë projektin.	Garies, R., Huemann, M., & Martinuzzi, A., 2010. Lidhja e zhvillimit të qëndrueshëm me menaxhimin e projektit: një model konceptual	https://www.pmi.org/learning/library/relating-sustainable-development-project-management-6497
Analizë kosto-përfitim	Mjeti i vendimit i cili gjykon nivelin e pritshmërive të projektit në krahasim me kostot dhe përfitimet e tyre.	Fjalor i IUCN-së	https://www.iucn.org/sites/dev/files/iucn-glossary-of-definitions_en.pdf
Kulturor	"Kulturor" i referohet tipareve shpirtërore, materiale, intelektuale dhe emocionale të shoqërisë apo një grupi shoqëror së bashku me artin, letërsinë, stilet e jetës, mënyrat e jetesës së përbashkët, sistemin e vlerave, traditat dhe besimet.	UNESCO	https://unesdoc.unesco.org/ark:/48223/pf0000127162
Diversitet Kulturor	Shumëllojshmëria apo larmishmëria e strukturave të shoqërisë njerëzore dhe strategjive për përshtatjen ndaj situatave në pjesë të ndryshme të botës. Gjuha është treguesi më i qartë i diversitetit kulturor, ku aktualisht fliten mbi 6 000 gjuhë.	Fjalor i Mjeteve për KDB	https://www.cbd.int/cepa/toolkit/2008/doc/CBD-Toolkit-Glossaries.pdf
Shërbime kulturore të ekosistemit	Përfitimet jomateriale që njerëzit përfitojnë nga ekosistemet përmes pasurimit shpirtëror, zhvillimit njohës, reflektimit, veprimtarive argëtuese, dhe përvojës estetike, duke përfshirë p.sh. sistemet e dijeve, marrëdhëniet shoqërore dhe vlerat estetike.	Shërbimet Mijëvjeçare të Ekosistemit	https://www.millenniumassessment.org/documents/document.776.aspx.pdf
Vendimmarrës	Personi, i cili përmes vendimeve të tij dhe veprimeve që rezultojnë prej tyre, mund të ushtrojë ndikim ndaj një kushti, procesi apo çështjeje nën shqyrtim.	Shërbimet Mijëvjeçare të Ekosistemit	https://www.millenniumassessment.org/documents/document.776.aspx.pdf

Termi	Përkufizimi	Burimi	Link-u
Fatkeqësi	Ndërprerja serioze e funksionimit të një komuniteti apo shoqërie duke shkaktuar humbje të mëdha në njerëz, materiale, ekonomi apo mjedis, e cila e tejkalon aftësinë e komunitetit apo shoqërisë së ndikuar për të vepruar me anë të burimeve të veta (ISDR 2004 – Strategjia Ndërkombëtare për Zvogëlimin e Fatkeqësive Natyrore 2004 SDZFN). Zvogëlimi i Rrezikut nga Fatkeqësitë. Njerëzit dhe institucionet e përfshira në përgatitjen, zbutjen (p.sh. përforsimi i strukturave të ndërtimit, përmirësimi i ndërgjegjësimit të publikut për rreziqet nga fatkeqësitë), dhe veprimtaritë parandaluese (p.sh. mbjellja e pemëve për të stabilizuar brigjet e lumit) të shoqëruara me ngjarje ekstreme. Këto përfshijnë parashikimin e rreziqeve dhe përpjekjeve të menjëhershme për ndihmë përballë fatkeqësive të mëdha që vijnë nga përmbytjet, ciklonet dhe në disa raste nga ngjarjet e ndotjes (përshtatur nga IISD/ IUCN/SEI 2003).	Fjalori i IUCN-së	https://www.iucn.org/sites/dev/files/iucn-glossary-of-definitions_en.pdf
Rrezik nga fatkeqësitë	Rastet e humbjes së jetës, dëmtimet, shkatërrimet apo dëmet ndaj kapitaleve, me të cilat mund të përballen një sistem, shoqëri apo komunitet në një periudhë të caktuar kohore, të përcaktuara si funksionim i mundshëm i ngjarjeve të dëmshme, ekspozimit, çënueshmërisë dhe kapacitetit.	Monty, F., Murti, R., Miththapala, S. and Buyck, C., 2017. Ekosistemet në mbrojtje të infrastrukturës dhe komuniteteve: mësimet e nxjerra dhe direktivat për zbatim.	https://portals.iucn.org/library/sites/library/files/documents/2017-045.pdf
Inxhinieri ekologjike	Menaxhimi i sistemeve të projektuara nga njeriu apo të krijuara nga mjedisi apo menaxhimi i dritës i cili bashkon projektimin njerëzor me krijimin mjedisor në mënyrë që ato të jenë simbiotike në mënyrë të ndërsjelltë. Projektimi i ekosistemeve të qëndrueshme të cilat integrojnë shoqërinë njerëzore me mjedisin e saj natyror për përfitim të dyjave.	IUCN 2016 Botimi për Zgjidhjet e Mbështetura tek Natyra (Odum, 1996) & (Mitsch, 2012)	https://portals.iucn.org/library/sites/library/files/documents/2016-036.pdf
Subvencione Ekologjike	Burimi i kontrolluar nga donatorët (preja, mbetjet, ushqyesit) nga njëri habitat tek marrësi i një habitati të dytë (bima apo konsumatori), i cili rrit prodhimtarinë e popullsisë marrëse, duke ndryshuar mundësisht dinamikën e konsumatorit dhe burimin e sistemit marrës.	Polis et al., 1997	https://www.annualreviews.org/doi/pdf/10.1146/annurev.ecolsys.28.1.289
Ekosistem	Në bazë të Marrëveshjes për Diversitetin Biologjik, ekosistemi është një kompleks dinamik i komuniteteve të bimëve, kafshëve dhe mikroorganizmave dhe mjedisit jo të gjallë, i cili ndërvepron si njësi funksionale. Ekosistemet mund të jenë të vegjël dhe të thjeshtë, si p.sh. një pellg i izoluar, apo të mëdhenj dhe të ndërlikuar, si p.sh. një pyll i caktuar tropikal apo guma koralore në detet tropikale.	Fjalori i IUCN-së	https://www.iucn.org/sites/dev/files/iucn-glossary-of-definitions_en.pdf
Qasje e ekosistemit	Qasja e ekosistemit është strategjia për menaxhimin e integruar të tokës, ujit apo burimeve të gjalla, e cila nxit dhe mbështet ruajtjen dhe përdorimin e qëndrueshëm në mënyrë të barabartë. Qasja e ekosistemit i vendos nevojat e njeriut në qendër të menaxhimit të biodiversitetit. Ajo ka për qëllim të menaxhojë ekosistemin, në bazë të funksioneve të shumta që kryejnë ekosistemet dhe përdorimet e shumta të cilat vijnë nga këto funksione. Qasja e ekosistemit nuk ka për qëllim të nxjerrë fitime ekonomike afatshkurtra, por ka për qëllim të optimizojë përdorimin e një ekosistemi pa e dëmtuar atë.	Fjalor i Mjeteve për KDB	https://www.cbd.int/cepa/toolkit/2008/doc/CBD-Toolkit-Glossaries.pdf

Termi	Përkufizimi	Burimi	Link-u
Funksion i ekosistemit	Madhësia, biodiversiteti, stabiliteti, shkalla e organizimit, shkëmbimet e brendshme të materialeve, energjia, dhe informacioni ndërmjet grupeve të ndryshme dhe vetitë e tjera që karakterizojnë një ekosistem. Përfshin funksionet dhe proceset e ekosistemit.	Shërbimet Mijëvjeçare të Ekosistemit	https://www.millenniumassessment.org/documents/document.776.aspx.pdf
Shëndet i ekosistemit	Gjendja e një ekosistemi: Kapaciteti i një ekosistemi për të ofruar shërbime, në varësi të kapacitetit të tij të mundshëm. Gjendja e një shërbimi të ekosistemit: Kapaciteti i një shërbimi të ekosistemit për të siguruar përfitime ndaj njerëzve, në varësi të kapacitetit të tij të mundshëm.	Shërbimet Mijëvjeçare të Ekosistemit	https://www.millenniumassessment.org/documents/document.776.aspx.pdf
Menaxhim i ekosistemit	Menaxhimi (i një ekosistemi) – një kategorizim i gjerë i cili mund të përfshijë mirëmbajtjen dhe rikuperimin e ekosistemeve (duke përfshirë restaurimin).	Standardet ndërkombëtare për praktikën e restaurimit ekologjik – duke përfshirë parimet dhe konceptet kyçe	http://seraustoralasia.com/wheel/image/SER_International_Standards.pdf
Proces i ekosistemit	Çdo ndryshim apo reaksion fizik, kimik apo biologjik, i cili shfaqet brenda ekosistemeve. Proceset e ekosistemit përfshijnë dekompozimin, prodhimin, ciklin e ushqyesve, fluksin e ushqyesve dhe energjinë.	Fjalori i terminologjisë së hartimit dhe vlerësimit të shërbimeve të ekosistemit	https://oneecosystem.pensoft.net/articles.php?id=27110
Veti të ekosistemit	Veçoritë të cilat karakterizojnë një ekosistem, të tilla si madhësia, biodiversiteti, stabiliteti, shkalla e organizimit, si dhe funksionet dhe proceset e tij (d.m.th. shkëmbimet e brendshme të materialeve, energjisë dhe informacionit ndërmjet grupeve të ndryshme).	Fjalori i terminologjisë së hartimit dhe vlerësimit të shërbimeve të ekosistemit	https://oneecosystem.pensoft.net/articles.php?id=27110
Shërbime të ekosistemit	Përfitimet që njerëzit marrin nga ekosistemet. Këto përfshijnë shërbimet e gatshme nga natyra të tilla si ushqimet dhe uji; shërbimet rregullatore të tilla si kontrollimi i përmbytjeve dhe sëmundjeve; shërbimet kulturore të tilla si shpirtërore, zbavitëse, dhe përfitimet kulturore; dhe shërbimet mbështetëse të tilla si cikli i ushqyesve, të cilat përmbajnë kushtet për jetën mbi Tokë. Koncepti “mallrat dhe shërbimet” nga ekosistemi është sinonimik me shërbimet e ekosistemit.	Shërbimet Mijëvjeçare të Ekosistemit	https://www.millenniumassessment.org/documents/document.776.aspx.pdf
Administrim i ekosistemit	Administrimi i ekosistemit është korniza e orientuar drejt veprimit për të nxitur qëndrueshmërinë shoqërore-ekologjike të planetit i cili po ndryshon me ritme të shpejta. Qëllimi i tij kryesor është të ruajë kapacitetin për të siguruar shërbimet e ekosistemit të cilat mbështesin mirëqenien e njeriut në bazë të kushteve të pasigurisë dhe ndryshimit. Administrimi i ekosistemit integron tri qasje të mbivendosura të qëndrueshmërisë: (i) zvogëlimin e cënueshmërisë ndaj ndryshimeve të papritura; (ii) nxitjen e aftësisë ripërtëritëse për të ruajtur kushtet e dëshirueshme përballë ankthit dhe pasigurisë dhe (iii) shndërrimin nga trajektoret e padëshirueshme kur shfaqen mundësitë (për ndryshim).	Administrimi i ekosistemit: strategjitë e qëndrueshmërisë për planetin i cili po ndryshon në mënyrë të shpejtë	http://dx.doi.org/10.1016/j.tree.2009.10.008
Strukturë e ekosistemit	Karakteristika e pandryshueshme e “Ekosistemit” e cila matet si stog apo vëllim i materialit apo energjisë, apo përbërja dhe shpërndarja e elementëve biofizikë.	Fjalori i terminologjisë së hartimit dhe vlerësimit të shërbimeve të ekosistemit	https://oneecosystem.pensoft.net/articles.php?id=27110
Përshtatje e mbështetur në ekosistem	Përdorimi i biodiversitetit dhe shërbimeve të ekosistemit si pjesë e strategjisë së përgjithshme të përshtatjes për të ndihmuar njerëzit të përshtaten ndaj ndikimeve të dëmshme të ndryshimeve klimatike.	IUCN 2016 Botimi për Zgjidhjet e Mbështetura tek Natyra – (CBD, 2009)	https://portals.iucn.org/library/sites/library/files/documents/2016-036.pdf

Termi	Përkufizimi	Burimi	Link-u
Zvogëlim i rrezikut nga fatkeqësitë e mbështetur tek ekosistemi	Menaxhimi i qëndrueshëm, ruajtja dhe restaurimi i ekosistemeve me qëllim ofrimin e shërbimeve të cilat zvogëlojnë rrezikun nga fatkeqësitë duke shmangur dëmet dhe duke ripërtërirë jetën e njerëzve.	IUCN 2016 Botimi për Zgjidhjet e Mbështetura tek Natyra – (PEDRR, 2010)	https://portals.iucn.org/library/sites/library/files/documents/2016-036.pdf
Menaxhim i mbështetur tek ekosistemi	Qasja e integruar dhe e mbështetur tek shkencat për menaxhimin e burimeve natyrore e cila ka për qëllim ruajtjen e shëndetit, aftësisë ripërtëritëse dhe diversitetit të ekosistemeve, ndërkohë që lejon përdorimin e qëndrueshëm nga njerëzit të mallrave dhe shërbimeve që ato ofrojnë.	IUCN 2016 Botimi për Zgjidhjet e Mbështetura tek Natyra – (Kappel et al., 2006) & (Garcia et al., 2003)	https://portals.iucn.org/library/sites/library/files/documents/2016-036.pdf
Zbutje e mbështetur tek ekosistemi	Rrit përfitimet dhe shmang ndikimet negative ndaj biodiversitetit duke zvogëluar emetimet, duke marrë parasysh nevojën për të siguruar pjesëmarrjen e plotë dhe të efektshme të komuniteteve autoktone dhe lokale në proceset përkatëse të politikëbërjes dhe zbatimit, aty ku është e përshtatshme. Rrit ruajtjen, përdorimin e qëndrueshëm dhe restaurimin e habitateve detare dhe bregdetare të cilat çënohen nga ndikimet e ndryshimeve klimatike apo të cilat kontribuojnë ndaj zbutjes së ndryshimeve klimatike.	IUCN 2016 Botimi për Zgjidhjet e Mbështetura tek Natyra – (CBD, 2010)	https://portals.iucn.org/library/sites/library/files/documents/2016-036.pdf
Angazhon	Tërheq apo përfshin interesin apo vëmendjen e dikujt. Angazhohet në/me: merr pjesë apo përfshihet.	Fjalori i IUCN-së i Ligjit për Mjedisin	https://www.iucn.org/theme/environmental-law/our-work/water/water-law-and-governance-support-platform/learning-resources/glossary#PStext
Mjedis	I referohet të gjithë komponentëve të gjallë dhe jo të gjallë dhe të gjithë faktorëve, si klima, të cilët rrethojnë një organizëm. Shpesh ai ngatërrohet me fjalën ekologji, e cila është shkencë e cila studion marrëdhëniet e qenieve të gjalla me njëra-tjetrën si dhe me të gjitha pjesët jo të gjalla të një mjedisi. Mjedis mund të konceptohet si rreshtimi i gurëve të dominos. Në këtë drejtim, ekologjia do të ishte studimi i ndikimit ndaj të gjithë gurëve të dominos mbi njëri-tjetrin ndërkohë që bien.	Fjalori i IUCN-së	https://www.iucn.org/sites/dev/files/iucn-glossary-of-definitions_en.pdf
Përfitime të barabarta	I referohet ndikimit përfundimtar të përpjekjeve për zhvillim nga të dyja gjinitë. Ai do të thotë se rezultatet duhet të përftoheshin në mënyrë të barabartë dhe të përdoren si nga meshkujt ashtu edhe nga femrat. Barazia e mundësive jo domosdoshmërisht nënkupton se të dyja gjinitë gëzojnë të njëjtat përfitime.	Fjalori i IUCN-së	https://www.iucn.org/sites/dev/files/iucn-glossary-of-definitions_en.pdf
Barazi	Kërkon të drejtën e njerëzve për mundësi të barabarta dhe ngritje të kapaciteteve bazë; kjo do të thotë se duhen eliminuar problemet të cilat pengojnë mundësitë ekonomike dhe politike, si dhe të drejtën për arsimim dhe shërbimet bazë, në mënyrë që njerëzit (femrat dhe meshkujt e të gjitha moshave, kushteve dhe pozicioneve) të jenë në gjendje të gëzojnë mundësi të tilla dhe të përfitojnë prej tyre. Barazia nënkupton drejtësi; që do të thotë, t'i jepet secilit çfarë i takon me ligj, duke njohur kushtet apo karakteristikat e caktuara të secilit individ apo grupi individësh (seksin, gjininë, klasën, fenë, moshën); ajo është njohja e diversitetit, pa shkaktuar diskriminim.	Fjalori i IUCN-së	https://www.iucn.org/sites/dev/files/iucn-glossary-of-definitions_en.pdf
Barazi	Cilësia e të qenurit i drejtë dhe i paanshëm. Parimi sipas të cilit të gjithë individët të cilët janë në të njëjtën situatë duhet t'i binden të njëjtave ligje, pa asnjë lloj dallimi apo diskriminimi.	Fjalori i IUCN-së i Ligjit për Mjedisin	https://www.iucn.org/theme/environmental-law/our-work/water/water-law-and-governance-support-platform/learning-resources/glossary#PStext

Termi	Përkufizimi	Burimi	Link-u
Proces i evolucionit	Numri i ngjarjeve të cilat sjellin ndryshime në frekuencat gjenetike brenda një popullate. Ndryshime të tilla mund të rezultojnë në shfaqjen e llojeve të reja (krijimi i llojeve të reja) apo të taksonomëve të rinj të caktuar.	Fjalori i terminologjisë së hartimit dhe vlerësimit të shërbimeve të ekosistemit	https://oneecosystem.pensoft.net/articles.php?id=27110
Qarkullim (shërbime të ekosistemit)	Sasia e një shërbimi të ekosistemit i cili faktikisht mobilizohet në një zonë dhe kohë të caktuar.	Fjalori i terminologjisë së hartimit dhe vlerësimit të shërbimeve të ekosistemit	https://oneecosystem.pensoft.net/articles.php?id=27110
Sigurim i ushqimit	Sigurimi i ushqimit: disponueshmëria e ushqimit e cila duhet të jetë e aksesueshme nga të gjithë, e sigurt dhe e përshtatshme në bazë të vendodhjes dhe e besueshme përgjatë periudhave kohore dhe territoreve, një nga çështjet kryesore me të cilat po përballen bota në ditët e sotme.	IUCN 2016 Botimi për Zgjidhjet e Mbështetura tek Natyra	https://portals.iucn.org/library/sites/library/files/documents/2016-036.pdf
Restaurim i Peizazhit Pyjor	Procesi i planifikuar për kthimin e integritetit ekologjik dhe rritjen e mirëqenies së njeriut në peizazhet e shpyllëzuara apo të degraduara. Restaurimi i peizazhit pyjor është procesi afatgjatë për kthimin e funksionit ekologjik dhe rritjen e mirëqenies së njeriut në peizazhet pyjore të shpyllëzuara apo të degraduara.	IUCN 2016 Botimi për Zgjidhjet e Mbështetura tek Natyra – (Mansourian et al., 2005) & (Maginnis et al., 2014)	https://portals.iucn.org/library/sites/library/files/documents/2016-036.pdf
Kornizë	Struktura e nivelit të lartë e cila përcakton objektivin dhe drejtimin e përbashkët për planet dhe programet.	Fjalori i IUCN-së	https://www.iucn.org/sites/dev/files/iucn-glossary-of-definitions_en.pdf
Gjini	Gjinitë janë grupe biologjike, shoqërore dhe kulturore, të ndërtuara historikisht përmes identifikimit të karakteristikave seksuale të cilat klasifikojnë qeniet njerëzore. Sapo klasifikohen, atyre u caktohet një grup i posaçëm funksionesh, veprimtarish, marrëdhëniesh shoqërore, formash dhe Standardesh të sjelljes. Ky është një grup i ndërlikuar për përcaktimet ekonomike, shoqërore, ligjore, politike dhe psikologjike, dhe karakteristikat, si ato kulturore, duke krijuar veçoritë të cilat në secilën periudhë të kohës, shoqërisë apo kulturës përcaktojnë të qenurit mashkull apo femër.	Fjalori i IUCN-së	https://www.iucn.org/sites/dev/files/iucn-glossary-of-definitions_en.pdf
Ngrohje globale	Rritja e përllogaritur e temperaturës mesatare globale të ajrit në sipërfaqe (GMST) e matur mesatarisht për një periudhë 30-vjeçare, apo periudhë 30-vjeçare të përqendruar në një vit apo dhjetëvjeçar të caktuar, e shprehur në lidhje me nivelet paraindustriale vetëm nëse nuk përcaktohet ndryshe. Për periudhat 30-vjeçare të cilat shtrihen në vitet e kaluara dhe të ardhshme, prirja aktuale prej shumë dhjetëvjeçarësh supozohet se do të vazhdojë.		https://www.ipcc.ch/site/assets/uploads/sites/2/2019/05/SR15_SPM_version_report_LR.pdf
Qeverisje	Veprimi apo mënyra e qeverisjes; sistemi i kontrollimit, drejtimit, apo rregullimit të ndikimit. Ajo përfshin katër aspekte: shoqërore, politike, ekonomike dhe ligjore. Më shumë sesa qeveria, qeverisja i referohet kompleksitetit të proceseve dhe institucioneve përmes të cilave shoqëria konteston, nxjerr dhe menaxhon vendimet.	Fjalori i IUCN-së i Ligjit për Mjedisin	https://www.iucn.org/theme/environmental-law/our-work/water/water-law-and-governance-support-platform/learning-resources/glossary#PStext
Organ qeverisës	Komiteti apo bordi përgjegjës për drejtimin strategjik të organizatës, monitorimi i efektshëm i menaxhimit, dhe llogaridhënia e menaxhimit ndaj të gjithë organizatës dhe aktorëve të saj.	Fjalori i Institutit Global të Raportimit	https://www.globalreporting.org/standards/media/1913/gri-standards-glossary.pdf

Termi	Përkufizimi	Burimi	Link-u
Infrastrukturë e gjelbër	IGJ-ja përmban të gjitha rrjetet natyrore, gjysmënatyrore dhe artificiale të sistemeve ekologjike shumëfunktionale brenda, përreth dhe ndërmjet zonave urbane, në të gjitha shkallët territoriale. Koncepti i infrastrukturës së gjelbër thekson cilësinë si dhe sasinë e hapësirave të gjelbra urbane dhe në periferi të tyre, rolin e tyre shumëfunktional, dhe rëndësinë e ndërlidhjeve ndërmjet habitateve. IGJ (Infrastruktura e Gjelbër) është rrjeti i planifikuar në mënyrë strategjike i zonave natyrore dhe gjysmë natyrore, me tipare të tjera mjedisore të hartuara dhe të menaxhuara për të kryer një gamë të gjerë të shërbimeve të ekosistemit. Ajo përfshin hapësirat e gjelbra (apo të kaltra nëse bëhet fjalë për ekosisteme ujore) dhe tipare të tjera fizike në zonat tokësore (duke përfshirë ato bregdetare) dhe detare. Në tokë, IGJ-ja është e pranishme në kontekstet rurale dhe urbane.	IUCN 2016 Botimi për Zgjidhjet e Mbështetura tek Natyra – (Tzoulas et al., 2007) & (Komisioni Europian, 2013)	https://portals.iucn.org/library/sites/library/files/documents/2016-036.pdf
Mekanizëm i ankimeve	Sistemi i mekanizmit të ankimeve përbëhet nga procedurat, rolet dhe rregullat për marrjen e ankesave dhe sigurimin e zgjidhjes. Shënim: Mekanizmat e efektshëm priten të jenë legjitimë, të aksesueshëm, të parashikueshëm, të barabartë, transparentë, në përputhje me të drejtat, dhe shërbejnë si burim i të nxëniet të vazhdueshëm. Në mënyrë që mekanizmat që funksionojnë me nivele të jenë të efektshëm, ata duhet të bazohen në angazhimin dhe dialogun. Për përshkrimin e secilit prej këtyre kritereve, shihni Parimin Udhëzues 31 të Kombeve të Bashkuara. (KB).	Fjalori i Institutit Global të Raportimit	https://www.globalreporting.org/standards/media/1913/gri-standards-glossary.pdf
Shëndeti i njeriut	Gjendja e mirëqenies së plotësuar fizike, mendore dhe shoqërore dhe jo thjesht mungesa e sëmundjes apo paafësia shëndetësore. Shëndeti i një komuniteti apo popullsie të tërë pasqyrohet në matjet e incidencës dhe prevalencës së sëmundjeve, numrit të vdekjeve të moshës së caktuar, dhe jetëgjatësisë. Përbërësit e mirëqenies: Aspektet e përvojës së mirëqenies, të tilla si shëndeti, lumturia, dhe liria për të jetuar dhe vepruar dhe në kontekstin më të gjerë, liritë themelore. Përcaktuesit e mirëqenies: Kontributet për krijimin e mirëqenies, të tilla si ushqimi, veshmbathja, uji i pijshëm, dhe mundësitë për marrjen e njohurive dhe informacionit.	Shërbimet Mijëvjeçare të Ekosistemit	https://www.millenniumassessment.org/documents/document.776.aspx.pdf
Mirëqenie e njeriut	“Mirëqenia e njeriut” supozohet të ketë përbërës të shumtë, duke përfshirë materialin bazë për një jetë të mirë, të tillë si jetesa e sigurt dhe e përshtatshme, ushqimi i mjaftueshëm gjatë gjithë kohës, strehimi, veshmbathja, dhe mundësitë për të pasur të mira materiale; shëndeti, duke përfshirë të ndjerin mirë dhe mundësinë për të pasur një mjedis të shëndetshëm fizik, të tillë si ajër të pastër dhe ujë të pastër; marrëdhënie të mira shoqërore, duke përfshirë lidhjet shoqërore, respektin e ndërsjelltë, dhe aftësinë për të ndihmuar të tjerët dhe për të siguruar fëmijët; siguri, duke përfshirë mundësinë për të pasur burime të sigurta natyrore dhe të tjera, sigurinë personale, dhe sigurimin nga fatkeqësitë natyrore apo të shkaktuara nga njeriu; dhe lirinë e zgjedhjes dhe veprimit, duke përfshirë mundësinë për të arritur atë çfarë vlerëson një individ duke vepruar dhe jetuar.”	Shërbimet Mijëvjeçare të Ekosistemit	https://www.millenniumassessment.org/documents/document.776.aspx.pdf
Ndikim	Ndikimi negativ apo pozitiv ndaj individëve, shoqërisë dhe burimeve mjedisore që vijnë si rezultat i ndryshimeve mjedisore.	Fjalori i terminologjisë së hartimit dhe vlerësimit të shërbimeve të ekosistemit	https://oneecosystem.pensoft.net/articles.php?id=27110

Termi	Përkufizimi	Burimi	Link-u
Ndikim (mjedisor)	Ndikimi i matshëm i veprimit të njeriut në ekosisteme të caktuara. Instrumenti matës është dokumenti ku tregohet ndikimi mjedisor, përmes të cilit zbulohet ndikimi i rëndësishëm dhe i mundshëm i krijuar nga një veprimtari apo punë, si dhe se si ai mund të shmangët apo zbutet në rastin e ndikimit negativ	Fjalori i IUCN-së	https://www.iucn.org/sites/dev/files/iucn-glossary-of-definitions_en.pdf
Zbatim	Zbatimi përshkruan veprimet e ndëmarra për të përmbushur angazhimet në bazë të një traktati dhe përfshin fazat ligjore dhe të efektshme. Zbatimi ligjor i referohet legjislacionit, rregulloreve, dekreteve gjyqësore, duke përfshirë veprime të tjera të tilla si përpjekjet për të administruar progresin, të cilat qeveritë i ndërmarrin për të përkthyer marrëveshjet ndërkombëtare në legjislacionin dhe politikën kombëtare. Zbatimi i efektshëm ka nevojë për politika dhe programe, të cilat sjellin ndryshime në sjelljen dhe vendimet e grupeve të synuara. Grupet e synuara më pas marrin masat e efektshme të zbutjes dhe përshtatjes. Shih gjithashtu Përputhjen.	IPCC	https://www.ipcc.ch/pdf/assessment-report/ar4/syr/assessment-report-ar4_syr_appendix.pdf
Tregues	Faktori apo ndryshorja sasiore apo cilësore e cila ofron një mjet të thjeshtë e të besueshëm për të matur realizimin e rezultateve, për të pasqyruar ndryshimet e lidhura me sistemin e Standardeve apo për të ndihmuar në vlerësimin e performancës së një organizate.	Fjalori i Termave ISEAL – i përshtatur nga Fjalori i OECD-së, 2002.	https://www.sustainabilityexchange.info/filesagri/ISEAL%20Glossary%20of%20Terms%20v1%20-%202016%20Jan%202015.pdf
Njohuri autoktone	Njohuritë të cilat janë unike për një kulturë apo shoqëri. Shih njohuritë tradicionale.	Shërbimet Mijëvjeçare të Ekosistemit	https://www.millenniumassessment.org/documents/document.776.aspx.pdf
Popuj autoktonë	Pasardhësit ekzistues të popujve të cilët banonin tërësisht apo pjesërisht në territorin aktual të një vendi në kohën kur erdhën njerëzit e një kulture apo origjine tjetër etnike nga pjesë të tjera të botës, të cilët i mposhtën ata përmes pushtimit, pozicionimit të tyre apo mënyrave të tjera duke i reduktuar në numër dhe duke i vendosur në një situatë jombizotëruese apo koloniale; ata sot jetojnë më shumë në përputhje me zakonet dhe traditat e tyre të veçanta shoqërore, ekonomike dhe kulturore sesa me institucionet e vendit ku tani ata formojnë vetëm një pjesë, në bazë të strukturës së Shtetit i cili përfshin kryesisht karakteristikat kombëtare, shoqërore dhe kulturore të segmenteve të tjera të popullsisë, të cilat janë mbizotëruese (përkufizimi funksional u miratua nga Grupi i Punës së Kombeve të Bashkuara për Popujt Autoktonë).	Fjalori i IUCN-së	https://www.iucn.org/sites/dev/files/iucn-glossary-of-definitions_en.pdf
Infrastrukturë	Pajisjet bazë, mjetet e nevojshme, ndërmarrjet prodhuese, instalimet dhe shërbimet kryesore për zhvillimin, vënien në funksion, dhe rritjen e një organizate, qyteti apo kombi.	IPCC	https://www.ipcc.ch/pdf/assessment-report/ar4/syr/assessment-report-ar4_syr_appendix.pdf
Institucione	Institucionet janë ligje, marrëveshje të parashikueshme, marrëdhënie të qëndrueshme, procese ose ofrues të shërbimeve, të cilat strukturojnë marrëdhëniet politike, shoqërore, kulturore ose ekonomike në një shoqëri. Ato mund të jenë joformale ose formale, dhe lejojnë përpjekjet e organizuara, kolektive për shqetësimet e përbashkëta. Pavarësisht se janë të qëndrueshme institucionet evoluojnë vazhdimisht.	Fjalori i IUCN-së i Ligjit për Mjedisin	https://www.iucn.org/theme/environmental-law/our-work/water/water-law-and-governance-support-platform/learning-resources/glossary#PStext

Termi	Përkufizimi	Burimi	Link-u
Vlerësim i integruar	Metoda e analizimit e cila kombinon rezultatet dhe modelet nga shkencat fizike, biologjike, ekonomike dhe shoqërore, dhe ndërveprimet ndërmjet këtyre komponentëve sipas një kornize të qëndrueshme për të vlerësuar statusin dhe pasojat e ndryshimeve mjedisore dhe reagimet e politikave ndaj tyre. Modelet e përdorura për të kryer analizime të tilla quhen Modelet e Vlerësimit të Integruar.	IPCC	https://www.ipcc.ch/pdf/assessment-report/ar4/syr/ar4_syr_appendix.pdf
Integrim	Niveli i integrimit brenda "Vlerësimeve ekzistuese të ekosistemit" është i ndryshëm; por zakonisht ndahet në i) kombinim ii) interpretim dhe iii) komunikim të njohurive nga disiplina të ndryshme.	Fjalori i terminologjisë së hartimit dhe vlerësimit të shërbimeve të ekosistemit	https://oneecosystem.pensoft.net/articles.php?id=27110
Lloje të prezantuara	Llojet e prezantuara janë ato që shfaqen jashtë rrezes së tyre natyrore (në të kaluarën dhe të tashmen) dhe aftësisë për t'u shpërndarë (d.m.th. jashtë rrezes në të cilën pushtojnë natyrshëm apo nuk do të pushtonin pa prezantimin (introduktimin) apo kujdesin e njerëzve).	Fjalori i Listës së Kuqe për Llojet e Kërcënuara	http://www.iucnredlist.org/initiatives/mammals/description/glossary
Lloje invazive	Një lloj i huaj është lloji i prezantuar nga njerëzit – me apo pa qëllim – jashtë shpërndarjes së tij të kaluar apo të tashme, megjithatë jo të gjitha llojet e huaja kanë ndikime negative dhe është përlogaritur se ndërmjet 5% dhe 20% e llojeve të huaja janë problematike. Ky lloj është ai i cili quhet me termin "lloj i huaj invaziv" (LLHI). "Lloj i huaj invaziv (LLHI) është lloji i cili është krijuar jashtë shpërndarjes së tij të kaluar apo aktuale natyrore, prezantimi (introduktimi) i të cilit dhe/ose shpërndarja kërcënojnë diversitetin biologjik" Konventa për Diversitetin Biologjik.	Fjalori i Listës së Kuqe për Llojet e Kërcënuara	http://www.iucnredlist.org/initiatives/mammals/description/glossary
Përdorim i tokës	Përdorimi i tokës lidhet me mënyrën se si ndahet një pjesë e caktuar e tokës: qëllimi i saj, nevoja apo përdorimi (p.sh. bujqësi, industri, banim apo natyrë).	Fjalori i Mjeteve për KDB	https://www.cbd.int/cepa/toolkit/2008/doc/CBD-Toolkit-Glossaries.pdf
Peizazh (kulturor)	Vetitë kulturore të cilat përfaqësojnë punët e kombinuara të natyrës dhe njerëzve.	Fjalori i terminologjisë së hartimit dhe vlerësimit të shërbimeve të ekosistemit	https://oneecosystem.pensoft.net/articles.php?id=27110
Peizazh (gjeografik)	Zona, siç perceptohet nga njerëzit, karakteri i të cilës është rezultati i veprimit dhe ndërveprimit të faktorëve natyrorë dhe njerëzorë. Termi "peizazh", për rrjedhojë, përkufizohet si zonë apo sipërfaqe, siç perceptohet nga banorët lokalë apo vizitorët, tiparet vizuale të të cilëve dhe karakteri janë rezultat i veprimit dhe/apo faktorëve kulturorë. Njohja lidhet me faktin se peizazhet zhvillohen përgjatë periudhave kohore dhe janë rezultat i veprimtarive natyrore dhe njerëzore. Peizazhi duhet të trajtohet si një i tërë – komponentët natyrorë dhe kulturorë merren së bashku, jo të ndarë.	Fjalori i terminologjisë së hartimit dhe vlerësimit të shërbimeve të ekosistemit	https://oneecosystem.pensoft.net/articles.php?id=27110
Qasje e peizazhit	Qasja e peizazhit bazohet në shfaqjen e një grupi parimesh të cilat theksojnë menaxhimin e përshtatur, përfshirjen e aktorëve dhe objektivat e shumta për të adresuar shqetësimet shoqërore për mjedisin dhe marrëveshjet për zhvillimin.	Sayer et al., 2013.	https://www.pnas.org/content/110/21/8349

Termi	Përkufizimi	Burimi	Link-u
Lidhshmëri e peizazhit	Shtrirja, në të cilën një peizazh lehtëson lëvizjen e organizmave dhe llojeve të tyre, përballet me kërcënime kritike si fragmentimi është edhe humbja e habitatit.	Rudnick et al., 2012	https://www.fs.fed.us/rm/pubs_other/rmrs_2012_rudnick_d001.pdf
Qarkullime të peizazhit	Qarkullimet e peizazhit - shkëmbimet të cilat shfaqen në një nivel më të madh sesa zona (duke përfshirë mjediset ujore) duke përfshirë qarkullimin e energjisë, ujit, zjarrit dhe materialit gjenetik. Shkëmbimet ndërmjetësohen nga lidhshmëria me habitatin (Wiens 1992).	Standardet ndërkombëtare për praktikën e restaurimit ekologjik – duke përfshirë parimet dhe konceptet kyçe	http://seraustoralasia.com/wheel/image/SER_International_Standards.pdf
Shkallë e peizazhit	Nuk ka një përkufizim të vetëm të pranuar për termin “shkalla e peizazhit”; ai, më tepër, është një term i përdorur rëndom për t’iu referuar veprimi i cili mbulon një shkallë të madhe territoriale, zakonisht duke adresuar një sërë procesesh të ekosistemit, objektivat e ruajtjes dhe përdorimet e tokës. “Shkalla e duhur” mund të marrë parasysh interesin e caktuar të individëve të përfshirë në nivelin vendor, karakteristikat estetike apo kulturore, tiparet natyrore të tilla si zonat e pellgut ujëmbledhës të lumit apo habitatet e veçanta, apo zonat e njohura si 159 Zonat e Karakterit Kombëtar. Ruajtja e shkallës së peizazhit karakterizohet nga ndjekja e përfitimeve të shumta përgjatë një zone të caktuar (p.sh. cilësia e ujit, biodiversiteti dhe aksesimi). Shembujt më të mirë lidhen gjithashtu me prioritetet ekonomike dhe shoqërore më të gjera, ku përmirësimi i natyrës mund të sigurojë përfitime ndaj ekonomisë vendore dhe cilësisë së jetës. Ka lidhje të forta ndërmjet qasjes së shkallës së peizazhit dhe “qasjes së ekosistemit”, e cila nxit qasjen e menaxhimit të integruar të tokës, duke marrë parasysh kostot dhe përfitimet e vendimeve të përdorimit të tokës, dhe duke ndjekur ato të cilat minimizojnë rreziqet dhe maksimizojnë mundësitë për njerëzit, për natyrën dhe për ekonominë.	Shkalla e peizazhit – drejt qasjes së integruar: Zgjedhja Natyrore, Raporti për Mjedisin Natyror, 2011	https://www.banc.org.uk/wp-content/uploads/2015/05/ECOS-33-3-4-6-Landscape-scale-integrated-approach.pdf
Kohëzgjatje	Fazat vijuese dhe të ndërlidhura të një produkti (mallra dhe shërbime), nga nxjerrja e burimeve natyrore deri tek asgjësimi përfundimtar.	Fjalori i UNDP – i përshtatur nga ISO 14040: 2006	https://www.unenvironment.org/explore-topics/resource-efficiency/why-does-resource-efficiency-matter/glossary
Lobim	Lobimi apo punët publike janë forma e specializuar e marrëdhënieve me publikun. Ai i referohet atyre veprimtarive që kanë për qëllim ndërtimin dhe mirëmbajtjen e marrëdhënieve joformale me vendimmarrësit formalë. Marrëdhëniet joformale përdoren për të ndikuar proceset e vendimmarrjes në interesin e organizatës, programit dhe/ose objektivave të saj.	Fjalor i Mjeteve për KDB	https://www.cbd.int/cepa/toolkit/2008/doc/CBD-Toolkit-Glossaries.pdf
Njohuri lokale	Shih njohuritë autoktone apo tradicionale.	-	-
Integrim	Përfshirja e një shqetësimi të caktuar, p.sh. përdorimi i qëndrueshëm i ekosistemeve, në politika dhe veprime.	Shërbimet Mijëvjeçare të Ekosistemit	https://www.millenniumassessment.org/documents/document.776.aspx.pdf
Mirëmbajtje	Mirëmbajtja e ekosistemit – veprimtaritë e vazhdueshme - të zbatuara pas rikuperimit të plotë – të synuara për të kundërvepruar ndaj proceseve të degradimit ekologjik për të ruajtur veçoritë e një ekosistemi. Mirëmbajtje e madhe dhe e vazhdueshme mund të kërkohe në zonat e restauruara ku vazhdojnë të jenë të pranishme nivelet më të larta të kërcënimeve, në krahasim me zonat ku kërcënimet janë vënë nën kontroll (McDonald et. al., 2016).	Standardet ndërkombëtare për praktikën e restaurimit ekologjik – duke përfshirë parimet dhe konceptet kyçe	http://seraustoralasia.com/wheel/image/SER_International_Standards.pdf

Termi	Përkufizimi	Burimi	Link-u
Zbutje	Masat të cilat lejojnë një veprimtari me ndikim negativ ndaj biodiversitetit, por zvogëlojnë ndikimin në zonë duke marrë parasysh ndryshimet e shkallës, hartimit, vendodhjes, procesit, vijueshmërisë, menaxhimit dhe/ose monitorimit të veprimtarisë së propozuar. Përpjekje të përbashkëta të planifikuesve, inxhinierëve, ekologjistëve, ekspertëve të tjerë dhe shpesh aktorëve lokalë, kërkohen për të arritur të mundësia më e mirë e praktikës mjedisore. Si shembull është ndikimi i papranueshëm ndaj biodiversitetit kur ndërtohet një rrugë e caktuar, e cila zbutet nga ndërtimi i një ure me harqe për kalimin e botës së egër.	Fjalor i Mjeteve për KDB	https://www.cbd.int/cepa/toolkit/2008/doc/CBD-Toolkit-Glossaries.pdf
Monitorim	Numërimet e vazhdueshme dhe të hartuara në mënyrë statistikore të një popullsie në mënyrë që të shihen numrat e saj, përbërja dhe shpërndarja.	Fjalori i IUCN-së	https://www.iucn.org/sites/dev/files/iucn-glossary-of-definitions_en.pdf
Monitorim & Vlerësim	Procesi i vazhdueshëm përmes të cilit një organizatë nxjerr përfundime për kontributin e saj ndaj rezultateve dhe ndikimeve të synuara. Sistemi i monitorimit dhe vlerësimit përbëhet nga një sërë funksionesh, procesesh dhe veprimtarish të ndërlidhura, duke përfshirë mbledhjen sistematike të të dhënave të monitorimit për treguesit e caktuar dhe zbatimin e rezultatit dhe vlerësimeve përfundimtare të ndikimit.	Fjalori i Termave ISEAL – i përshtatur nga Fjalori i OECD	https://www.sustainabilityxchange.info/filesagri/ISEAL%20Glossary%20of%20Terms%20v1%20-%2016%20Jan%202015.pdf
Angazhime kombëtare	Strategjia Kombëtare për Biodiversitetin dhe Plani i Veprimit. Konventa për Diversitetin Biologjik bën thirrje për secilën nga Palët e saj të përgatitë një Strategji Kombëtare për Biodiversitetin dhe Planin e Veprimit (Neni 6a) e cila krijon veprimtaritë dhe synimet e caktuara për përmbytjen e objektivave të Konventës. Këto plane zbatohen në partneritet me organizatat e ruajtjes. Llojet apo habitatet të cilat i nënshtrohen SKBPV-së janë prioritetet e veprimit të shprehura nga qeveritë dhe për rrjedhojë, nëse ato kërcënohen përbëjnë arsye për shqetësim. SKBPV-të nuk kanë status ligjor dhe llojet e listuara dhe llojet e habitateve nuk janë domosdoshmërisht të mbrojtura (pavarësisht se disa trajtohen nga legjislacione të tjera).	Fjalor i Mjeteve për KDB	https://www.cbd.int/cepa/toolkit/2008/doc/CBD-Toolkit-Glossaries.pdf
Vendas	Ekosistemi vendas – ekosistemi i cili përmban llojet dhe nënllojet (duke përfshirë llojet invazive jovendase) të cilat njihen se kanë evoluar në vendodhjen e caktuar ose kanë migruar kohët e fundit nga vendodhjet fqinje për shkak të klimave të ndryshueshme. Aty ku mungojnë të dhënat vendore, informacioni rajonal dhe historik mund të ndihmojë për të siguruar informacion për ekosistemet e mundshme vendase. Këto dallohen nga “ekosistemet kulturore” (p.sh., agro-ekosistemet) nëse sistemet janë modifikuar në mënyrë thelbësore në shtrirje dhe konfigurim përtej analogëve natyrorë apo qëndrojnë jashtë rrezes së variacionit natyror për atë ekosistem.	Standardet ndërkombëtare për praktikën e restaurimit ekologjik – duke përfshirë parimet dhe konceptet kyçe	http://seraustoralasia.com/wheel/image/SER_International_Standards.pdf
Natyror	Mjedisi natyror përmban të gjitha qeniet e gjalla dhe jo të gjalla që shfaqen natyrshëm në Tokë. Në kuptimin më të plotë, përkufizimi i referohet një mjedisi i cili nuk është rezultat i veprimtarisë apo ndërhyrjes njerëzore. Mjedisi natyror është në kontrast me “mjedisin e ndërtuar” dhe është gjithashtu në kontrast me konceptin e peizazhit kulturor.	Fjalor i Mjeteve për KDB	https://www.cbd.int/cepa/toolkit/2008/doc/CBD-Toolkit-Glossaries.pdf

Termi	Përkufizimi	Burimi	Link-u
Infrastrukturë Natyrore	Infrastruktura Natyrore (IN) përkufizohet si "rrjeti i planifikuar dhe i menaxhuar në mënyrë strategjike i tokave natyrore, të tilla si pyjet dhe ligatinat, peizazhet e punës dhe hapësira të tjera të hapura të cilat ruajnë apo rritin vlerat dhe funksionet e ekosistemit dhe ofrojnë përfitimet e shoqëruara ndaj popullatave njerëzore".	IUCN 2016 Botimi për Zgjidhjet e Mbështetura tek Natyra – Benedict & McMahon, 2006	https://portals.iucn.org/library/sites/library/files/documents/2016-036.pdf
Kohëzgjatje e ZMN-ve	Konceptim Zhvillim Zbatim & Monitorim Vlerësim Mbyllje	IUCN PAAS	https://www.iucn.org/resources/project-management-tools/project-guidelines
Mundësi	Janë hapësirat për të zhvilluar aftësitë intelektuale, fizike dhe emocionale, për të ndjekur dhe arritur qëllimet e vendosura në jetë.	Fjalori i IUCN-së	https://www.iucn.org/sites/dev/files/iucn-glossary-of-definitions_en.pdf
Rezultate	Kushtet ekologjike apo shoqërore në terren të cilat janë pasojat e drejtpërdrejta të produkteve dhe kontribuojnë ndaj ndikimit të propozuar. Për shembull, trupi ujqor i mbrojtur nga bagëtitë, ndryshimi i sipërfaqes pyjore të menaxhuar në mënyrë të qëndrueshme (si rezultat i njohurive të përmirësuar përmes trajnimit), erozioni dhe zvogëlimi i sedimenteve (që shkaktohen nga rimbjellja në shpate).	Procedura e Shërbimeve të Ekosistemit: Demonstrimi i Ndikimit dhe Mjetet e Tregut	https://ic.fsc.org/file-download/ecosystem-services-procedure.a-7433.pdf
Produkte	Pasojat e menjëhershme dhe direkte të veprimtarive të menaxhimit të zbatuara në njësinë e menaxhimit. Për shembull, metrat e gardhit të ndërtuar, numri i njerëzve të trajnuar dhe numri i hektarëve të shpateve të rimbjella, proporcioni i njësisë së menaxhimit ku janë hequr llojet ekzotike.	Procedura e Shërbimeve të Ekosistemit: Demonstrimi i Ndikimit dhe Mjetet e Tregut	https://ic.fsc.org/file-download/ecosystem-services-procedure.a-7433.pdf
Kërkime për Veprimin Gjithëpërfshirës	Kërkimet për Veprimin Gjithëpërfshirës (KVGJ) është qasja për kërkimin e informacionit, e cila është përdorur që në vitin 1940. Ajo përfshin kërkuesit dhe pjesëmarrësit që punojnë së bashku për të kuptuar një situatë problematike dhe për ta ndryshuar atë për mirë. Ka shumë përkufizime të qasjes, të cilat ndajnë disa elementë të përbashkët. KVGJ-ja përqendrohet në ndryshimin shoqëror, i cili promovon demokracinë dhe sfidon pabarazitë; është specifik për nga konteksti, shpesh synon nevojat e grupit të caktuar; është një cikël ripërsëritës i kërkimit, veprimit dhe reflektimit; dhe shpesh kërkon t'i "nxitë" pjesëmarrësit për të pasur një ndërgjegjësim më të madh për situatën e tyre në mënyrë që të ndërmerret veprim. KVGJ-ja përdor një sërë metodash, si cilësore ashtu edhe sasiore.	Instituti i Studimeve për Zhvillim	https://www.participatorymethods.org/glossary-terms
Të Nxënë dhe Veprimi Gjithëpërfshirës	Të Nxënë dhe Veprimi Gjithëpërfshirës është një grup qasjesh, metodash, qëndrimesh, sjelljesh dhe marrëdhënish, të cilat mundësojnë dhe fuqizojnë njohuritë për jetën dhe kushtet e tyre, dhe përdoren për të planifikuar, vepruar, monitoruar, vlerësuar dhe reflektuar.	Instituti i Studimeve për Zhvillim	https://www.participatorymethods.org/glossary-terms
Politikë	Parimet e përgjithshme të cilat drejtojnë qeverinë për menaxhimin e marrëdhënieve të saj me publikun. Kursi apo parimi i veprimit i miratuar apo i propozuar nga një organizatë apo individ.	Fjalori i IUCN-së i Ligjit për Mjedisin	https://www.iucn.org/theme/environmental-law/our-work/water/water-law-and-governance-support-platform/learning-resources/glossary#PStext

Termi	Përkufizimi	Burimi	Link-u
Para-industrial	Periudha shumëshekullore përpara fillimit të veprimtarisë industriale në shkallë të gjerë rreth vitit 1750. Periudha e referimit 1850-1900 përdoret për të përafshuar GMST (Global Medium Surface Temperature - temperatura mesatare globale e sipërfaqes së ajrit) para industriale.	Raporti i IPCC	https://www.ipcc.ch/site/assets/uploads/sites/2/2019/05/SR15_SPM_version_report_LR.pdf
Projekt	Projekti është një grup i kufizuar në kohë i veprimtarive të hartuara për të arritur rezultate dhe për të sjellë ndikime.	IUCN PAAS	https://www.iucn.org/resources/project-management-tools/project-guidelines
Hartim i projektit	Përpilimi i duhur organizativ për të zhvilluar një projekt të veçantë mund të konsiderohet një faktor kryesor për suksesin e projektit. Projektet kërkojnë përpilimet e duhura organizative duke përfshirë role të tilla si përfituesi i projektit, menaxheri i projektit, anëtarët e ekipit të projektit, ekipet e projektit dhe nën ekipet. Më tej, organizimi i projektit duhet të lidhet me kompaninë apo kompanitë e ekzekutimit të projektit. Metodat e menaxhimit qendror të projektit janë grafiku i organizimit të projektit dhe përshkrimet e rolit të projektit.	Lidhja mes zhvillimit të qëndrueshëm dhe menaxhimit të projektit: një model konceptual - (Gareis, 2005)	https://www.pmi.org/learning/library/relating-sustainable-development-project-management-6497
Projektim	Zhvillimi i mundshëm në të ardhmen i një sasive apo grupi sasior, shpesh i përllogaritur automatikisht me anë të një modeli. Projektimet dallohen nga parashikimet në mënyrë që të theksohet se projektimet përfshijnë supozime, për shembull, në lidhje me zhvillimet e ardhshme shoqërore, ekonomike dhe teknologjike të cilat mund të realizohen ose jo, dhe për rrjedhojë i nënshtohen pasigurisë së theksuar.	IPCC	https://www.ipcc.ch/pdf/assessment-report/ar4/syr/ar4_syr_appendix.pdf
Zonë e mbrojtur	IUCN-ja e përkufizon zonën e mbrojtur si: "Hapësira gjeografike e përcaktuar qartë, e njohur, e dedikuar dhe e menaxhuar, përmes mjeteve ligjore apo mjeteve të tjera efikase, për të arritur ruajtjen afatgjatë të natyrës me shërbimet e shoqëruara të ekosistemit dhe vlerat kulturore" (Dudley, 2008). Mbrojtja e efektshme mund të ndodhë gjithashtu diku tjetër dhe IUCN-ja drejton një proces për të përcaktuar për njohjen e saj sic mund të jenë "mekanizma të tjera të efektshme të ruajtjes së bazuar te zona" (Jonas et al., 2014).	Zonat e Mbrojtura të IUCN-së	https://www.iucn.org/theme/protected-areas/about
Shërbime të ofruara nga natyra	Produktet e përftuara nga ekosistemet, për shembull, burimet gjenetike, ushqimi, lënda drusore dhe uji i pijshëm.	Shërbimet Mijëvjeçare të Ekosistemit	https://www.millenniumassessment.org/documents/document.776.aspx.pdf
Shërbime rregullatore	Përfitimet e përftuara nga rregullimi i proceseve të ekosistemit, duke përfshirë, për shembull, rregullimin e klimës, ujit dhe disa sëmundjeve të njeriut.	Shërbimet Mijëvjeçare të Ekosistemit	https://www.millenniumassessment.org/documents/document.776.aspx.pdf
Aftësi ripërtëritëse (ekosistemi)	Aftësia ripërtëritëse e ekosistemit – aftësia e një sistemi për të asimiluar çrregullimet dhe për t'u riorganizuar ndërsa ende ruan funksionin e ngjashëm të ruajtjes, strukturën dhe reagimet. Në komunitetet e bimëve dhe të kafshëve, kjo veti varet shumë nga përshtatjet e llojeve individuale ndaj çrregullimeve apo trysnive të përjetuara gjatë evolucionit të llojeve.	Standardet ndërkombëtare për praktikën e restaurimit ekologjik – duke përfshirë parimet dhe konceptet kyçe	http://seraustoralasia.com/wheel/image/SER_International_Standards.pdf
Aftësi ripërtëritëse (e përgjithshme)	Aftësia e një sistemi shoqëror apo ekologjik për të asimiluar çrregullimet ndërsa ruan të njëjtën strukturë bazë dhe mënyrat e funksionimit, aftësinë për t'u vetëorganizuar dhe aftësinë për t'u përshtatur ndaj trysnive dhe ndryshimit.	IPCC	https://www.ipcc.ch/pdf/assessment-report/ar4/syr/ar4_syr_appendix.pdf

Termi	Përkufizimi	Burimi	Link-u
Burime (biologjike)	Burimet biologjike. Burimet gjenetike, organizmat ose pjesët e tyre, popullatat, apo çdo komponent tjetër biotik i ekosistemeve me vlerë reale apo të mundshme, apo dobia ndaj qenieve njerëzore. Aksesit: përkufizohet si mundësia për pjesëmarrje, përdorim dhe përfitim.	Fjalori i IUCN-së	https://www.iucn.org/sites/dev/files/iucn-glossary-of-definitions_en.pdf
Burime (natyrore)	Burimet natyrore shpesh klasifikohen si burime të rinovueshme dhe të parinovueshme. Burimet e rinovueshme janë në përgjithësi burime të gjalla (p.sh. peshku, kafeja, dhe pyjet), të cilat mund të shumohen sërish (rinovohen) nëse nuk shfrytëzohen së tepërmi. Burimet e rinovueshme mund të shumohen sërish dhe të përdoren pafundësisht nëse ato përdoren në mënyrë të qëndrueshme. Burime të tjera të rinovueshme konsumohen me një ritëm i cili tejkalon ritmin e tyre natyror të zëvendësimit, stogu që mbetet për rrjedhojë do të ulet dhe do të shterojë. Ritmi i përdorimit të qëndrueshëm të një burimi të rinovueshëm përcaktohet nga shkalla e zëvendësimit dhe sasia e stogut të mbetur. Burimet natyrore jo të gjalla të parinovueshme përfshijnë tokën, ujin, baticat dhe rrezatimin diellor, në krahasim me energjinë e rinovueshme. Burimet gjithashtu mund të klasifikohen në bazë të origjinës së tyre biotike dhe abiotike. Burimet biotike vijnë nga kafshët dhe bimët (d.m.th. bota e gjallë). Burimet abiotike (d.m.th. nga bota jo e gjallë p.sh. toka, uji dhe ajri). Burimet minerale dhe energjetike janë gjithashtu burime abiotike dhe disa vijnë nga natyra. Si nxjerrja e burimit bazë ashtu edhe rafinimi i tij në një formë më të pastër, të përdorshme direkt (p.sh., metalet, vajrat e rafinuara) përgjithësisht konsiderohen veprimtari të natyrës dhe burimeve, pavarësisht se këto të fundit jo domosdoshmërisht mund të shfaqen pranë të parës. Burimet natyrore janë kapitali natyror i konvertuar në kontributet e mallrave ndaj proceseve të kapitalit infrastrukturor.	Fjalor i Mjeteve për KDB	https://www.cbd.int/cepa/toolkit/2008/doc/CBD-Toolkit-Glossaries.pdf
Restaurim	Rikuperimi i strukturës, funksionit dhe proceseve të ekosistemit origjinal.	Fjalori i IUCN-së	https://www.iucn.org/sites/dev/files/iucn-glossary-of-definitions_en.pdf
Rezultate	Produktet, rezultatet dhe ndikimet që vijnë nga zbatimi i sistemit të Standardeve (përshtatur nga Fjalori i OECD, 2002).	Fjalori i Termave ISEAL – i përshtatur nga Fjalori i OECD-së, 2002.	https://www.sustainabilityxchange.info/filesagri/ISEAL%20Glossary%20of%20Terms%20v1%20-%202016%20Jan%202015.pdf
Rrezik	Rreziku i një projekti mund të përshkruhet si “mundësia për të devijuar në mënyrë pozitive apo negative nga një objektivi i caktuar i tij”. Për rrjedhojë, rreziqet mund të kenë ndikim ndaj realizimit me sukses të një projekti ndaj duhet të menaxhohen me kujdes.	Lidhja mes zhvillimit të qëndrueshëm dhe menaxhimit të projektit: një model konceptual - (Gareis, 2005).	https://www.pmi.org/learning/library/relating-sustainable-development-project-management-6497
Aftësi shkallëzuese	Përmes këtij procesi “aftësia shkallëzuese” u përkufizua si aftësia e një ndërhyrjeje për t’u zgjeruar në bazë të kushteve reale për përfshirjen e një numri më të madh të popullsisë së synuar duke ruajtur efektshmërinë, pavarësisht se në shkallë të vogël dhe/apo në kushte të kontrolluara ka rezultuar efikase.	Koncepti i aftësisë shkallëzuese: rritja e shkallës dhe miratimi i mundshëm i ndërhyrjeve për promovimin e shëndetit në politikë dhe praktikë.	https://www.ncbi.nlm.nih.gov/pubmed/22241853

Termi	Përkufizimi	Burimi	Link-u
Shkallë	Përmasat e matshme të dukurive apo vëzhgimeve. E shprehur në njësi fizike, të tilla si metrat, vitet, numri i popullsisë apo sasitë e lëvizura apo të shkëmbyera. Në vëzhgim, shkalla përcakton finesën relative apo ashpërsinë e detajeve të ndryshme dhe përzgjedhjen ndërmjet modeleve që mund të formojnë këto të dhëna.	Shërbimet Mijëvjeçare të Ekosistemit	https://www.millenniumassessment.org/documents/document.776.aspx.pdf
Shkallëzim	Shkallëzimi përkufizohet si “zgjerimi, përsëritja, përshtatja dhe ruajtja e politikave, programeve apo projekteve të suksesshme në hapësirën gjeografike dhe në periudhat kohore, për të arritur tek një numër më i madh njerëzish. “Ai është i rëndësishëm për të përkufizuar paraparakisht shkallën përfundimtare në të cilën duhet apo mund të ndërmerret një ndërhyrje, duke pasur parasysh nevojat e popullsisë së synuar dhe të natyrës së ndërhyrjes. Është gjithashtu e rëndësishme të konsiderohet në mënyrë realiste diapazoni kohor në të cilin duhet të shtrihet procesi i shkallëzimit në mënyrë që të arrihet shkalla përfundimtare e dëshiruar. Hartmann dhe Linn zbuluan se shkallëzimi i suksesshëm i programeve në bazë të shkallës kombëtare mund të kërkojë dhjetë deri në pesëmbëshjetë vjet, ose më tepër.	Vendosja e Novacioneve në Shkallë: Metodën, Zbatimet dhe Mësimet	https://www.usaid.gov/sites/default/files/documents/1865/v5web_R4D_MSI-BrookingsSynthPaper0914-3.pdf
Shkallëzim	Shkallëzimi arrihet përmes: pjesëmarrjes në proceset dhe veprimet e vendimmarrjes; të nxënë të lidhjeve me ndryshimin e nevojshëm; marrëdhëniet dhe rrjetet e cilat përhapin idetë dhe frymëzojnë veprimin. Pjesëmarrja, të nxënë dhe marrëdhëniet, kërkojnë ndërhyrje funksionale të cilat përmbushin nevojat lokale dhe zotërohen nga aktorët. Kjo çon në qëndrueshmërinë dhe shkallëzimin e rezultateve.	Burns, D., and Worsley, S., 2015. Lundrimi përmes Kompleksitetit në Zhvillimin Ndërkombëtar	http:// dx.doi.org/ 10.3362/ 9781780448510
Njohuri shkencore	Programi për Vlerësimin e Studentit Ndërkombëtar (PISA) përkufizon dijen shkencore si kapaciteti për të përdorur njohuritë shkencore, për të identifikuar pyetjet dhe për të nxjerrë përfundime të bazuara në fakte në mënyrë që të kuptohen dhe të ndihmohen vendimet për botën natyrore dhe ndryshimet e kryera ndaj saj përmes veprimtarisë së njeriut.	OECD	https://stats.oecd.org/glossary/search.asp
Sektorë	Nëndarjet e një ekonomie, shoqërie apo sfere të veprimtarisë, të përkufizuara në bazë të disa karakteristikave të përbashkëta.	Fjalori i Institutit Global të Raportimit	https://www.globalreporting.org/standards/media/1913/gri-standards-glossary.pdf
Zonë	Zona apo vendodhja e veçuar. Mund të shfaqet në shkallë të ndryshme por në përgjithësi është në shkallën e gastrës apo pronës (d.m.th., më e vogël se një peizazh).	Standardet ndërkombëtare për praktikën e restaurimit ekologjik – duke përfshirë parimet dhe konceptet kyçe	http://seraustoralasia.com/wheel/image/SER_International_Standards.pdf
Kushte shoqërore	Kapitali shoqëror. Përbëhet, në një kuptim më të ngushtë, nga rrjetet shoqërore dhe normat përkatëse të cilat kanë ndikim në prodhimtarinë e shoqërisë. Ai bazohet në besim, dhe lehtëson bashkëpunimin dhe bashkërendimin për përfitimin e ndërsjelltë të anëtarëve të grupit. Në një kuptim më të gjerë termi përmbledh si shoqërimet vertikale ashtu edhe horizontale, ndërmjet komuniteteve dhe grupeve të tjera të tilla si agjencitë, grupet e certifikimit të pyjeve, këshillat bashkiakë dhe kështu me radhë.	Fjalori i IUCN-së	https://www.iucn.org/sites/dev/files/iucn-glossary-of-definitions_en.pdf

Termi	Përkufizimi	Burimi	Link-u
Lloje	Një grup individësh të cilët shumohen në bazë të karakteristikave të përbashkëta për të prodhuar (të aftë për të prodhuar) të vegjël dhe të cilët nuk arrijnë të shumohen brenda grupeve të tjera të tilla, d.m.th., një popullatë e cila nga ana e riprodhimit është e izoluar nga të tjerat; llojet përkatëse grupohen sipas llojeve, një gjermë apo numër i vendosur pas emrit të përgjithshëm, p.sh., <i>Squatina</i> sp. (Skadhina e butë sp.).	Fjalori i IUCN-së	https://www.iucn.org/sites/dev/files/iucn-glossary-of-definitions_en.pdf
Aktor	Aktorët janë individët apo grupet të cilët ndikohen direkt apo indirekt nga projekti, si dhe ata të cilët mund të kenë interes për një projekt dhe/ose aftësinë për të ndikuar në rezultatet e tij, pozitivisht apo negativisht. Aktorët mund të përfshijnë komunitetet apo individët e ndikuar në nivelin vendor dhe përfaqësuesit e tyre formalë dhe joformalë, autoritetet e pushtetit qendror dhe vendor, politikanët, drejtuesit e fesë, organizatat e shoqërisë civile dhe grupet me interesa të veçanta, komunitetin akademik, apo biznese të tjera. "Roli" që secili nga këta individë apo grupe të ndryshme ka në projekt apo investim është i ndryshëm.	IFC	https://www.ifc.org/wps/wcm/connect/938f1a0048855805beacfe6a6515bb18/IFC_StakeholderEngagement.pdf?MOD=AJPERES
Angazhim i aktorëve	Angazhimi i aktorëve është një term kryesor që përfshin një sërë veprimtarish dhe ndërveprimesh gjatë kohëzgjatjes së një projekti.	IFC	https://www.ifc.org/wps/wcm/connect/938f1a0048855805beacfe6a6515bb18/IFC_StakeholderEngagement.pdf?MOD=AJPERES
Strategji	Strategjia është plani afatgjatë me fushë zbatimi të përcaktuar, e cila identifikon objektivat e matshme; aktorët kryesorë dhe grupet e synuara për arritjen e rezultateve të harmonizuara me një vizion të përcaktuar.	Fjalor i Mjeteve për KDB	https://www.cbd.int/cepa/toolkit/2008/doc/CBD-Toolkit-Glossaries.pdf
Shërbime mbështetëse	Shërbimet e ekosistemit të cilat janë të nevojshme për prodhimin e të gjithë shërbimeve të ekosistemit. Disa shembuj përfshijnë prodhimin e biomasës, prodhimin e oksigjenit atmosferik, formimin dhe ruajtjen e tokës, ciklin e ushqyesve, qarkullimin e ujit dhe sigurimin e habitatit.	Shërbimet Mijëvjeçare të Ekosistemit	https://www.millenniumassessment.org/documents/document.776.aspx.pdf
Qëndrueshmëri	I referohet aksesit, përdorimit dhe menaxhimit të duhur të burimeve natyrore, për të siguruar se meshkujt dhe femrat e brezave aktualë dhe të ardhshëm janë në gjendje të përmbushin nevojat e tyre themelore në mënyrë të pandërprerë. Modeli i sjelljes, i cili garanton për secilin nga brezat e ardhshëm mundësinë për të gëzuar të paktën të njëjtin nivel të mirëqenies së gëzuar nga brezi paraardhës. Theksi vendoset në barazinë ndërmjet brezave të zhvillimit.	Fjalori i IUCN-së	https://www.iucn.org/sites/dev/files/iucn-glossary-of-definitions_en.pdf
I qëndrueshëm	I lidhur me, ose duke përcaktuar format e veprimtarisë ekonomike të njeriut dhe kulturës, në mënyrë të tillë që nuk çojnë në degradimin mjedisor, veçanërisht duke shmangur zvogëlimin afatgjatë të burimeve natyrore.	Fjalori i IUCN-së i Ligjit për Mjedisin	https://www.iucn.org/theme/environmental-law/our-work/water/water-law-and-governance-support-platform/learning-resources/glossary#PStext
Menaxhim i qëndrueshëm	Menaxhimi përmes potencialit aktual të burimeve përdoret në mënyrë më të mirë të mundshme dhe nuk redukton disponueshmërinë e burimeve.	Fjalori i IUCN-së	https://www.iucn.org/sites/dev/files/iucn-glossary-of-definitions_en.pdf
Përdorim i qëndrueshëm	Përdorimi i komponentëve të biodiversitetit biologjik në një mënyrë dhe në një shkallë të tillë e cila nuk çon në reduktim afatgjatë të diversitetit biologjik, duke ruajtur për rrjedhojë potencialin e saj për të përmbushur nevojat dhe aspiratat e brezave aktualë dhe të ardhshëm.	Fjalori i IUCN-së	https://www.iucn.org/sites/dev/files/iucn-glossary-of-definitions_en.pdf

Termi	Përkufizimi	Burimi	Link-u
Sinergji	Rezultati i veprimtarive të përbashkëta i cili shkon përtej numrit të veprimtarive individuale, duke i bërë përpjekjet më të efektshme dhe më efikase.	Fjalori i Termave të UNEP-së për Negociatorët e Marrëveshjeve Mjedisore Shumëpalëshe (2007)	http://wedocs.unep.org/handle/20.500.11822/7569
Teori e ndryshimit	Përshkrimi dhe ilustrimi i plotë i mënyrës se si dhe pse pritët të ndodhë ndryshimi i dëshiruar në një kontekst të caktuar.	Shërbimi i Ekosistemit: Demonstrimi i Ndikimit dhe Mjetet e Tregut – e përshtatur Qendra për Teorinë e Ndryshimit 2016	https://ic.fsc.org/file-download/ecosystem-services-procedure-a-7433.pdf
Kompromis	Zgjedhja e cila përfshin humbjen e një cilësie apo shërbimi (të një ekosistemi) në këmbim të fitimit të një cilësie apo shërbimi tjetër. Shumë vendime që ndikojnë ekosistemet përfshijnë kompromise, ndonjëherë kryesisht në periudhën afatgjatë.	Fjalori i IUCN-së	https://www.iucn.org/sites/dev/files/iucn-glossary-of-definitions_en.pdf
Njohuri tradicionale	Njohuritë ekologjike tradicionale (NJEK) janë transmetimi gojor ndër breza në bllok trinomin besim-praktikë-njohuri (Berkes, 2008), duke treguar një kujtesë të fortë kulturore për mjedisin dhe ndjeshmëri të lartë ndaj ndryshimit, dhe varen nga mbijetesa e kulturave të gjalla në vendin e tyre autokton. Njohuritë ekologjike tradicionale (NJET) janë bashkëplotësuese për shkencën perëndimore dhe menaxhimin e burimeve në zonat e mbrojtura, veçanërisht në këtë epokë të ndryshimit të menjëhershëm mjedisor. Kjo njihet nga ekologjistët në revistën e Shoqërisë Ekologjike të Amerikës (Ecological Society of America ESA): Frontiers in Ecology (Kufijtë në Ekologji): "Njohuritë territoriale tërësisht lokale janë veçanërisht të rëndësishme për identifikimin e kufijve apo caqeve ... popujt autoktonë kanë njohuri intime të ndryshoreve territoriale dhe kohore si tregues vëzhgimi, të cilat kur kombinohen me një kuptim shkencor ... mund të përdoren për të zhvilluar përshkrimet e besueshme të kushteve të referimit për vlerësimet (mjedisore) ..." (Herrick et al., 2010). Praktikë tradicionale kulturore, për pjesën më të madhe, kanë qenë ekologjikisht të qëndrueshme, Parqet e Kanadasë (Parks Canada) dhe Këshilli i Parqeve Kanadeze (2008) (Canadian Parks Council) njohin "praktikat e qëndrueshme, të testuara, ekologjikisht të përshtatshme si vlera ekologjike për t'u restauruar apo mirëmbajtur".	Restaurimi Ekologjik për Zonat e Mbrojtura	https://portals.iucn.org/library/sites/library/files/documents/PAG-018.pdf
Përdorim tradicional	Shfrytëzimi i burimeve natyrore nga përdoruesit autoktonë apo nga banorët joautoktonë që përdorin metodat tradicionale. Përdorimi në nivel vendor i referohet shfrytëzimit nga banorët lokalë.	Shërbimet Mijëvjeçare të Ekosistemit	https://www.millenniumassessment.org/documents/document.776.aspx.pdf
Transparencë	Transparenca i referohet një mjedisi në të cilin objektivat e politikës, korniza e tij ligjore, institucionale dhe ekonomike, vendimet për politikat dhe logjika e tyre, të dhënat dhe informacioni në lidhje me politikat monetare dhe financiare, dhe kushtet e agjencive për mbajtjen e përgjegjësisë, ofrohen ndaj publikut në mënyrë të kuptueshme, të aksesueshme dhe të përpiktë.	OECD	https://stats.oecd.org/glossary/detail.asp?ID=4474

Termi	Përkufizimi	Burimi	Link-u
Pasiguri	Shprehja e shkallës në të cilën është e panjohur një gjendje ose situatë e ardhshme (p.sh., e një ekosistemi). Pasiguria mund të vijë për shkak të mungesës së informacionit apo nga mosmarrëveshja për atë që njihet apo kuptohet. Ajo mund të ketë shumë lloje burimesh, që nga gabimet sasiore për të dhënat deri tek terminologjia e përkufizuar në mënyrë të paqartë apo projektimet e paqarta të sjelljes njerëzore. Pasiguria për rrjedhojë mund të përfaqësohet nga masat sasiore (p.sh., një numër vlerash të llogaritura nga modele të ndryshme) apo nga percaktimet cilësore (p.sh., reflektimi i gjykimit të një ekipi ekspertësh).	Shërbimet Mijëvjeçare të Ekosistemit	https://www.millenniumassessment.org/documents/document.300.aspx.pdf
Shkallëzim në rritje	Termi shkallëzim sot përdoret në një sërë mënyrash. Në disa diskutime ai i referohet gjerësisht “të bërit më shumë”, si për shembull “shkallëzimi i trajtimit të HIV/AIDS”. ExpandNet përkufizon shkallëzimin në mënyrë më specifike si: përpjekje të qëllimshme për të rritur ndikimin e novacioneve në shëndetësi të provuara me sukses dhe për të nxitur zhvillimin e politikave dhe programeve në mënyrë të qëndrueshme. “Novacioni” i referohet komponentëve të shërbimit, praktikave apo produkteve të tjera të cilat janë të reja apo të perceptuara si të reja. Novacioni përbëhet nga një “grup ndërhyrjesh” duke përfshirë jo vetëm teknologjinë e re, praktikën klinike, komponentin arsimor apo iniciativat komunitare, por gjithashtu edhe proceset menaxheriale të nevojshme për zbatimin e suksesshëm. Shprehja “të provuara në mënyrë të suksesshme” thekson se ndërhyrjet që do të zgjerohen, mbështeten nga faktet e nxjerra në nivel vendor për efikasitetin dhe fizibilitetin e programit të përfutur qoftë përmes projekteve pilote, demonstruese apo eksperimentuese, apo përmes paraqitjes fillestare të një numri të kufizuar të zonave vendore. “Përpjekjet e qëllimshme” e përcaktojnë shkallëzimin si një proces të drejtuar, në kontrast me shpërndarjen spontane të novacioneve. “Zhvillimi i politikave dhe programeve në mënyrë të qëndrueshme” thekson rëndësinë e ndërtimit të kapaciteteve institucionale dhe qëndrueshmërinë.	OBSH	http://www.who.int/immunization/hpv/deliver/nine_steps_for_developing_a_scalingup_strategy_who_2010.pdf
Sigurim i ujit	“Kapaciteti i një popullsie për të mbrojtur aksesimin e qëndrueshëm të sasive të duhura të ujit me cilësi të pranueshme për të mbështetur jetesën, mirëqenien e njeriut, dhe zhvillimin shoqëror dhe ekonomik, për sigurimin e mbrojtjes kundër ndotjes së ujit dhe fatkeqësitë që lidhen me ujin, dhe për ruajtjen e ekosistemeve në klimë paqeje dhe stabilitet politik.” Ky është përkufizimi i propozuar nga UN-Water, për të shërbyer si pika e fillimit për dialog në sistemin e Kombeve të Bashkuara.	UN Water	http://www.unwater.org/publications/water-security-infographic/
Pellg ujëmbledhës	Zona me tokë e cila ushqen me ujë një lum, duke kaluar nëpër peizazh për t’u derdhur në tributarë dhe rrjedhat kryesore të lumit. Quhen gjithashtu ujëmbledhës, basene kulluese apo basene lumorë.	Fjalori i IUCN-së	https://www.iucn.org/sites/dev/files/iucn-glossary-of-definitions_en.pdf

Referencat

- CBD (Convention on Biological Diversity) (2004). *The Ecosystem Approach* (CBD Guidelines). Montreal: Secretariat of the Convention on Biological Diversity. 50 pp.
- Cohen-Shacham, E., Walters, G., Janzen, C. and Maginnis, S. (2016). *Nature-Based Solutions to Address Societal Challenges*. Gland, Switzerland: International Union for Conservation of Nature. 10.2305/IUCN.CH.2016.13.en
- Cohen-Shacham, E., Andrade, A., Dalton, J., Dudley, N., Jones, M., Kumar, C., Maginnis, S., Maynard, S., Nelson, C., Renaud, F., Welling, R. and Walters, G. (2019). Core principles for successfully implementing and upscaling Nature-based Solutions. *Environmental Science and Policy* 98: 20–29. <https://doi.org/10.1016/j.envsci.2019.04.014>
- de Coninck, H., Revi, A., Babiker, M., Bertoldi, P., Buckridge, M., Cartwright, A., Dong, W., Ford, J., Fuss, S., Hourcade, J.-C., Ley, D., Mechler, R., Newman, P., Revokatova, A., Schultz, S., Steg, L. and Sugiyama, T. (2018). Strengthening and Implementing the Global Response. In: *Global Warming of 1.5°C. An IPCC Special Report on the impacts of global warming of 1.5°C above pre-industrial levels and related global greenhouse gas emission pathways, in the context of strengthening the global response to the threat of climate change, sustainable development, and efforts to eradicate poverty*. IPCC. <https://www.ipcc.ch/report/sr15/chapter-4-strengthening-and-implementing-the-global-response/>
- Holling, C.S (1973). Resilience and stability of ecological systems. *Annual Review of Ecology and Systematics* 4: 1–23. <https://doi.org/10.1146/annurev.es.04.110173.000245>
- Holling, C.S. (ed.) (1978). *Adaptive Environmental Assessment and Management*. London: John Wiley and Sons. 377 pp.
- Holling, C.S. (1986). The resilience of terrestrial ecosystems: local surprise and global change. In: W.C. Clark and R.E. Munn (eds.), *Sustainable Development of the Biosphere*, (Chap. 10: 292–317). Cambridge, U.K.: Cambridge University Press.
- IPBES (Intergovernmental Science-Policy Platform on Biodiversity and Ecosystem Services) (2019a). *Global assessment report on biodiversity and ecosystem services of the Intergovernmental Science- Policy Platform on Biodiversity and Ecosystem Services*. E.S. Brondizio, J. Settele, S. Díaz and H.T. Ngo (eds.). Bonn, Germany: IPBES Secretariat. <https://ipbes.net/global-assessment>
- IPBES (Intergovernmental Science- Policy Platform on Biodiversity and Ecosystem Services) (2019b). *Summary for policymakers of the global assessment report on biodiversity and ecosystem services of the Intergovernmental Science-Policy Platform on Biodiversity and Ecosystem Services*. S. Díaz, J. Settele, E.S. Brondizio, H.T. Ngo, M. Guèze, J. Agard, A. Arneth, P. Balvanera, K.A. Brauman, S.H.M. Butchart, K.M.A. Chan, L.A. Garibaldi, K. Ichii, J. Liu, S.M. Subramanian, G.F. Midgley, P. Miloslavich, Z. Molnár, D. Obura, A. Pfaff, S. Polasky, A. Purvis, J. Razzaque, B. Reyers, R. Roy Chowdhury, Y.J. Shin, I.J. Visseren-Hamakers, K.J. Willis and C.N. Zayas (eds.).

- Bonn, Germany: IPBES Secretariat. 56 pp. <https://ipbes.net/news/global-assessment-summary-policy-makers-final-version-now-available>
- IPCC (Intergovernmental Panel on Climate Change) (2018). *Global Warming of 1.5°C. An IPCC Special Report on the impacts of global warming of 1.5°C above pre-industrial levels and related global greenhouse gas emission pathways, in the context of strengthening the global response to the threat of climate change, sustainable development, and efforts to eradicate poverty*. IPCC. <https://www.ipcc.ch/sr15/>
- IPCC (Intergovernmental Panel on Climate Change) (2019). *IPCC Special Report on Climate Change, Desertification, Land Degradation, Sustainable Land Management, Food Security, and Greenhouse Gas Fluxes in Terrestrial Ecosystems. Summary for Policymakers*. IPCC. <https://www.ipcc.ch/srccl/>
- IUCN (International Union for Conservation of Nature) (2016). Resolution 69 on Defining Nature-based Solutions (WCC-2016-Res-069). IUCN Resolutions, Recommendations and Other Decisions 6–10 September 2016. World Conservation Congress Honolulu, Hawai'i, USA. https://portals.iucn.org/library/sites/library/files/resrecfiles/WCC_2016_RES_069_EN.pdf
- OECD (Organisation for Economic Co-operation and Development) (2020). <http://www.oecd.org/dac/financing-sustainable-development/blendedfinance-principles/> accessed: 11 May 2020.
- PwC and WWF (World Wide Fund for Nature) (2020). *Nature is too big to fail – Biodiversity: the next frontier in financial risk management*. Switzerland: PwC and WWF. <http://www.pwc.ch/wwf-report>
- Rockström, J., Steffen, W., Noone, K. et al. (2009). A safe operating space for humanity. *Nature* 461: 472–475. <https://doi.org/10.1038/461472a>
- Rogers, K.H., Luton, R., Biggs, H., Biggs, R., Blignaut, S., Choles, C.G., Palmer, A.G. and Tangwe, P. (2013). Fostering complexity thinking in action research for change in social-ecological systems. *Ecology and Society* 18(2): 31, 10.5751/ES-05330-180231
- Sharp, R., Tallis, H.T., Ricketts, T., Guerry, A.D., Wood, S.A., Chaplin-Kramer, R., Nelson, E., Ennaanay, D., Wolny, S., Olwero, N., Vigerstol, K., Pennington, D., Mendoza, G., Aukema, J., Foster, J., Forrest, J., Cameron, D., Arkema, K., Lonsdorf, E., Kennedy, C., Verutes, G., Kim, C.K., Guannel, G., Papenfus, M., Toft, J., Marsik, M., Bernhardt, J., Griffin, R., Glowinski, K., Chaumont, N., Perelman, A., Lacayo, M., Mandle, L., Hamel, P., Vogl, A.L., Rogers, L., Bierbower, W., Denu, D. and Douglass, J. (2020). *InVEST User Guide*. The Natural Capital Project, Stanford University, University of Minnesota, The Nature Conservancy, and World Wildlife Fund.
- Smith, R.D. and Maltby, E. (2003). *Using the Ecosystem Approach to implement the Convention on Biological Diversity: Key issues and Case Studies*. Gland, Switzerland and Cambridge, UK: IUCN. <https://doi.org/10.2305/IUCN.CH.2003.CEM.2.en>
- Steffen, W., Richardson, K., Rockstrom, J., Cornell, S.E., Fetzer, I., Bennett, E.M., Biggs, R., Carpenter, S.R., de Vries, W. and de Wit, C.A. (2015). Planetary boundaries: guiding human development on a changing planet. *Science*. <https://doi.org/10.1126/science.1259855>

Waltner-Toews, D. and Kay, J. (2005). The evolution of an ecosystem approach: the diamond schematic and an adaptive methodology for ecosystem sustainability and health. *Ecology and Society* 10(1): 38. <https://doi.org/10.5751/ES-01214-100138>



UNIONI NDËRKOMBËTAR PËR RUAJTJEN
E NATYRËS

SELIA BOTËRORE
Rue Mauverney 28
1196 Gland, Zvicër
Tel +41 22 999 0000
Fax +41 22 999 0002
NbSStandard@iucn.org
www.iucn.org